

1 E martë, 22 tetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e Seancës paraqisni lëndën, ju lutem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të
8 nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori
9 i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 [Përkthim] Mirëmëngjesi, vërej për procesverbal që të
13 gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

14 Përpara sesa të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
15 Prokurorisë 04240 ka një çështje paraprake që dëshirojmë ta
16 trajtojmë.

17 Dje ZPS-ja dorëzoi parashtrimin e protokolluar F02665, ku
18 kërkoi që të ndryshonte listën e provave për të përfshirë tri
19 dokumente që synohen të përdoren për Dëshmitarin 04758 dhe e
20 ftoi Trupin Gjykses që të përcaktonte një kalendar të
21 përshpejtuar.

22 Përderisa Dëshmitari 04758 planifikohej që të dëshmojë
23 pas dëshmitarit që do kemi pas pak, Trupi Gjykses dëshiron që
24 të ftojë Mbrojtjen e Viktimave dhe Ekipet e Mbrojtjeve që të
25 bëjnë parashtrimet e tyre në përgjigje të parashtrimit F02665

1 me gojë në qoftë se ka ndonjë gjë për të shtuar.

2 Atëherë, z. Laws?

3 Z. LAWS: [Përkthim] Ne nuk kemi asnjë kundërshtim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic
5 ose kushdo tjetër që dëshiron të marrë fjalën.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duhet të
7 shikojmë pak dokumentin dhe t'ju japim një përgjigje në qoftë
8 se është e mundur do të kërkonim që t'ju jepnim një përgjigje
9 në seancën tjetër.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
11 problem. Mund ta bëjmë këtë.

12 Ka ndonjë kundërshtim z. Pace?

13 Mirë, në rregull atëherë. Pas pushimit të orës së 11.00
14 do t'ju jap fjalën palëve në mënyrë që të bëjnë parashtrimet e
15 tyre në qoftë se kanë ndonjë gjë kundër këtij propozimi të
16 ZPS-së apo jo.

17 Z. DIXON: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Znj. Asistente, ju
19 lutem, sillni dëshmitarin e Prokurorisë 04440 [Sipas
20 përkthimit] në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
23 uleni.

24 Mirëmëngjesi, Dëshmitar. Jemi gati të vazhdojmë me
25 dëshminë tuaj.

1 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi, përshëndetje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ZPS-ja ka
3 disa pyetje të tjera për ju, kështu që, ju lutem, dëgjojeni me
4 vëmendje.

5 Z. Pace, e keni fjalën ju.

6 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

7 DËSHMITARI: FADIL GECI [Vijon]

8 Pyetje nga z. Pace: [Vazhdim]

9 Z. PACE: [Përkthim]

10 PY. Dhe mirëmëngjesi, Dëshmitar.

11 PË. Mirëmëngjesi.

12 PY. Në intervistën me ZPS-në ju keni thënë që Sabit Geci
13 është nga Llausha, është nga i njëjti fshat dhe keni qenë në
14 të njëjtën klasë bashkë në shkollë. Për procesverbal, këtë e
15 keni thënë në faqen 11 dhe 12, Pjesa 4. A ke informacion se
16 kur është kyçur Sabit Geci në UÇK, Dëshmitar?

17 PË. Edhe një herë, kur është kyç, ë? Të lutem më qartë
18 pyetjen.

19 PY. A e dini se kur është kyçur Sabit Geci në UÇK, Dëshmitar?

20 PË. Unë mund të gaboja, por për afërsisht Sabiti ka qenë në
21 burg, i dënum për një aksident të komunikacionit. Dhe diku në
22 '97, menjëherë që është dalë prej burgu është kyç. Unë q'ashtu
23 jam -- si është dalë prej burgu është kyç.

24 PY. Musliun, që është djali i Mujë Gecit nga Llausha, a e
25 njihni, Dëshmitar?

1 PË. Po, e njoh, shumë mirë e njoh.

2 PY. A ka luftuar ai kundër serbëve në 1998 dhe 1999?

3 PË. Po, po.

4 PY. Po Hetemin, djalin e Sokol Gecit nga Llausha, e njihni?

5 PË. E njoh shumë mirë, shumë, shumë mirë.

6 PY. Po ai, a ka luftuar kundër serbëve në '98 dhe '99?

7 PË. Është bash është dajë i Adem Jasharit.

8 PY. A e njihni Shemsedinin, djalin e Haradin Gecit, dhe në
9 qoftë se e njihni, a e dini në qoftë se ai ka luftuar kundër
10 serbëve në 1998 dhe 1999?

11 PË. I njoh edhe atë të Llaushës janë, të mirë janë. Ca di unë
12 janë të mirë.

13 PY. Kanë luftuar ata kundër serbëve në '98 dhe '99?

14 PË. Po, kanë luftuar edhe baballarët e tyre më herët me
15 Serbinë. Edhe ata kanë vazhdu.

16 PY. A e njihni, a e dini në qoftë se Bekimi, djali i Sejdi
17 Gecit, ka luftuar në '98 dhe '99 kundër serbëve?

18 PË. Po. Ka qenë një kohë. Ata si emra po më përzihen, por
19 edhe ai është i asaj familje që thashë më herët. Dhe unë çka
20 di veç fjalë të mira kem edhe për atë familje edhe për ata.

21 PY. A e dini në qoftë se Xhemajli, djali i Ahmet Gecit, ka
22 luftuar në '98 dhe '99 kundër serbëve?

23 PË. Edhe ai është i Llaushës. Ka fjalë të mira, por çka e di
24 kam fjalë veç të mira. Ka luftue.

25 PY. Emri i fundit që kam sa i takon kësaj linje pyetjesh,

1 është në qoftë se Sabiti, që është djali i Tafil Gecit, ka
2 luftuar apo jo, në '98 dhe '99?

3 PË. Po, ka luftue edhe është familje e mirë edhe unë çka di
4 ka luftue. Ato tjerat -- çka nuk di, nuk di.

5 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
6 në ekran dokumentin 089026-098128 [Sipas përkthimit] dhe
7 sikurse bëmë dhe dje, ky dokument mund të transmetohet për
8 publikun. Do të filloj me faqen 098030. Do kërkoja që të
9 zmadhohej pamja, fotografia që është ngjitur me numrin 23.
10 098030. Ju lutem, zmadhoni vetëm fotografinë me numër 23 që
11 është në cep në të majtë.

12 PY. Dëshmitar, a e ke parë këtë fotografi përpara sesa ta
13 tregoja unë para një jave?

14 PË. Jo, nuk e kam pa. E kam pa për herë të parë tek ju.

15 PY. A njihni ndonjë prej personave që janë pjesë e kësaj
16 fotografie dhe në qoftë se po, ju lutem, na thoni se cilët
17 janë këta persona, duke i lidhur ata me numrat që keni me këto
18 shigjetat përkatëse në fotografi?

19 PË. Po, i njoh. Disa ndër ta dy-tre, tre po më duket. Numër 5
20 është Rexhep Selimi, numër 3 Sylejman Selimi edhe numër 2
21 Kapuqi, një hero i Kosovës.

22 PY. A e dini se si e ka emrin e saktë, e plotë Kapuqi?

23 PË. Po më del mu prej mendje, më duket që e njoh me emër me
24 këtë nofkë e kam njoh gjithë, me këtë nofkë. Komandant Kapuqi.

25 PY. Ju thatë që është heroi i Kosovës. A jeton akoma, apo jo?

1 PË. Jo, nuk jeton. Për atë është hero se këta të gjallët pak
2 zor është për heronj.

3 PY. A e dini se kur ka vdekur ai, në çfarë muaji dhe çfarë
4 viti?

5 PË. Ka vdekë në një rast në kufi me Shqipërinë në mënyrë
6 tragjike, tuj luftu me armikun fyt për fyt.

7 PY. A e dini se kur ka ndodhur kjo, domethënë, në cilin muaj
8 dhe cilin vit?

9 PË. Kjo '98 diku, nuk -- me data muj me gabu, të lutem. Se
10 janë datat -- është krejt opinionimi publik kombëtar e
11 ndërkombëtar e din, nuk -- i mbaj mend fort datat, as nuk jam
12 shku kështu e them vet.

13 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 098042; ta
14 zmadhojmë te fotografia në fund në të djathtë të faqes. Kjo
15 fotografi.

16 PY. Dëshmitar, a e kishe parë ti këtë fotografi përpara se
17 t'jua tregoja unë para një jave?

18 PË. Jo, kurrë hiç.

19 PY. A njeh ndonjë person në këtë fotografi, Dëshmitar?

20 PË. Numër 3, numër 3 Rexhep Selimi. Që ky numër 2 nëse është,
21 nëse s'gaboj në qoftë ai që e kam pa mund të jetë Abedin
22 Rexha.

23 PY. Po vendi, a e njihni se cili është vendi kur është bërë
24 kjo fotografia?

25 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares ta zmadhojë

1 pak se mbase mund ta keni më të qartë.

2 PË. Jo [E pakuptueshme]. Jo, jo veni. Një pemë po shihet. Unë
3 nuk di ka mujt me konë pemë gjithkund, nuk di. E dinë këta më
4 mirë vetë që janë këtu, personi.

5 Z. PACE: [Përkthim] Tani le të kalojmë te faqja 098046
6 [Sipas përkthimit]. Ta zmadhojmë fotografinë me numër 141.

7 PY. Dëshmitar, a njihni ndonjë person te kjo fotografia që
8 është fotografia në të djathtë të ekranit që janë këta dy
9 personat me shifrën 1 dhe 2?

10 PË. Numër 1 është Rexhep Selimi. Numër 2 është ai person që
11 thashë edhe një herë, po mendoj pas ky përpjetë me sy, mund me
12 qenë Abedin Rexha; mund me qenë, mund me gabue, veç sipas
13 mendimit tim Abedin Rexha.

14 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë te faqja 098087. Atëherë
15 do shikojmë fillimisht fotografinë e parë në të majtë që është
16 një fotografi me tre persona, që janë tre persona në këmbë dhe
17 dy persona të ulur.

18 PY. A njihni ndonjë person në këtë fotografinë që keni
19 përpara, Dëshmitar?

20 PË. Po. Dy vëllazërit Jashari, i njoh mirë. Edhe ua kom njoht
21 babën Hamit që ka qenë një burrë shumë shumë i mirë në
22 Drenicë. I pari me mjekër është Sahit Jashari, kurse ky në
23 këmbë me musteqe është Musë Jashari. Këta të tjerët unë nuk po
24 i njoh.

25 PY. Për të qenë të qartë, personi i parë që ka -- që është

1 ulur është i ulur poshtë, për këtë e keni fjalën që e

2 identifikuat, ky që ka mjekër, Dëshmitar?

3 PË. Po ky që ka mjekër i ulën është Sahit Jashari. Ky në mes
4 me do musteqe është Musë Jashari.

5 PY. Ky është personi që ka veshur këtë bluzën e bardhë?

6 PË. Po. Që ky është Musë Jashari, djali i Hamit Jasharit, i
7 një babe të mirë.

8 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin. Të nderuar
9 Gjykatës, kërkojmë që të pranohen në prova fotografitë që i
10 treguam dëshmitarit që kanë të bëjnë me identifikimin e Rexhep
11 Selimit dhe anëtarëve të tjerë të UÇK-së, që ka të bëjë me
12 llojet e uniformave dhe veshjeve që kanë përdorur anëtarët e
13 UÇK-së. Si dhe llojet e ndryshme të armëve dhe të pajisjeve të
14 tjera.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
16 kundërshtim?

17 Përderisa nuk ka kundërshtim, dokumentet si më poshtë
18 098026 në faqen 098030 pranohet në provë.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 besoj se Prokurori kërkoi tre dokumente të tjerë, tre faqe të
21 tjera që të pranoheshin në prova. Më konkretisht kërkoi faqen
22 098030, 098042, 098064 dhe 098087.

23 Z. PACE: [Përkthim] Po, është e saktë dhe mund të
24 klasifikohen si publike.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjitha

1 këto faqe pranohen edhe ju lutem, caktojini një numër prove.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
3 këtyre dokumenteve do iu jepet numri i provës P01753.

4 Aktualisht klasifikimi i këtij dokumenti është si konfidencial
5 dhe me ç'kuptova Prokurori kërkon që të riklasifikohen si
6 publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund t'i
8 riklasifikoni si publike.

9 Z. PACE: [Përkthim]
10 PY. Dëshmitar, në faqen 37 të transkriptit të djeshëm,
11 Mbrojtja e z. Krasniqi tha që ju mund të keni thënë diçka të
12 ngjashme, sepse është diçka që nuk u pasqyrua në transkript në
13 anglisht, kështu që do t'jua lexoj dhe do t'ju pyes në qoftë
14 se keni thënë këtë apo jo. Avokati tha që ajo çfarë dëgjua ne
15 që ju keni thënë është kjo:

16 "Ata që kanë shkruar Komunikatën 59, atëherë do t'ju
17 bëhet analiza e gjakut dhe si rezultat ata nuk do dalin që të
18 jenë shqiptarë."

19 A ju kujtohet - nuk mund të jenë dot shqiptarë - a ju
20 kujtohet ta keni thënë këtë dje, Dëshmitar?

21 PË. Po, kam thënë dje edhe po e them sot.

22 PY. A mund të na e shpjegoni pak, Dëshmitar, se çfarë ke dash
23 të thuash ti me këtë? Domethënë që ata që e kanë shkruar
24 Komunikatën 59 nuk janë shqiptarë, nuk mund të kenë dot gjak
25 shqiptar, çfarë, cili është mesazhi, çfarë keni dashur të

1 thoni me këtë?

2 PË. Mesazhi është i qartë. Ai shqiptar që na ka njoftë mirë
3 kush jem na, e ka shkru Komunikatën 59 mund me konë tyrlifarë
4 lloj nacie tjetër, por jo shqiptar. Me i kontrollu. Mund me
5 thonë jem shqiptar, por brenda nuk besoj që është shqiptar në
6 zemër edhe në gjak. Këtë e kam thënë edhe kjo është e vërtetë.

7 PY. Kjo që do lexoj tani është marrë nga faqja 78, rreshti 19
8 i transkriptit të ditës së djeshme. Do ju lexoj pyetjen dhe
9 përgjigjen dhe pastaj do ju bëj një pyetje, Dëshmitar.

10 "PY. A keni folur ndonjëherë me Ramë Bujën lidhur me
11 komunikatën 59?"

12 Përgjigja që ti jep është si më poshtë:

13 "Po, kam folur. Gjatë mandatit tim të parë si deputet unë
14 i kam thënë, 'M'u largo, sepse ti ke qenë atje dhe nuk ke
15 thënë asnjë fjalë lidhur me ne dhe ti e di shumë mirë se çfarë
16 ka ndodhur'. Ai më mori përdore dhe më çoi në zyrën e
17 zëvendëskryetarit të parlamentit dhe më tha, 'Do të të them
18 diçka. Unë kam folur me ta; i kam thënë 'Mos e bëni këtë gjë
19 se është e gabuar,' dhe ata nuk më dëgjuan. Ju keni vuajtur
20 pasojat, por edhe unë kam vuajtur pasojat se ju kam mbrojtur."

21 "Ai e di këtë gjë. Ai ma ka thënë vetë me gojën e vet
22 këtë gjë."

23 Pyetja e parë që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: A ju
24 ka shpjeguar apo a ju ka thënë Ramë Buja se me kë ka diskutuar
25 lidhur me Komunikatën 59?

1 PË. Po, më ka thënë që "Kemi bisedu në shtab". Ai e dinë atë.
2 Por thotë, "Kam pas pasoja edhe unë pse kam fol për ju". Bile
3 më thotë se "Unë kam hëngër plumb pse ju kam mbrojt ju, e ju
4 keni pas të drejtë, edhe ju mirë na e keni bë se keni pas të
5 drejtë. Iu kam thënë mosni, nuk më ka dëgju, e mbajtshi me
6 shëndet. Le ta mbajnë, le ta marrin përgjegjësinë". Nëse Ramë
7 Buja i mban këto fjalë, mua m'i ka thënë aty, vetëm mua
8 drejtpërdrejt.

9 Edhe ai e din, edhe na dimë edhe diçka që edhe shokët e
10 vet e dinë mirë që kanë pas probleme aty pse kanë fol për
11 vëllazërit Geci.

12 PY. Ju thatë që Ramë Buja të ka thënë që "E kemi diskutuar, e
13 kemi biseduar në shtab". Si e keni kuptuar juve për kë shtab e
14 kishte fjalën Ramë Buja?

15 PË. Ramë Buja ka qenë një përfaqësues i LPK-së. Unë thashë
16 keni punu bashkë në LDK, e kemi njoftë mirë, na ka njoftë mirë
17 dhe e kemi dit që është me orientim ato çfarë -- Marksist-
18 Leninist. Është konë i përбетum në atë drejtim, por është konë
19 njëri prej njerëzve më të meçëm të atij grupi që kam thënë dje
20 edhe po them sot, që kemi pas edhe ne besim në të.

21 PY. Në rregull. Dëshmitar, ju lutem më dëgjoni me vëmendje,
22 përqendrohuni, se është pyetja e fundit për ju. Kur ka thënë
23 Ramë Buja që, "E kam diskutuar, e kam biseduar këtë çështje në
24 shtab", në cilin shtab e ka biseduar këtë, apo ku e ka
25 biseduar këtë?

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 12

1 PË. Shtabin e LPK-së të quajtur UÇK. A tjetër shtab s'ka pas
2 Ramë Buja, këta që janë këtu.

3 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera për ju.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar

6 Kryegjykatës.

7 Pyetje të palës tjetër z. Misetic:

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar. Unë jam Luka Misetic. Jam
10 avokati i Hashim Thaçit. Kam disa pyetje për ju.

11 PË. Shumë bukur.

12 PY. Dua që të fillojmë me disa pyetje të përgjithshme. Ju
13 thatë që njësitë ku keni luftuar, ju nuk e konsideroni se ka
14 qenë pjesë e UÇK-së atë njësit. A është e saktë kjo?

15 PË. Edhe një herë për shpjegim, e ty si avokat më së shumti
16 se e kupton më mirë. Shteti e ka UÇK-në, si forcë të
17 armatosur, e ka policinë si forcë të armatosur edhe ka
18 mbrojtjen territoriale. Një prej atyne ka qenë UÇK-ja që është
19 një UÇK. Kurse ato tjerat ai që e kupton çka është shteti, që
20 ti e kupton mirë, janë edhe këtu. Ai që s'e kupton ia jep
21 shpatit si këta vetë deri tash që ia kanë dhënë.

22 Prandaj UÇK-ja është UÇK. Në kuadër të shtetit është emër
23 UÇK. S'ka tjetër emër asnjë shtet në botë tjetër emër në pos
24 UÇK, ushtri. Nuk ka tjetër emër.

25 PY. Dëshmitar, atëherë do ju them se çfarë i keni thënë ju

1 ZPS-së përpara një jave dhe kjo pasqyrohet në Shënimin
2 Përgatitor numër 1, ku reflektohet atë çfarë i keni thënë ju
3 ZPS-së më konkretisht në paragrafin 14 thuhet që ti ke thënë
4 që:

5 "Kur LPK-ja ka ardhur pas vrasjes së familjes Jashari ata
6 kanë luftuar nën emrin e UÇK-së. Dëshmitari 04240", që jeni
7 juve, "nuk e ka konsideruar veten si pjesë të UÇK-së, sepse ka
8 qenë pjesë e forcave qeveritare."

9 A ju kujtohet t'ia keni thënë Prokurorit këtë përpara një
10 jave, Dëshmitar?

11 PË. Vetëm mos t'i përziem. UÇK-ja është një, një UÇK --

12 PY. Ndalo këtu.

13 PË. Unë kam qenë në Kosovë --

14 PY. Ndalo, ju lutem.

15 Pyetja ime është kjo: A ia ke thënë Prokurorit këtë
16 përpara një jave që ti nuk e ke konsideruar veten që ke qenë
17 pjesë e UÇK-së? A ia ke thënë këtë përpara një jave, apo jo?
18 Po apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Jo, jo, jo. Unë po ju tregoj që kanë qenë dy organizime,
20 dy. Një ka qenë për shtet që jam unë UÇK edhe një për pushtet
21 që -- ai që mbron ti. Kjo ka qenë e vërteta.

22 PY. Pra, ju keni konfirmuar nën betim dje se ajo çfarë
23 pasqyrohet në Shënimin Përgatitor 1 është e vërtetë dhe e
24 saktë. Ndërkohë që tani po thua që ti nuk e ke thënë asnjëherë
25 që e keni konsideruar veten që s'keni qenë pjesë e UÇK-së.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 14

1 Këtë po thoni, Dëshmitar? E keni thënë, apo nuk e keni thënë?

2 PË. Unë kam thënë që jam pjesë e strukturave organizative --

3 PY. Ndalo këtu.

4 Nuk po të pyes këtë. Po të pyes tjetër gjë. Në fjali
5 thuhet që ti nuk e ke konsideruar veten si pjesë e UÇK-së; dua
6 një përgjigje me po apo jo? Ia keni thënë Prokurorit këtë
7 përpara një jave apo jo?

8 PË. Unë nuk e kam konsideru veten si pjesë e LPK-së e jo UÇK-
9 së. UÇK-ja është e shenjtë e shqiptarisë. Pjesë e asaj që kam
10 kontribu më së shumti jam unë, me familje e me shqiptarë të
11 ndershëm gjithë ka.

12 PY. Në rregull. Edhe pse dje nën betim ju thatë që kjo është
13 e vërtetë, rezulton që kjo nuk ka qenë e vërtetë për aq kohë
14 sa po thua tjetër gjë sot.

15 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, sepse e mori përgjigjen
16 pyetja.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
18 duhet të thuash "po" apo "jo", në përgjigje të pyetjes, asgjë
19 tjetër më shumë se kaq.

20 DËSHMITARI: Unë kam qenë pjesë --

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm "po"
22 apo "jo".

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. A i ke thënë apo jo Prokurorit përpara një jave që nuk ke
25 qenë pjesë e UÇK-së, po apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Edhe një herë, unë kam qenë pjesë e UÇK-së, por jo e LPK-
2 së.

3 PY. Në rregull. Do ta lemë me kaq këtë temë. Kujt i keni
4 raportuar ju? E kam fjalën për njësitin ku ke qenë pjesë ti.
5 Kujt i raportonit ju si njësit?

6 PË. Ne e kemi pas Ministrin e Mbrojtjes, Ahmet Krasniqin, i
7 zgjedhur nga Presidenti Ibrahim Rugova. Ai ka qenë komanda
8 kryesore e jona. Komandant ka qenë Ibrahim Rugova. Zyrtarisht
9 me rregulla, me ligj. Kurrkund në botë nuk ka tjetër jashtë
10 këtyre rregullave.

11 PY. Në rregull. Unë dua të më thoni fakte. Dua të më jepni
12 një përgjigje faktike. Në aktivitetet ose veprimtaritë tuaja
13 të përditshme si komandant i atij njësiti, si komunikonit ju
14 me Ahmet Krasniqin? Sepse me ç'kuptoj ju thoni që i keni
15 raportuar drejtpërsëdrejti Ahmet Krasniqit, apo jo, Dëshmitar?

16 PË. Po. Ne komunikimin e kemi pas për fillim, kemi pas
17 drejtpërdrejt me një telefon që kemi pas; nuk kemi pas mjete
18 ne tashit, moderne që po komunikojmë. Por drejtpërdrejt jemi
19 konë të lidhur me Ahmet Krasniqin.

20 PY. Ju nuk keni komunikuar me askund tjetër në zinxhirin e
21 komandës. Domethënë nga njësiti juaj ju keni biseduar ose keni
22 komunikuar drejtpërsëdrejti me Ahmet Krasniqin, nuk ka pas
23 asnjë tjetër ndërmjet që keni raportuar ose keni biseduar ju,
24 kështu Dëshmitar?

25 PË. Unë kam komuniku drejtpërdrejt me Ahmet Krasniqin. Baza,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 16

1 themeli i asaj pjese ka qenë në Drenicë, te ne, tek unë
2 personalisht, te familja jonë edhe te pjesa komplet që ka qenë
3 e strukturume e LDK-së.

4 PY. Po, pyetja ime është paksa e ndryshme tani. Ajo çfarë po
5 them është kjo që ju nuk i keni raportuar askujt tjetër, vetëm
6 Ahmet Krasniqit i keni raportuar, askujt tjetër përveç atij,
7 kështu?

8 PË. Kështu është e vërtetë.

9 PY. Pra, ju nuk e keni konsideruar veten që keni qenë nën
10 komandën e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, a është e saktë
11 kjo, Dëshmitar?

12 PË. Unë nuk kam qenë nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm
13 të LPK-së që e ka qujt veten UÇK.

14 PY. Me këtë doni të thoni e keni fjalën për Bislim Zyrapin,
15 Rexhep Selimin, Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, domethënë,
16 doni të thonë që nuk keni qenë nën komandën e askujt prej
17 këtyre që përmenda?

18 PË. Kanë qenë pjesë e LPK-së.

19 PY. Nuk është pyetja ime kjo, Dëshmitar. Unë ty pyeta, ju nuk
20 keni qenë nën komandën e këtyre personave që përmenda, po apo
21 jo?

22 PË. Thashë jo, e LPK-së. Mjafton po më duket.

23 PY. Atëherë se çfarë mjafton e vendos unë. Unë po ju pyes, ju
24 s'keni qenë nën komandën e këtyre personave, a është e saktë
25 kjo, Dëshmitar?

1 PË. Kurrë e Marksistëve-Leninistëve s'kam qenë nën komandën e
2 tyne, kurrë.

3 PY. Dëshmitar, po ju bëj pyetje të thjeshta, kështu që, ju
4 lutem, mundohuni që ta hiqni politikën nga përgjigjet që më
5 jepni.

6 Gjatë seancës përgatitore ju kanë bërë pyetje dhe më
7 konkretisht për procesverbal e kam për Shënimin Përgatitor
8 numër 2, paragrafi 27 dhe lidhur me këtë pikë ju bënë pyetje
9 edhe dje. Ju kanë treguar një fragment, një pjesë dhe ju keni
10 konfirmuar që ndokush që nuk e dinte që ju dhe të tjerët keni
11 qenë me Ministrinë e Mbrojtjes mendonte ose mund të supozonte
12 që ju të gjithë ishit luftëtarë të UÇK-së; a është e vërtetë
13 kjo, Dëshmitar?

14 PË. Edhe një herë, ju lutem ma -- edhe një herë pyetjen se
15 mirë s'e kuptova, duhet ta kuptoj më mirë.

16 PY. Po, Dëshmitar. Dje të treguan një pjesë nga një libër i
17 shkruar nga Maxhun Smajli, të kujtohet?

18 PË. Po.

19 PY. Maxhun Smajli aty kishte një fotografi tënden në libër,
20 të kujtohet?

21 PË. Po.

22 PY. Në libër shkruante që ju ishit luftëtarë të UÇK-së.
23 Ndërsa javës që shkoi i the ZPS-së se dikush që nuk të njihte
24 ty dhe të tjerët që ishit me Ministrinë e Mbrojtjes do të
25 mendonin se ishit ushtarë të UÇK-së, a i keni këtë gjë, të

1 kujtohet javës që shkoi?

2 PË. Unë kam thënë se deri në atë kohë, kur ai ka thënë, ka
3 qenë marsi, prilli, maji, qershori komplet kemi qenë unik,
4 komplet kemi qenë unik në një Ushtri Çlirimtare të Kosovës,
5 komplet pa përçarje, derisa janë ardhë këta prej atjehit dhe
6 na kanë mësu qysh me luftu prej jashtmi, prej Zvicre. E na
7 ishim në luftë këtu. Qysh me na thënë neve që ishim këtu, këta
8 ishin atje? Qysh erdhën këta na mësuan, na e morën kokën e na
9 mësuan qysh me luftu?

10 PY. Nuk po i përgjigjesh përsëri pyetjes. Pyetja është, a i
11 the javës që shkoi Prokurorisë se një person që nuk e dinte se
12 ishit me Ministrinë e Mbrojtjes do të mendonte se ishit
13 ushtarë të UÇK-së, po apo jo?

14 PË. Edhe në atë kohë të gjithë kemi qenë unik në një vend.
15 Gjithë pa asnjë përçarje 99 për qind një vend në Ushtrinë
16 Çlirimtare të Kosovës, derisa na kanë ardhë -- nën mbrojtje të
17 institucioneve.

18 PY. Dëshmitar, besoj që e kupton pyetjen që po të bëj dhe po
19 i shmangesh, po i bën bisht përgjigjes. Po e përsëris për herë
20 të tretë, a i the ZPS-së javës që shkoi se një njeri që nuk e
21 dinte se ti dhe të tjerët ishit me Ministrinë e Mbrojtjes do
22 të supozonin, do të mendonin se ishit luftëtarë të UÇK-së.

23 Pyetja është po apo jo? Ia ke thënë këtë gjë javës që shkoi
24 Prokurorisë?

25 PË. Besoj që edhe ju edhe Gjyqtari edhe ju të gjithë këtu po

1 më kuptoni ca po them. Ishim unik, një ka qenë, s'kem qenë të
2 tjerë deri sa janë ardhë e na kanë përça këta prej Zvicrës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Detyra jote
4 këtu është t'i përgjigjesh pyetjeve. Nuk po i përgjigjesh
5 pyetjeve. Pyetja kërkon një përgjigje me po apo jo. Në këtë
6 rast është e domosdoshme që t'i përgjigjesh "po" apo "jo". A
7 ia ke thënë këtë ZPS-së? Kjo është pyetja. Dhe ti mund t'i
8 përgjigjesh "po" apo "jo".

9 DËSHMITARI: I nderuar Kryetar, Gjyqtar --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prit, prit.

11 Mund t'i përgjigjes vetëm me "po" dhe "jo". Kjo është
12 detyrim për ty. Përgjigju që të vazhdojmë të ecim më tej.

13 DËSHMITARI: Veç po më duket i jap kuptim tjetër. Se unë
14 krejt në rregull.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo. Përgjigju
16 pyetjes.

17 Vetëm përgjigju pyetjes. Nëse ZPS-ja dëshiron që më vonë
18 të të bëjë pyetje sqaruese do ta kenë rastin të bëjnë. Ndërsa
19 në këtë moment përgjigju pyetjeve që të bën Avokati. Dhe
20 përgjigju sipas asaj që të pyesin.

21 Më kupton? E kupton apo jo? Më thuaj.

22 DËSHMITARI: E kuptoj, por po më duket nuk po i jepet
23 kuptimi me "po", "jo". Po njet mangët. I nderuari Gjyqtar, po
24 njet, Kryetari i Gjyqit, po njet mangët. Edhe me një fjalë e
25 hup kuptimin krejt.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E ke gabim.
2 Kjo pyetje kërkon një përgjigje me "po" apo "jo". Dhe kështu
3 përgjigju.

4 DËSHMITARI: Okej. Do të provoj, qysh të denë do të
5 provoj.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Ia ke thënë këtë Prokurorisë javën e kaluar, po apo jo?

8 PË. Ça i kam thënë, edhe një herë shpjegoma se kam thënë
9 shumë sende aty.

10 PY. Dakord. A i the javës që shkoi Prokurorisë se një njeri
11 që nuk e di se ti dhe të tjerët ishit me Ministrinë e
12 Mbrojtjes do të supozonin, do të mendonin se ishit ushtarë të
13 UÇK-së; po apo jo?

14 PË. Po, e kam thënë, sigurisht e kam thënë. Veç kuptimi është
15 tjetër.

16 PY. Në rregull. Tani të shkojmë në një temë tjetër. Ju keni
17 ndonjë njohuri personale se çfarë ndodhi në Qirez me
18 delegacionin parlamentar në '98 se s'ke qenë i pranishëm.

19 PË. Nuk kam qenë i pranishëm.

20 PY. Në rregull. Nuk ke njohuri vetjake, personale, pra,
21 lidhur me atë që ndodhi me Mensur [Sipas përkthimit] Deskun
22 dhe Kastratin, kështu? Nuk ke qenë i pranishëm?

23 PË. A kam njohuri a nuk kam qenë? Shumë kam njohuri. A nuk
24 kam qenë vetë.

25 PY. Po, por doja të thosha nuk e ke parë me sytë e ty vetë;

- 1 nuk ishte që ta dëgjoje me veshët e ty. Nuk ke qenë që të
2 shikoje me sytë e tu.
- 3 PË. Krejt ashtu është.
- 4 PY. Lidhur me Tahir Zemajn në shtator të '98-s, nuk ke qenë
5 në zonën e Dukagjinit për të dëgjuar ndonjë bisedë midis, për
6 ndonjë bisedë me Hashim Thaçin, Rexhep Selimin dhe Tahir
7 Zemajn, kështu?
- 8 PË. E vërtetë është ajo që s'kam qenë. Por edhe këtu kam
9 njohuri se kam takue Tahir Zemën se vetë m'i ka thënë me gojë
10 të vet edhe libri është.
- 11 PY. Po, janë në libër. Tani nuk ke qenë i pranishëm kur është
12 arrestuar Sejdi Koci, kështu?
- 13 PË. Nuk kam qenë, por e kam pas Sejdi Koci ka qenë njeri
14 numër një në Drenicë, patrioti numër një që është arrestu,
15 është mbajt 10 ditë dhe në fund ka hongër edhe plumb si
16 kryetar i LDK-së, si bashkëpunëtor i imi. Prej njerëzve që i
17 kanë thënë të kanë lypë ata nalt dhe e ka arrestu Sabit Geci.
18 Po Sabiti ka thënë, "Unë e di që je burri i mirë, e di që ke
19 respekt shumë, por ata nalt të kanë kërku, se unë kurrë s'të
20 kisha marrë." E kush janë ata nalt nuk di që ka pas [E
21 pakuptueshme].
- 22 PY. Në rregull. Pra, nuk ke njohuri personale për këtë që
23 thamë. Thjesht po përsërit atë që të ka thënë të tjerët më
24 vonë, kështu?
- 25 PË. M'ka thënë Sejdi Koca, e kam pas bashkëpunëtorin më të

1 ngushtë, m'ka thënë mua ditën që është ardhë. Krejt këto sikur
2 ai i transmetoj unë, se mua m'i kanë thënë drejt; njeri i
3 vetëm që ka pas besim jam unë. Edhe mua m'i ka thënë këto
4 fjalë. Edhe këto janë 200 për qind të vërteta çfarë po të
5 them. Është arrestu edhe është tentu me e vra, veç Zoti e ka
6 shpëtu plumbin në fyt e ka marrë. Njeriu më i mirë i Drenicës
7 ka marrë plumbin në fyt pse ka qenë me LDK-në, pse ka qenë i
8 pathyeshëm me Ibrahim Rugovën.

9 Pse u arrestu edhe gjatë luftës veç pse ka qenë -- si ai
10 kanë pas fatin edhe shumë të tjerë që nuk i kam përmend. Më
11 pyetni t'ju përmendi se janë njet shumë pa thënë.

12 PY. Pra, po e them. Këtë e ke dëgjuar më vonë, nuk ke qenë
13 vetë i pranishëm kur është arrestuar Sejdi Koci, kështu?

14 PË. Aty nuk kam qenë i pranishëm, se është e vërtetë, por më
15 ka thënë mua kur është ardhë ditën që është ardhë m'i ka thënë
16 mua këto fjalë. Edhe asnjëri nuk është as djemtë e tij
17 kurrkush që i din ato punë qa më ka thënë mua se unë.

18 PY. Tani të kalojmë te një temë tjetër. A ke dijeni, dhe për
19 këtë ka shkruar vëllai yt një libër për urdhër-arrestin që ka
20 lëshuar Sylejman Selimi për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, dhe
21 Rexhep Selimin, e ke lexuar këtë pjesë në librin e vëllait?

22 PË. Nuk kam dijeni. Vjen vëllai edhe pyeteni atë këtu
23 drejtpërdrejt.

24 PY. Pra, nuk ke dijeni se Sylejman Selimi ka dhënë një urdhër
25 arresti për të arrestuar Hashim Thaçin, Rexhep Selimin dhe

1 Kadri Veselin?

2 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Dëshmitari tha që nuk ka
3 njohuri.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigju
5 pyetjes, nuk merret parasysh kundërshtimi.

6 DËSHMITARI: Nuk kam njohuri. Atë e din vetëm ai që ka
7 thënë, ai përgjigjet, jo unë. Ai vjen këtu dhe pyeteni.

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Tani, ajo që di apo ajo që dëgjove lidhur me hartimin e
10 Komunikatës 59, nga ç'the ti dje, unë kuptova që Rexhep
11 Selimi, Jakup Krasniqi, Fatmir Limaj i kanë thënë Milaim Zekës
12 që i tha Sabit Gecaj i cili të ka thënë ty, kështu?

13 PË. Emri Sabit Geci këtu nuk u përmend hiç.

14 PËRKTHYESI: Më fal. Gabimi im, Gani, Gani. Gabim. Gani
15 Geci.

16 PY. Nuk e thashë unë, thashë Gani. Ishte gabim përkthimi.

17 Po e përsëris përsëri. Ato që dije, që more mësove lidhur
18 me Komunikatën 59 kush e kishte shkruajtur, pretendohet se
19 Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj i thanë Milaim
20 Zekas që i tha vëllait tënd Gani Geci që të tha ty, kështu ka
21 qenë?

22 PË. Për Komunikatën 59, nuk jemi ndal na, kemi punu me krejt
23 shtabin me të cilin e kemi zënë, kemi bisedu me ta cili e keni
24 shkru, dhe ne, unë e kam bë një shkresë zyrtare në emër të
25 familjes në '98, që u informuam prej Milaim Zekës që ky person

1 e ka shkruar dhe ajo është e vërtetë. Tash është zyrtare edhe
2 këtu në dokumente.

3 PY. Dakord. Kur thua Milaim Zekaj na informoi, sipas dëshmisë
4 tënde e informoi Gani Gecit i cili të tha ty, kështu?

5 PË. Gani Gecin. Gani Gecin, vëllain tim.

6 PY. Milaim Zeka ka të bëjë me ju apo jo, është njeriu juaj i
7 afërm?

8 PË. Jo, hiç s'është i afërm, kurrëgjë afër me mua lidhje s'ka
9 Milaim Zeka. As kurrfarë jarani s'e kam Milaim Zekën, hiç. Se
10 është marksist edhe ai. Po, nip e kam, nip prej Llaushës është
11 por kurrfarë jarani s'e kam, hiç. Unë bile hiç. Jarani, ai
12 është jarani i këtyne, i Hashimit dhe i këtyne.

13 PY. Mjaft, mjaft. Çfarë do të thotë që "është nip i
14 Llaushës", çfarë do të thotë kjo?

15 PË. Do të thotë që i ka dajat në Llaushë, por jo te Geci, por
16 në katund tonin, katund i madh.

17 PY. E kuptova. Pra, ky informacion nga Milaim Zekaj, këtë ta
18 thënë përpara sesa të vije të jepje intervistën për ZPS-në në
19 19 shtator 2018, kështu?

20 PË. Unë kam kërku aty kemi kërku publikisht prej shtabit,
21 nuk e di ZPS a më ka pyet, por ti që po më pyet po të tregoj,
22 kem kërku unë publikisht, dilni kërkon falje për Komunikatën
23 59.

24 PY. Nuk ishte kjo pyetje ime. Dëgjoje pyetjen. Ata
25 informacione që ia dha Gani Gecit Milaim Zekaj që t'u kalua ty

1 pastaj, këtë ta thënë, këtë informacion përpara asaj

2 intervistës së 18 shtatorit 2018, kështu?

3 PË. Po përpara ka qenë ajo.

4 PY. Tani --

5 PË. Edhe pse unë e kam dit se unë i kam -- menjëherë kur

6 është shku komunikata unë kam shku në familjen e Hashim

7 Thaçit, te baba i tij. Edhe 20 vjet nuk është dalë me kërku

8 falje derisa e pa që s'ka ku shkon mandej. E pasojat i kemi

9 vuajt ne si familje me dy të vramë e shumë të tjerë.

10 PY. Nuk ishte kjo pyetje që ju bëra. Nuk jemi këtu për të

11 mbajtur familje. Përgjigju pyetjes që po të bëj.

12 PË. Po, po.

13 PY. Mjaft. Do të bëj edhe disa pyetje të tjera.

14 Është e saktë që në deklaratën që i ke dhënë si

15 dëshmitar, nuk identifikon asgjë që ka thënë Hashim Thaçi gjë

16 të keqe për ty apo për familjen Geci, kështu?

17 PË. Çka do me konë më e keqe se me shkru Komunikatën 59, çka

18 ka më të keqe, çka ka më të rëndë, çka ka më vrastare --

19 PY. Mjaft, mjaft.

20 PË. -- çka ka më të poshtër.

21 PY. Zotëri, mos e çojmë më tej. Kaq. Për procesverbal Hashim

22 Thaçi e mohon që ka komunikuar, ka shkruar, ka pas të bëjë me

23 Komunikatën 59. Pra, ta lëmë mënjanë këtë Komunikatën 59.

24 Është e saktë që në deklaratën që ke dhënë si dëshmitar

25 nuk ke thënë asnjë gjë, dëgjoje me vëmendje, nuk ka thënë

1 asgjë të keqe për ty, Gani Gecin apo anëtarët e tjerë të
2 familjes Geci, a është kjo e vërtetë?

3 PË. Çka ka me thënë tjetër send, gjithë thuje të mirë, veç
4 shkruaje Komunikatën, s'ka burra si ti, i ka pri ofensivës
5 serbe. Punë më të poshtër a ka diçka.

6 PY. Pra, pajtohesh me mua që përveç asaj që ti pretendon
7 lidhur me Komunikatën 59 nuk ka thënë asgjë të keqe për ju,
8 gjatë luftës apo mbas luftës për familjen Geci?

9 PË. Pretendoj, por është e vërtetë e kurrëgjë tjetër s'ka
10 thënë, veç Komunikatën 59. Gjithë të tjerat që ka thënë janë
11 të mira. S'ka si ata. Veç Komunikatën 59 e ka çu.

12 E tash që kjo pesha e fjalëve t'mira dhe asaj.

13 PY. Kjo është e diskutueshme.

14 PË. Jo.

15 PY. Do t'i kthehem kësaj mbas pak, por për momentin dua të
16 sqarojmë me sa di ti gjatë luftës apo mbas luftës nuk ka bërë
17 asgjë. Në fakt dje the, siç ke thënë edhe në intervistën e
18 ZPS-së që një herë që je takuar me Hashim Thaçin gjatë luftës,
19 the që të puthi dorën, kështu?

20 PË. Po, e vërtetë.

21 PY. Pra, puthja e dorës, ça tregon? Respekt apo jo?

22 PË. Jo, jo s'tregon respekt. Është diçka krejt tjetër. Është
23 njeri i rrezikshëm. Se kur mendon që është në rrezik tana i
24 bën. Edhe burri që ta puth dorën ai katastrofë është për atë,
25 për shokët e vet edhe për shoqni është katastrofë, me i lënë

1 diçka në dorë. Kjo është e vërteta.

2 PY. Për procesverbal --

3 PË. Edhe për --

4 PY. Pra, për ty kur dikush të puth dorën është shenjë
5 armiqësie? E kuptova.

6 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Nuk është pyetja. Mos e
7 përshtati sipas dëshirës.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po i them, pra, ju, pra, ti e merr
9 si shenjë armiqësie puthjen e dorës, kështu?

10 Z. PACE: [Përkthim] Iu përgjigj dëshmitari. E kundërshtoj
11 edhe këtë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet
13 kundërshtimi.

14 Mund t'i përgjigjeni pyetjes, Dëshmitar.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Pra, për ty është shenjë armiqësie, kështu?

17 PË. Në atë moment që del edhe thotë, vetëm ka mendu që
18 situata është aq e ashpër qysh kanë bë vetë dhe unë nuk kisha
19 pa kurrë në jetë, as kam pa sot në jetë asi rasti, kurrë, s'ka
20 bë vaki kush me ma puth dorën. Femra të ma puthë dorën e kam
21 mërzi.

22 PY. Nuk ishte kjo pyetja.

23 PË. Shumë mërzi, jam shumë i ndishëm, janë burrat. Kjo është
24 ajo që unë mendoj edhe kam thënë.

25 PY. Edhe një herë nuk po i përgjigjesh pyetjes sime. Për ty

1 është shenjë armiqësie, këtë dua të them, kështu?

2 PË. Shenjë me dalë, me ik, dribling, me i ik rrezikut, veç me
3 dalë. Ka mendu që është në rrezik dhe veç të dal të eci. E
4 kurrë më s'mu ka përgjigj. As kurrë s'ka lyp me u taku me mu.
5 As kurrë nuk është deklaruar për Komunikatën 59. Pasojat i kemi
6 vuajt na familja jonë. Edhe shqiptarët në përgjithësi kanë
7 thënë që ashtu qenka deri tash që po merren, po e dinë cila
8 është e vërteta.

9 PY. Po asgjë nga këto që thua nuk është e vërtetë, këto që
10 sapo the.

11 PË. Të gjitha janë të vërteta edhe vetëm të vërteta.

12 PY. Do të vijmë edhe aty. Zotëri, përpara 2017 asnjëherë nuk
13 të ka sugjeruar apo të ka thënë se Hashim Thaçi e ka shkruar
14 Komunikatën 59, a është e saktë kjo?

15 PË. Prej ditës së parë e kam dit që Hashim Thaçi e ka shkru.
16 Unë prej ditës së parë që e ka shkru e kam dit, i kam shku në
17 shtëpi, edhe i kam thënë, "ama përgjigjen për Komunikatën 59".
18 Më ka thënë "brenda një muaji", baba i tij "ta jep
19 përgjigjen", kurrë s'më ka dhënë përgjigjen. Pse, pse pyetëm
20 ti si avokat, të kallëzoi pse s'e ka dhënë përgjigjen. Unë të
21 tregoj -- pse s'e ka dhënë përgjigjen, pse s'e ka dhënë 20
22 vjet. E unë të kallëzoi ty pse s'e ka dhënë. Edhe Gjykatës së
23 nderuar këtu. Nuk e ka dhënë përgjigjen se kanë mendu --
24 Jasharët i likuiduan, ky njerëzit e vdekun i ka dashtë edhe i
25 ka përmend, jo të gjallët. E na jemi të gjallë e ka mendu edhe

1 neve me na likuidu. Po jem këtu edhe na ka ruajt Zoti me thënë
2 të vërtetën edhe me i shkru të vërtetën, jo rrenën. Edhe vetëm
3 të vërtetën. Të gjitha këto janë të sakta.

4 PY. Dëshmitar, nuk është e saktë, sepse Hashim Thaçi, vëllai
5 yt Gani Geci e ka përdorur Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin si
6 ndërmjetës në 2013 për të ndërmjetësuar për këtë
7 mosmarrëveshje me Azem Sylën, kështu?

8 PË. Po e vërtetë që janë taku, po. Po Kadri Veseli --

9 PY. Po, kështu është.

10 PË. -- mos ma shtin në atë lami me këta hiç. Unë nuk du me u
11 marrë me të, tjetër është person. Hiç.

12 PY. Jo, jo, jo.

13 PË. Nuk kam unë çka me thënë.

14 PY. Ndalo tani.

15 Familja jote e ka përdorur Hashim Thaçin dhe Kadri
16 Veselin si ndërmjetësues në një mosmarrëveshje midis Ganiut
17 dhe Azem Sylës në 2013, kështu?

18 Ti i besove atij --

19 PË. Çka i besova?

20 PY. -- si ndërmjetësues. Pra, ti e pranove që të ishe
21 ndërmjetësues në mosmarrëveshjen që kishit me Azem Sylën,
22 kështu ka qenë? E more në shtëpi?

23 PË. Jo, nuk e kam marrë në shtëpi. Është rregull e
24 shqiptarit; kur nuk të pret i zoti i shtëpisë, i zoti i
25 shtëpisë është vëllai i madh Halili, unë jam i dyti Fadili, i

1 treti është Haxhia, i katërti, i pesti kam besu me fol me ta,
2 jo unë, as në shtëpinë time hiç, kurrë s'kam pranë se e kam di
3 se çfarë është, kurrë.

4 PY. Pra, mirë atëherë, familja jote e pranoi në shtëpi.

5 PË. Jo, në shtëpi familja ime, hiç në shtëpinë time, kurrë.

6 Kurrë s'ka qenë në shtëpinë time. S'e kam pranë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim materialin DHT04395 deri
8 në DHT04396 edhe në shqip edhe në anglisht.

9 PY. Ky është një artikull i botuar në 2013, pra, ishte lajm
10 publik; e dinin të gjithë se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli
11 kishin qenë ndërmjetësues në mosmarrëveshjen e vëllain tënd me
12 Azem Sylën, kështu?

13 PË. Ku? Në cilin vend? Se e vërtetë është ajo çfarë po thu.

14 PY. Më thuaj ti ku ndodhi kjo?

15 PË. Edhe unë po të them s'janë kon në shtëpinë time, që ku të
16 kenë këtu, të dy janë këtu.

17 PY. Jam unë që po të pyes --

18 PË. Edhe unë po të pyes ty.

19 PY. -- ku ndodhi kjo?

20 PË. Kjo ka ndodh në katundin tim në Llaushë, por jo në
21 shtëpinë time.

22 PY. Në shtëpinë e kujt ka ndodh?

23 PË. Në shtëpinë e Jetullah Gecit.

24 PY. Në rregull. Kush është Jetullah Geci?

25 PË. Jetullah Geci është një person i katundit. Daja i Adem

1 Jasharit. Është një djalë i mirë, është një luftëtar i mirë, i
2 ka të gjitha të mirat.

3 PY. Dakord, pra, t'i kthehem përsëri pyetjes që të bëra në
4 fillim. Askush nuk të ka thënë ndonjëherë, sidomos përpara
5 këtij ndërmjetësimi për të cilin po flasim, se Komunikatën 59
6 e ka shkruar Hashim Thaçi, kështu?

7 PË. Unë po të them prej ditës së parë e kam dit, po kena pyet
8 gjithë shtabin, krejt vllaznia janë marrë me shtabin cili e ka
9 shkru.

10 PY. Unë po të bëj një pyetje. Askush nuk të ka thënë se ai e
11 ka shkruar Komunikatën 59, ndryshe nuk do ta kishte përdorur
12 si ndërmjetësues në këtë mosmarrëveshjen me Azem Sylën?

13 PË. Nuk është ai për aty për komunikatë. Azem Sylja ka fol, ka
14 thënë, "Unë e kam shkru". Azem Sylja ka thënë që "Qëndroj mbas
15 saj". Azem Sylja ka thënë "Unë qëndroj mbas kësaj." Nuk e di a
16 qëndron. Pyetni tash a qëndron a s'qëndron, a ka ndërru mendje
17 edhe ai. Kur të vjen këtu pyeteni. A publikisht ka thënë unë
18 qëndroj mbas kësaj. Mbas një rrene, mbas një poshtërsie.

19 PY. Dëshmitar, po t'i bëj unë pyetjet. Dhe pyetja është kjo:
20 Familja jote nuk do ta kishte përdorur Hashim Thaçin si
21 ndërmjetësues në këtë mosmarrëveshje, në qoftë se në atë
22 moment ti do të kishe qenë i bindur që Komunikatën 59 e ka
23 shkruar ai për Gani Gecin, kjo është logjike, apo jo?

24 PË. Jo, s'është hiç se krejt i kemi dit, por kemi dashtë me
25 dit ça po thojnë vetë se kanë fol edhe rrena. Sa kanë mund

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 32

1 kanë fol rrena, kanë kërku falje, thuj s'e kena bo hiç e, janë
2 të mirë ata. Por Komunikatën e ka shkru Hashim Thaçi. A duhet
3 diçka tjetër me thënë këtu, a është e qartë kjo tash? Kjo
4 është e qartë për publik edhe për ty besoj nuk ka nevojë më
5 shumë kush e ka shkru.

6 PY. Do të diskutojmë dhe më shumë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar e paraqis këtë dokument
8 si provë për ta pranuar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT04395 deri
10 në DHT04396 në anglisht dhe në shqip pranohen.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Versionet shqip dhe
12 anglisht do të kenë numrin 1D00196, klasifikimi i tyre është
13 publik.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Dëshmitar, rreth kësaj kohe kur është bërë ndërhyrja, z.
16 Thaçi kishte folur me vëllain tënd dhe i kishte treguar se
17 kush ishte ai që ky besonte e kishte shkruar Komunikatën 59,
18 kështu?

19 PË. Po. Përafërsisht po, me rrotulla, po.

20 PY. Pra, çfarë i thotë vëllait -- kush e kishte shkruar që ai
21 mendonte se kishte shkruar këtë Komunikatën 59?

22 PË. Është më së miri vëllain me e pyet, por unë mua çfarë më
23 ka thënë. Kjo ndoshta s'është diçka, mua çfarë më ka thënë po
24 e them.

25 PY. Pra, je sjellë këtu që të tregosh edhe atë që të ka thënë

1 vëllai dhe unë po të pyes: Çfarë të tha vëllai që i kishte
2 treguar Hashim Thaçi lidhur me personin që e kishte shkruajtur
3 Komunikatën 59?

4 PË. Unë e kam dit që e ka pak zanat, tha marrke, qitke shpesh
5 me dalë me bo shurrën, me nder me thënë para juve, edhe e
6 rroke bukur shpesh. Dhe më thojke që unë kam faj që nuk e lash
7 atëherë për njonin që jeni konë, ke dashtë -- ke pas fjalë me
8 të. Ai u ditke që është Rexhep Selimi. Ai për Rexhep Selimin
9 ka thënë që -- ka aludu që ai e ka shkru me rrotulla.

10 PY. Pra, vëllai yt thotë që ai e kuptoi qartë që Rexhep
11 Selimi e kishte shkruar Komunikatën 59. Kjo ka ndodhur rreth
12 vitit 2013, pra, pavarësisht se ç' thatë më përpara, që s' i ka
13 thënë asnjëherë familjes se kush e ka shkruar Komunikatën 59.
14 Në fakt e di që ai i ka thënë vëllain tënd që Komunikatën 59 e
15 ka shkruar Rexhep Selimi. Pra, ti e di këtë?

16 PË. Nuk ia ka përmend emrin, por thashë edhe një herë, me
17 rrotulla, u mundu me i gju dikë, me i hup. Emrin s' ia ka
18 përmend por aty ka aludu. Aty ka mendu. Aty ka mendu.

19 PY. Do shikojmë atë çfarë ka thënë vëllai jua j për pak, sa i
20 takon atë çfarë është thënë lidhur me personin që ka shkruar
21 Komunikatën 59. Megjithatë për momentin e lë të pyes diçka
22 tjetër.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
24 do të bëjmë një pushim të shkurtër. Gjithsesi, në qoftë se
25 keni një pyetje të shkurtër mund ta bëni pyetjen ose

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 34

1 përndryshe do të bëjmë pushim.

2 Dëshmitar, do të bëjmë pushim prej 10 minutash. Do vini
3 përsëri në sallë pas 10 minutash. Domethënë, në orën 10.10.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
6 pushim deri në orën 10.10.

7 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

8 --- Seanca rifillon në orën 10.10

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
10 Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
13 tani do vazhdojmë më tej me pyetjet e z. Misetic, avokati i z.
14 Thaçi.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
16 Kryegjykatës.

17 PY. Dëshmitar, diskutuam lidhur me marrëdhënien e familjes
18 tuaj me z. Thaçi. Tani dëshiroj që të flasim lidhur me
19 marrëdhënien e familjes tuaj me disa persona të tjerë.

20 Është e saktë, apo jo, Dëshmitar, që familja juaj ka qenë
21 në një konflikt afatgjatë, në një konflikt që është shtrirë në
22 kohë me Rexhep Selimin? A është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Nuk e di çfarë konflikti. Spjegoma pak. Unë s'po e
24 kuptoj.

25 PY. Patjetër. Të fillojmë nga fillimi. I keni dëshmuar ZPS që

1 fillimisht ka pasur një problem, pra, ju keni pasur një
2 problem me Rexhep Selimin në Jabllanicë sa i takon furnizimit
3 me armë. A është e saktë kjo?

4 PË. Asnjë problem s'e kemi pas. A kon një mashtrim, jena kon
5 tanë unikë. I kam besu, s'u dalë q'ashtu. Kurr gjë s'ka të
6 keqe. S'a konflikt i madh ajo. S'a kurr gjë.

7 PY. Në rregull. Ju e keni parë intervistën që ka dhënë z.
8 Selimi në 1999 duke thënë që, që e ka thënë domethënë që 1998
9 vëllai juaj, Ganiu është përpjekur që ta vriste atë. Të
10 paktën. Mënyra si e ka parë z. Selimi është që ka pas një lloj
11 konflikti midis jush, apo jo?

12 PË. Na kemi pas mendime rreptësisht të kundërtata. Ai ka qenë
13 përfaqësues i LPK-së, ne kemi përfaqësues i shtetit i LDK-së.
14 Edhe mendime kemi pasur të kundërta gjithë. Me Rexhep Selimin
15 jam taku disa herë edhe në Llaushë kam pas mendime krejt të
16 kundërta. S'a konflikt që ke mendim të kundërt, as luftë.

17 PY. Kur dikush përpiqet që të vrasë dikën tjetër, kjo shkon
18 përtej mosmarrëveshjeve që mund të kenë pas këto persona për
19 çështje polikë, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Shiqo, edhe një herë kam thënë, ato intervistë që e ka
21 dhënë Rexhep Selimi ka gabu. Besoj që e pranon vetë që ka
22 gabu. Unë mendoj që duhet me e pranë që ka gabu. E këto të
23 tjerat e këto të tjerat u panë edhe po shihen kush, ça, qysh.
24 Unë kam mendim të kundërt me Rexhep Selimin. Rreptësisht, ai
25 ka qenë, ai është i majtë përfaqësues i LPK-së, unë jam i

1 qendrës së djathtë, përfaqësues i LDK-së edhe i 90 për qind të
2 popullit të Kosovës.

3 PY. Në rregull. Tani do kërkoj që të paraqitet intervista e
4 z. Selimi, që në seancën përgatitore numër 2, në paragrafin
5 11, ju pretendoni në këtë intervistë që ai ka "përsëritur e
6 fjalët e Hashim Thaçit". Kështu që le të shikojmë se çfarë ka
7 përsëritur ekzaktësisht ai.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares që të
9 paraqesë në ekran provën P1749.

10 PY. A ju kujtohet që e keni parë këtë artikull dje,
11 Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të
14 kalojmë në faqen 7 në anglisht të versionit në PDF. Ndërkohë
15 që të shqip fillon -- po. Mendoj që mund ta shikoni këtu siç
16 është, aktualisht është e shfaqur në ekran. Megjithatë, do të
17 vazhdojmë në faqen 7 në versionin anglisht. Pikërisht këtu.

18 PY. Në mes të paragrafit thuhet:

19 "Vrasja e komandantit Sandokan është një ndër vrasjet
20 tradhtare që janë të ngjashme me persona të tjerë ku historinë
21 ku tradhtarët vrasin burra me emër."

22 Pra, ju thoni që ai ka përsëritur fjalët e Hashim Thaçit.
23 Kur i ka thënë këto fjalë Hashim Thaçi, Dëshmitar?

24 PË. Hashim Thaçi i ka thonë në Komunikatën 59. Këto fjalë i
25 ka thënë në Komunikatën 59. Këto fjalë të Rexhep Selimit

1 komandantit Sylejman Selimi i ka demantue, e ka djalë të
2 mixhës Rexhën. Ka thënë "ka gabu, se nuk është ashtu çka ka
3 thon". Edhe falënderojmë komandant Selimin që ka thënë një të
4 vërtetë me shokë të Drenicës. Edhe nuk mendoj ka diçka tjetër.
5 Ky ka fol fjalët e Hashimit. Që ka gabu që ka fol, edhe e ka
6 vërtetu që ka gabu kur ka thon që këtë komunikatë nuk është
7 dashtë me i shkru. Edhe mjafton me kaq.

8 PY. Baza e vetme që keni ju është prezumimi ose mendimi që
9 keni ju personalisht që Komunikatën 59 e ka shkruar Hashim
10 Thaçi, kështu, Dëshmitar?

11 PË. Jo mendimi që them unë, po unë besoj që nuk ka mo ç'ka me
12 bisedu në atë drejtim kush e ka shkru. Komunikatën 59 e ka
13 shkru me dorën e vet Hashim Thaçi.

14 PY. Do kalojmë edhe te kjo temë për pak. Megjithatë, në faqen
15 tjetër që:

16 "Unë personalisht kam qenë përballë rrezikut se personi
17 që ka vrarë Abedin Rexhën më ka sulmuar mua, më ka bërë sulm
18 mua për të më marrë jetën time, në të njëjtin vend që është
19 vrarë edhe Abedini."

20 A është e saktë, Dëshmitar, që Gani Geci është përpjekur
21 që të vrasë Rexhep Selimin?

22 PË. As -- unë nuk besoj që është e vërtetë. Pyetni Ganiun kur
23 të vjen.

24 PY. Në rregull. Megjithatë, z. Selimi pa diskutim që mendon
25 që kështu ka qenë edhe përsëri për t'ju kthyer aspektit që po

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 38

1 të pyesja më përpara, marrëdhënia ndërmjet z. Selimi dhe
2 familjes tuaj nuk ka qenë një marrëdhënie e mirë për një
3 periudhë të gjatë kohe. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
4 PË. Jo. Nëse më leni një minutë, Kryetar, unë e spjegoj në
5 detale. Një minutë nëse ma jep. Kryetari i Gjyqit, ju lutem.
6 PY. Do t'ju tregoj një dëshmi tjetër dhe pastaj të shohim në
7 qoftë se kjo dokumenti që do ju tregoj do të ndryshojë
8 opinionin.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
10 përgjigjuni pyetjeve që ju bën avokati.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem paraqisni në ekran provën
12 P760.

13 PY. Është një dokument që ju tregua nga Prokurori gjatë
14 seancës përgatitore. Dhe informacioni lidhur me të pasqyrohet
15 përfaqësues 10 të Shënimit Përgatitor.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Numri i faqes është P076627.

17 PY. Më 4 mars 2006 [Sipas përkthimit], Rexhep Selimi e quante
18 vëllain tuaj, Gani Gecin si vrasës serial. Ju jeni në dijeni
19 të kësaj, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Është këtu po thotë që e paska quajt ashtu edhe në bazë
21 të komunikatës ndryshe s'ke mujt me e qujt.

22 PY. Ta marrim hap pas hapi. Së dyti -- së pari, vëllai juaj
23 Gani ka qenë i dënuar më përpara, apo jo, për vrasje?

24 PË. Kur?

25 PY. Edhe sot e kësaj dite ai ka qenë i dënuar për vrasje më

1 përpara, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Kur ma përpara ta kem të kjartë se Ganiut, vëllaut i kanë
3 ndodhë do raste te improvizime prej këtij grupi që kanë tentu
4 me e vra dhe u mbrojt edhe e ka mbajt dënimin. Është dënu tri
5 vjet e gjysë e kam mbajt dënimin, ka vepru në vetëmbrojtje nga
6 një grup i mirëorganizuar dhe i paguar nga ky shtab, nga këta
7 njerëz, nga ky njeri këtu që është sot. Ka qenë bashkëpunëtor
8 i ngushtë i tij, vrasësi.

9 PY. Vëllai juaj është dënuar për vrasjen e Ruzhdi Shaqirit. A
10 është e saktë kjo?

11 PË. E saktë.

12 PY. Pra, ai është dënuar më përpara për vrasje. Këtë të pyeta
13 dhe t'i u përgjigje "po, që është dënuar për vrasje më
14 përpara". Dhe z. Selimi këtë e thekson që në vitin 2016,
15 domethënë është diçka të cilën e thotë në 2016-n që ju është
16 treguar dhe tek materiali që keni përpara në ekran.

17 PË. Po.

18 PY. Në atë kohë ti e ke ditur që z. Selimi dhe vëllai juaj
19 kanë pasur marrëdhënie armiqësore me njëri-tjetrin. A është e
20 saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Edhe një herë, "marrëdhënie armiqësore" mu po më duket
22 pak shumë, derisa unë familjen e tijna, Vesel Selimin e kam
23 pas, e kam pas veprimtar, kryetar. Une kam qenë udhëheqësi i
24 tijna në [E pakuptueshme] unë kam qenë udhëheqësi i tijna dhe
25 ai u plagu në Prekaz. Dhe kam fjalë të mira edhe për vëllaun e

1 Rexhep Selimit, Danin, kam fjalë të mira se më ka dho bukë.
2 Kam hongër bukë në shtëpi tija. Derisa ai ka fol kështu, ka
3 gabu shumë. Rëndë ka gabu, edhe i din që gabimet është mirë që
4 me dalë publikisht që me thanë para teje këtu, para juve me
5 kërku falje për këto punë. Është mirë Rexha me dalë me kërku
6 falje, se gabim a kon që ka thonë këto fjalë, ka gabu.
7 PY. Kur them "marrëdhënie armiqësore", pra të thuash
8 publikisht që vëllai juaj është vrasës serial, kjo në vetvete
9 a nuk do të thotë që ai nuk është se ka ndonjë opinion pozitiv
10 ose të mirë për vëllain tuaj?
11 PË. Gabim shumë i madh. Është gabim shumë i madh i Rexhep
12 Selimit. A kon i idhnushëm ka mendu gjithçka po gabim o.
13 Gabim, qe ku o këtu le të del e të thotë që është gabim. Është
14 ma mirë para opinionit "Kam mendu po s'ish kon ashtu, ish kon
15 gabim". Unë e kërkoj le të del është ma mirë. Është në interes
16 të tanëve. Dhe të tija të punës së tij që e ka bo.
17 PY. Në rregull. Sa i takon z. Krasniqi, ju këtë temë e cekët,
18 e diskutuat me Prokurorinë dje. Nuk dua që ta shtjelloj në
19 imtësi, megjithatë në vitin 2006, në librin e vet z. Krasniqi
20 thotë që Abedin Rexha është vrarë nga duart e një kriminelit që
21 është tradhtar dhe që është i pandershëm, i pabesë. A ju
22 kujtohet që jetë diskutuar kjo dje?
23 PË. Po. Shumë mirë e kam pa. Edhe kurrëgjë tjetër s'kam prit
24 prej kësaj grupit. Tona po i sheh në seli, ky, ky, ky, kanë
25 thonë për Ganinë q'ashtu për ne. Pse? Një rrenë e kanë thonë

1 me na likujdu me na hjek pej organizimi. Kanë gabu shumë. Do e
2 kanë pa që kanë gabu, e kanë thonë të vërtetë, edhe kjo mirë.
3 Do të thotë mirë është të thonë të vërtetë. Më mirë është tash
4 se ma vonë. Ma mirë a kon ma herët me dalë me kërkë falje dhe
5 me thonë nuk është kjo komunikatë e jonia. Na kish bo nder
6 krejt UÇK-së dhe shqiptarisë, jo me na pru këtu e ma kuq
7 familjen e -- me na pru në këtë gjendje.

8 PY. Përsëri ju po përsërisni diçka që e keni thënë në seancën
9 përgatitore me Prokurorinë. Dhe në fakt e keni thënë tre herë
10 në seancën përgatitore. Është pasqyruar në Shënimin Përgatitor
11 2 në paragrafët 14, 16 dhe 17, që ju akuzoni z. Krasniqi që
12 gënjen në librin e vet në pika të ndryshme të atij libri sa i
13 takon vëllait tuaj. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Kjo është e saktë, që Jakup Krasniqi është historian edhe
15 ka shkru të pavërteta. Ka shkru të pavërteta. Thotë mënjanimin
16 dhe dje nuk e kam dhon këtë përgjigje po unë po ja u dho sot
17 nëse më lejon Gjyqtari. E ka thon -- eliminimin e njerëzve ma
18 eminentë të LDK-së. Njerëzit ma eminentë të LDK-së ai ka menue
19 te njerëzit që s'e ka marrë asnjë votë në fshat të vetin. E ai
20 njeri që s'e ka marrë asnjë votë në fshat të vetin e ka këqyr
21 me ardh atje delegat është Gani Koca. Për të ka pas fjalën, e
22 nuk e ka shkru drejt, po ka shkru rrena. Nuk i takon me shkru
23 rrena [E padëgjueshme].

24 PY. Vazhdojmë me diçka tjetër. Në rregull. Vëllai juaj ka pas
25 një marrëdhënie problematike edhe me Fatmir Limën apo jo? Nuk

1 ka pas marrëdhënie të mira as me të. A është e saktë kjo,

2 Dëshmitar?

3 PË. Krejt grupi i LPK-së a kon kundra vëllazërve Geci. Po

4 dikush e ka pa e ka kërku falje, është mirë. E ai që ka kërku

5 falje që o dal e i ka ra pishman, faleminderës. Ai që s'i ka

6 ra pishman e ka shkru Komunikatën 59 ka gabu rëndë. Rëndë ka

7 gabu. Me histori ka gabu që s'do t'ia fali historia, me e fy

8 një familje si familjen tem, nuk ja fal historia.

9 PË. Në rregull. Të shohim atë çfarë i ka thënë vëllai juaj,

10 Gania, ZPS-së në vitin 2017.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares

12 të paraqesë në ekran dokumentin nga 055803 deri në 055808.

13 PY. Pra kjo është diçka që i ka thënë vëllai juaj ZPS-së në

14 prill 2017 sa i takon marrëdhënies me Rexhep Selimin, Jakup

15 Krasniqin dhe Fatmir Limajn. Është një shënim zyrtar kontakti

16 që ata kanë pasur me vëllain tuaj, Ganiun.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Kështu të do kalojmë në paragrafin

18 11 të këtij dokumenti. Po ashtu do i kërkoja Sekretare të

19 kalojë në të njëjtin paragraf edhe në shqip.

20 PY. Vëllai juaj thotë si më poshtë:

21 "Gani Geci deklaroi se nuk ka asnjë problem të kundër

22 udhëheqësve politikë pasi ai është akuzuar në mënyrë të rreme

23 si tradhtar në Komunikatën 59, pavarësisht se nuk kishte prova

24 mbështetëse. Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi që ishin

25 pjesëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së e quajtën atë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 43

1 tradhtar në atë kohë. Rexhep Selimi e quajti Gani Gecin
2 tradhtar në vitin 1999 në Radio Rilindja, ndërsa Jakup
3 Krasniqi e quajti tradhtar atë në Drenicë. Tani ata po thonë
4 se ai nuk ishte tradhtar. Fatmir Limaj kohët e fundit për herë
5 të parë pas 15 -- 18 vjetësh foli në mënyrë pozitive për
6 Gecin. Gani Geci deklaroi se nëse ZPS-ja do të zbulonte të
7 vërtetën lidhur me Komunikatën 59, ky do të ishte çelësi për
8 zbulimin e vrasjeve të tjera.”

9 Të ndalojmë këtu për një çast, Dëshmitar. Sipas vëllait
10 tuaj, Fatmir Limaj, nuk kishte thënë asnjë fjalë të mirë,
11 asnjë gjë pozitive për 18 vjet. Dhe për herë të parë filloi që
12 të fliste pozitivisht diku rreth vitit 2017. A pajtohet kjo me
13 atë çfarë ju kujtohet juve lidhur me këtë marrëdhënie,
14 Dëshmitar?

15 PË. Kanë fillu me fol tanë dikur. Krejt këta kanë qenë një
16 vend. Komplet një vend. Tanë na kanë fy. Disa mujn mos me i
17 ditë, se nuk e kanë ditë e me siguri s'e kanë dit edhe kanë
18 fillue me fol të vërtetën. Edhe mirë që po e flasin të
19 vërtetën. I falënderoj të gjithë ata. Edhe Fatmir Limën që
20 paska thonë atë fjalë, atë pozitiv. Mirë boll. Se q'ashtu a
21 kon e vërteta është duhet me fol tan poziv për vëllazënit
22 Geci, se as dhe një prej këtyre nuk kanë bo punë ma të madhe
23 për interesin kombëtar shqiptar se vëllazit Geci. Familja
24 Jashari janë një, mbas tyne janë vëllazënit Geci, këta janë
25 shumë, shumë ma mbrapa. Që respekt për çdo punë kush e ka bo

1 për mirë. As dhe një për të keq, kurrkujt.

2 PY. Pajtohem me ju që menjëherë papritmasi të gjithë filluan
3 filluan të flisnin pozitivisht me Ganiun. Kjo është një
4 përputhje me atë që sapo na thatë, Dëshmitar, apo jo?

5 PË. Ka fillu me fol edhe Hashimi ka fol, po ka rrejt. Ka fol
6 mirë s'ka si ata, si burra ma të mirë s'ka [E padëgjueshme].

7 PY. Hashimi, sikurse e thamë dhe më herët, ju vite më përpara
8 sesa kaq e keni përdorur si ndërmjetës për mosmarrëveshjen që
9 keni pasur me Azem Sylën. Kështu që keni pasur një lloj
10 marrëdhënie të një farë respekti të paktën, në qoftë se e keni
11 përdorur atë si ndërmjetësues për të zgjidhur mosmarrëveshjen
12 që keni pasur me Azem Sylën.

13 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Ose duhet që të bëhet
14 pyetje ose nuk është e nevojshme që të bëhen shtjellime
15 editoriale.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
17 Mund të vazhdoni.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë te paragrafi 21.

19 DËSHMITARI: Une për me përfundu para Gjykatës rreth
20 rastit çka ka thonë Gani Geci, pyt ata, mos më pytni mu.

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Më lejoni t'ju bëj unë pyetjen njëherë, pastaj
23 përgjigjuni.

24 PË. Ju flisni shumë lidhur me atë çfarë keni dëgjuar nga Gani
25 Geci e për këtë arsye po ja u bëj pyetjet, Dëshmitar.

1 PË. Nuk janë [E pakuptueshme] për mu hiç, veç ai, ai t'i
2 thonë vetë këtu. Krejt çka kam thonë une, t'i thotë vetë. Pyete
3 t'i atë, gjyqtari.

4 PY. Në paragrafin 21, vëllai juaj thotë këtë në prill 2017,
5 duke filluar nga fjalia e tretë:

6 "Kur u pyet se për ku e donte e donte, Geci thotë që ai
7 dëshironte të dinte se kush e kishte shkruar Komunikatën 59,
8 të cilën ai e konsideronte si kryesore për të gjitha gjërat e
9 këqija që i kishin ndodhur familjes së tij. Vëllai i tij mbeti
10 i plagosur më pas. Geci thotë që Milaim Zeka i kishte thënë
11 atij, pra i kishte dhënë informacion atij që komunikatën e
12 kishte shkruar Hashim Thaçi."

13 A e shikon këtë, Dëshmitar?

14 PË. Hiç këtu, hiç këtu as i shikoj as janë të miat. Ato t'i
15 thotë Gani Geci vetë ty kur të vjen.

16 PY. Në rregull. Ajo çfarë po them unë është që informacioni
17 nga Milaim Zeka mund t'i jetë dhënë vëllait tuaj në prill 2017
18 ose përpara prillit 2017. E pranoni ju këtë, Dëshmitar?

19 PË. Ato që janë data janë data. Ganiu ja u thotë gjitha këto
20 kur të vjen këtu nëse ju vyn.

21 PY. Të vazhdojmë më tej. Të shohim rrethanat politike në atë
22 kohë ndërmjet këtyre individëve.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoj Sekretares që
24 të paraqesë në ekran dokumentin DHT004429 deri në DHT04430.

25 PY. Është një artikull nga interneti, pra është një publikim

1 në internet që quhet *Balkan Insight*, mban datën e marsit 2014,
2 dhe raporton për një parti të re politike që krijohet nga
3 Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj. A keni qenë në dijeni ju se
4 Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj kanë krijuar partinë e tyre
5 politike në mars 2014, Dëshmitar?

6 PË. Këto janë kon publike, për opinion publik. Krejt Kosova e
7 din ato kur janë përça ndër vedi për interesa të veta. Ata e
8 dinë. Janë publike ato. Une s'jam në këto hiç, s'un më
9 interson fort kjo punë.

10 PY. Të shohim se çfarë dini ju. Të fillojmë me paragrafin e
11 parë që thotë:

12 "Ish-komandanti i UÇK-së Fatmir Limaj dhe ish-sekretari i
13 UÇK-së kanë krijuar një parti, një forcë të re politike për të
14 sfiduar Partinë Demokratike të Kosovës në pushtet."

15 Po të kalojmë më poshtë thotë që:

16 "Ish-komandanti Limaj, është, ka qenë një nga aleatët më
17 të ngushtë të Hashim Thaçit, por marrëdhënia e tij me ish-
18 bosin e mëparshëm filloi të prishej në nëntor 2012, kur
19 misioni i BE-së në Kosovë, EULEX-i, bëri padi lidhur me krim
20 të organizuar dhe korrupsion kundër Limajt."

21 Dy paragrafë më poshtë thuhet:

22 "Si shenjë e ndarjes me Thaçin, Limaj mbështeti
23 publikisht një parti të vogël të quajtur Iniciativa Qytetare
24 për Malishevën në zgjedhjet e fundit lokale në nëntor 2013."

25 A e keni ditur që z. Thaçi dhe z. Limaj janë ndarë në

1 2013 për të shkak të akuzës që ka bërë EULEX-i?

2 PË. Une ma mirë se këta vetë nuk i di kurrkush. Këta vetë i
3 dinë. Të dytë, të dy palët. Dhe a kon kjo publike. Kjo publike
4 mund me kon edhe rrenë. Unë nuk muj, une po të them nuk e di.
5 nuk e di ça ka pas. Hiç s'më ka interesu me u merr me ta hiç.

6 PY. Po të kalojmë në fund të faqes, thotë që:

7 "Partneri i Limajt, Krasniqi, kryetari aktual i
8 Parlamentit të Kosovës, u largua nga PDK-ja e Thaçit në shkurt
9 të vitit të kaluar dhe muajin e kaluar kritikoi atë që ai e
10 quajti 'mungesë e demokracisë'."

11 E keni ditur që edhe z. Krasniqi është ndarë nga z.
12 Thaçi?

13 PË. Aty janë kon, janë kon publike në opinion janë kon
14 publike.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, e paraqes këtë
16 dokument.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
18 kundërshtim?

19 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
21 DHT04429 deri në DHT0443 [Sipas përkthimit] pranohet.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të ketë numrin
23 ID00197 [Sipas përkthimit] dhe është e klasifikuar si publik.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të na shfaqni në ekran
25 materialin DHT04408 deri në DHT04409, ju lutem.

1 PY. Dua t'ju tregoj një artikull tjetër, Dëshmitar, nga viti
2 2017. Është afërsisht koha kur vëllai ka folur me Prokurorinë
3 në prill 2017. Dhe thotë:

4 "Jakup Krasniqi i lë vend Milaim Zekës."

5 Dhe duke u bashkuar me partinë e krijuar nga z. Krasniqi
6 dhe Limaj ai thotë që:

7 "Iniciativa është prezantuar -- ka prezantuar anëtarin më
8 të ri Milaim Zekaj.

9 "Iniciativa për Kosovën është -- i është bashkëngjitur
10 Milaim Zeka."

11 Pyetja që kam: A e keni ditur ju se Milaim Zeka dhe
12 Hashim Thaçi ishin pjesë e të njëjtës parti politike?

13 PË. Edhe një herë të lutem ma ngadalë.

14 PY. Pra, e dini dhe është e qartë nga intervista se Milaim
15 Zeka ishte personi që i tha vëllait tënd se Jakup Krasniqi,
16 Fatmir Limaj dhe Rexhep Selimi akuzonin Hashim Thaçin se
17 kishte shkruar Komunikatën 59, kështu?

18 PË. Ganiu e ka të incizum, ai ja u shpjegon. Unë nuk di ma
19 tepër.

20 PY. Në rregull. Pyetja tjetër që kam është: Në atë kohë e
21 keni ditur se Milaim Zeka ishte bashkuar me të njëjtën parti
22 politike si Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj?

23 PË. Edhe një herë, këta persona që mi përmende të gjithë
24 janë, të gjithë janë të LPK-së, të një organizimi, të një
25 organizate Marksiste-Leniniste.

1 PY. Nuk ishte kjo pyetje ime. Nuk ishte kjo pyetje që ju
2 bëra.

3 PË. Një ideologji.

4 PY. Ne e dimë që nuk ju pëlqeni, nuk i pëlqeni Marksist-
5 Leninistët, nuk keni nevojë ta përsërisni. Pyetje ime ishte
6 shumë e thjeshtë. Jakup Krasniqi pra, e keni ditur që Milaim
7 Zeka i është bashkëngjitur të njëjtës parti si Jakup Krasniqi
8 dhe Fatmir Limaj? E keni ditur këtë në 2017?

9 PË. Po e shoh, q'tash po e lexoj që q'ashtu koka kona. Se
10 s'është ajo diçka. Po e di q'tash që ashtu koka kon. Q'ktu po
11 shkrun. Normale. Ka të drejtë ku duhet me ju bashkangjit.
12 Është e drejtë e tijna. Unë besoj ka të drejtë.

13 PY. Pra po thua që e di tani. Po në 2017 e ke dit?

14 PË. Hiç s'jam merr me atë punë une fort, hiç. Unë jam largu
15 prej politike në 2010-2011, mo hiç s'më ka interesu hiç, as me
16 u merr me ta hiç.

17 PY. Atëhere nuk e ke ditur as që Jakup Krasniqi e ka lënë
18 vendin e tij në Parlament Milaim Zekës?

19 PË. Ato janë interesa të tyne aty ça kanë bo, qysh i kanë bot
20 ato vetë. Këto s'janë punë për mu hiç. Hiç nuk di. As du me
21 di. As nuk merrna me këto punë hiç kurrë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, e paraqis edhe këtë
23 dokument si provë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
25 kundërshtim?

1 Z. PACE: [Përkthim] Po. Kundërshtojmë sepse dëshmitari
2 nuk ka dijeni për përmbajtjen e dokumentit dhe nuk është në
3 gjendje të japë mendimet e tij. Gjithashtu edhe rëndësia e
4 dokumentit nuk është e qartë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe unë vet
6 nuk jam shumë i qartë për rëndësinë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Sepse ka tre veta që -- të një
8 partie që bëjnë akuza ndaj Thaçit. Në të njëjtën pra, parti
9 politike.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
11 DHT040 --4408 deri në DHT04409 pranohet.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
13 numrin si provë 1D00198.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Z. Geci, e keni ditur që Rexhep Selimi ishte anëtar i
16 partisë Vetëvendosja në 2017? E keni ditur?

17 PY. Edhe një herë, unë e di që Rexhep Selimi ka lëviz pak a
18 kon një herë në AAK, tani ku është fort nuk jam merr, po ju
19 them, me këto punë hiç.

20 PY. Përgjigja është që nuk e keni ditur që ka qenë anëtar i
21 Vetëvendosjes, kështu?

22 PË. Nuk e di unë në ato punë, hiç s'jam merr me ato punë. Unë
23 veç e di që qëta kanë qenë bashkë tanë. Që kjo ka qenë një
24 lëvizje një LPK. Q'kjo e di, edhe e di kush e shkru
25 Komunikatën 59, qysh e di dhe ti dhe Gjykata edhe kush e ka

1 shkrujt.

2 PY. Mjaft. Nuk ishte kjo pyetje. Vetëvendosja, a e njihni
3 këtë parti?

4 PË. Po more.

5 PY. Keni dëgjuar për të?

6 PË. Qysh jo.

7 PY. A është -- a mund të themi që z. Thaçi dhe PDK-ja janë
8 kundërshtarë politikë të Vetëvendosjes?

9 PË. Shiqo, këto kundërshtarët politikë nëse i merrim na ashtu
10 janë është ashtu, mund me kon kundërshtarë politikë, po kanë
11 thonë një të vërtetë, pa marrë parasysh tash, u bashk don me
12 kon ça thotë, si të bohet tjetër parti me thonë e kam pa si o
13 kon në parti, me i ndërru. Koka lehtë ajo. Veç dil në tjetër
14 parti, e kam pas për këtë mendim, t'i po thu? Se unë tjetër
15 parti, unë tash po thotë. Kjo s'ka kurrfarë kuptimi. Jo,
16 qëllimi i juv ça po thu, mu po më duket sikur [E pakuptueshme]
17 pa kuptim. Krejt pa kuptim po i thu. Se është kollaj koka dil
18 në tjetër parti e thuj "jo s'kam thonë, se [E pakuptueshme]
19 kon ti kundërshtar politik, kam thonë". Nuk s'ka asnjë kuptim.

20 PY. Të shohim -- të shohim, ta shohim këtë dhe atë që ka --

21 PË. Këto janë --

22 PY. -- dhe atë që ka thënë vëllai. Një minutë. Të shohim ç'ka
23 thënë vëllai jot.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem shfaqni në ekran 0785

25 [Sipas përkthimit] Pjesa 2 RED3, në faqen 22 në anglisht, dhe

1 në faqen 19 rreshti 24 në versionin shqip.

2 PY. Dua t'ju tregoj atë që i ka thënë vëllai ZPS-së lidhur me
3 atë që ndodhi kur ai foli me z. Selimi për autorin e
4 Komunikatës 59, pra kush e kishte shkruar këtë komunikatë.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mund ta përsërisni
6 faqen e dokumentit në anglisht se sikur thatë 22 po
7 transkripti ka vetëm 21 faqe.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Një minutë.

9 Në shqip është e saktë, në rreshtin 19? Në anglisht është
10 faqja 15. Ndjesë.

11 PY. Atij e fillon dhe thotë:

12 "Kur Hashim Thaçi po më pëshpëriste në vesh se komunikata
13 ishte shkruar nga Rexhep Selimi, vëllai im [Redaktuar] u takua
14 me Rexhep Selimin në teatër."

15 PË. Cili vëlla i tijna? Unë jam Fadili. Unë për vete flas.

16 Nëse jam taku unë le të thotë këtu që jam taku.

17 PY. Në rregull. Vazhdon:

18 "Vëllai im i tha se t'i je nga fshati Açarevë, unë jam
19 nga fshati [Redaktuar]."

20 "Ai thotë ... nuk do të jetë e mundur që të dy familjet
21 tona të jetojnë bashkë në Drenicë duke e ditur që në
22 komunikatë ke thënë që familja jonë ka udhëhequr ofensivën
23 serbe."

24 Z. PACE: [Përkthim] Versioni në ekran nuk është i
25 redaktuar. Emri është aty.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Tani më thonë që Halili, bëhet fjalë për Halilin.

3 PË. Unë jam Fadili. Pyete Fadilin.

4 PY. Kuptoj. Nuk ishte -- nuk ishte ky qëllimi. Nuk po them që
5 jeni ju ai vëllai që përmendet këtu që ka folur me Rexhep
6 Selimin. Dua të vazhdoj. Halili, vëllai thotë që:

7 "Nuk do të ishte e mundur që të dy familjet tona të
8 jetonin bashkë në Drenicë duke e ditur që në komunikatë ke
9 thënë që familja jonë po drejtonte ofensivën serbe. Nuk mund
10 të ndodhë kjo gjë, nuk mund të jetojmë së bashku."

11 Përpara ju pyeta për armiqësinë midis Rexhep Selimit dhe
12 familjes tuaj. A e keni ditur ju që vëllai Halil i ka thënë
13 këto Rexhep Selimit mbas informacionit të marrë nga Hashim
14 Thaçi se ai e kishte shkruajtur këtë Komunikatën 50 dhe se
15 vëllai i ka thënë, "Nuk mund të jetonin bashkë të dy familjet
16 në Drenicë për këtë arsye".

17 PË. Une nuk e di çka ka thënë Halili, po unë jam Fadili. Edhe
18 Fadili po e thotë që është vështirë këto dy familje me qenë
19 aty në këtë formë, derisa nuk komunikohet -- nuk vërtetohet
20 komunikata. Ne i jemi drejtuar Gjykatës, i nderuar. Ju presim
21 nga ju me e thonë të vërtetën dhe aty marrim frymë
22 pozitivisht. Unë jam Fadili e them këtë. Jo çka thotë Halili.
23 Halili nuk flas unë me fjalë Halilit - fjalë të Fadilit jam
24 këtu.

25 PY. Në rregull. Pra, pyetja është kjo: A je tu thënë që as

1 Ganiu as Halili nuk të kanë thënë që kanë biseduar me Rexhep
2 Selimin?

3 PË. Nuk jam une i informum. Ata pyeti kur të vijnë. Cilin të
4 dujsh, që t'ju vijnë, thirre, fill vijnë.

5 PY. Në rregull. Vazhdon, thotë që, vëllai, po flet Ganiu:

6 "Mund të pyesi vëllain tim, Halilin, se çfarë u tha
7 saktësisht në atë bisedë. Sepse këto gjëra unë i kam dëgjuar
8 nga vëllai."

9 Pyetja: "Cili vëlla?"

10 "Halil Geci", përgjigja.

11 Pastaj vazhdon:

12 "Rexhep Selimi i tha Halilit se ishte Hashimi ai që e
13 shkroi komunikatën. Kur e pyeti -- kur u pyet Selimi se kush e
14 shkroi komunikatën ai filloi të reagojë. Me siguri ka folur me
15 Milaim Zekën për të. Pastaj Milaim Zeka na tha se komunikata
16 është shkruar nga Hashim Thaçi. Dhe për këtë dëshmitar është
17 Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj. Këta të tre
18 persona i kanë thënë Milaim Zekës se Hashim Thaçi ishte ai që
19 e shkroi komunikatën."

20 Mesa kuptoj unë nga fjalët që thotë vëllai ishte Hashim
21 Thaçi që tha në fillim se Rexhep Selimi e kishte shkruar
22 komunikatën. Vëllai jot Halil, e pyeti Rexhep Selimin për këtë
23 gjë dhe Rexhep Selimi, ose drejtpërdrejtë ose nëpërmjet Milaim
24 Zekë, s e kundërakuzoi Hashim Thaçin se e kishte shkruar ai.
25 Kështu e ke kuptuar ti? A janë bërë këto akuza, a janë

1 shkëmbyer këto fjalë?

2 PY. Ata pyti. Unë po e them, këto pytëm mu unë ju tregoj.

3 PY. Pra, t'i deri sot nuk e ke ditur këtë kronologji të
4 ngjarjeve se kush e bëri akuzën i pari, kush iu përgjigj
5 akuzës. Pra, nuk di asgjë për këto?

6 PË. Unë krejt ça ka dit i kam thonë ZPS-së edhe këtu
7 Gjykatës. Le të më pyt, këtu jam. Ato ça thojnë tjetër, pa ka
8 thonë ky, e ça ka thonë ai, ata vijnë vetë thojnë.

9 PY. Po vë re se vëllai ka thënë dhe se rreth dhe t'i e the se
10 rreth vitit 2017 të gjitha personat, Jakup Krasniqi, Rexhep
11 Selimi, Fatmir Limaj, befas filluan të flasin mirë,
12 pozitivisht për Ganiun, kështu? Dhe pyetja që kam për ju
13 është: Në këtë situatë kur thotë "ai tha, ajo tha, ky tha" ti
14 vendose të besosh që Hashim Thaçi e shkroi komunikatën edhe
15 pse përpara këtij fakti nuk ke pasur mosmarrëveshje me Hashim
16 Thaçin dhe në vend të kësaj, besove fjalët e tre personave me
17 të cilët s'kishte pasur ndonjë punë për gjithë këto vite?

18 PË. Jo. unë e besova ditën që kam shku në shtëpi të tij, që
19 Hashim Thaçi e ka shkur komunikatën, edhe nuk e kthej
20 përgjigje 20 vjet. Kjo është ajo mendimi im. Ditën që i kam
21 shku në shtëpi, e kam dit që ai e ka shkru, edhe vetëm ai. Une
22 kam pas këtë besim edhe ashtu më ka dalë.

23 Nuk kam besu që tjetërkush mund të shkrun ashtu, veç ajo
24 shtëpi e ajo familje, e ai djalë i asaj familje, që është
25 zgedh me përfaqësu, djali ma i ligë i Drenicës. Që s'ka

1 histori familjare. Që s'ka cung. Që s'ka bo kurrqjo për
2 shqiptari. Që një pulë s'e ka dëmtu për shqiptari në histori.
3 E kam dit që ai mund të bo ashtu. E kam dit që ai mund të bëjë
4 ashtu. Unë e kam ditë këtë, une, une q'ky q'tu që o. Jo ça
5 kanë thonë këta se s'merrem me këta të tre hiç une.
6 PY. Pra ti thua që shkove të takosh babain e z. Thaçi. Kush e
7 provon këtë? A ka dëshmitarë? Më thuaj emrat e ndonjë njeriu
8 që mendon që mund t'i thërresim këtu dhe të dëshmojnë që t'i
9 ke shku në shtëpinë e babait të Thaçit?
10 PË. Unë në shpi të babait të Thaçit ka qenë vëllavi i tijna,
11 Gani Thaçi edhe baba i tij. Më kanë njoft mu, se unë jam kon
12 veprimtar i Drenicës, më kanë njoft mirë. Edhe i kam kërku nga
13 ata që për një afat një muj ditë me më tregu se ku e kanë
14 marrë informatën për Gani Gecin që e din Drenica, shqiptaria
15 kush o Gani Geci.
16 PY. Kaq. E di këtë. por po pyes për diçka tjetër. T'i
17 pretendon që Gani Thaçi, babi i z. Thaçit, kush tjetër mund ta
18 konfirmojë që t'i ke shkuar në shtëpinë e tij lidhur me
19 Komunikatën 59.
20 PË. Ka qenë me mue, ka qenë me mue deri afër Nezir Lizi, një
21 Nezir Lizi ka qenë me mu, Nezir Lizi. Nezir Kotori. Ka qenë me
22 mue deri aty dhe i kam tregu që une drejt në shpi të Hashimit
23 q'tash edhe jam shku. Fatkeqësisht Nezir Lizi tash është i
24 vdekun, po ka qenë një burrë shumë i mirë edhe një familje
25 shumë e mirë në atë terren.

1 PY. Pra, a s'ka njeri të gjallë përveç Gani Thaçit, babait të
2 z. Thaçit që mund ta provojë?

3 PË. Kjo është e vërteta. Le ta thotë ky që s'është q'ashtu.
4 Q'këtu e ki.

5 PY. Po të kërkoj vetëm emra të thuash, nëse ka.

6 PË. T'i dhashë une. Unë po tamam jam kon te shpia e tijna.

7 PY. Në rregull. Z. Krasniqi --

8 PË. Une flas veç të vërteta, zotëri Avokat. Çdo send që ta
9 them është fakt. Vetëm një nëse s'është fakt mbaj përgjegjësi
10 para juve.

11 PY. Jakup Krasniqi nuk të ka thënë asnjëherë ty apo vëllait
12 tënd se isht Hashim Thaçi ai që e shkroi Komunikatën 59,
13 kështu?

14 PË. Jo. S'kam fol kurrë me Jakup Krasniqin, hiç. Edhe kena
15 punu me ta 10 vjetë. Kurrë mu s'më ka fol. U prishëm.

16 PY. Po Ganiu?

17 PË. Hiç nuk di. Hiç [E pakuptueshme] s'di. Kurrë s'ka fol. Më
18 ka ik gjithë. Kurrë, jam taku në kuvend, më ikte. Kurrë forcë
19 s'kemi. Vetëm një herë e di që i kam thonë në kuvend, na kena
20 punu bashkë e marrshëm me kerr Jakup Krasniqin, Mehdi Bardhin,
21 Idriz Rrecin, dy burra shumë të mirë, edhe shkojshim unë i
22 vojitsha shkojshim bashkë deri në Prishtinë. Dhe sa herë
23 dojsha me e idhnu Jakup Krasniqin ja shajsha Leninin dhe
24 Stalinin.

25 PY. Në rregull.

1 PË. Edhe kurrë s'më foli mo. U idhnu.

2 PY. Mirë. Dëshmitar, e ke dijeni t'i se z. Krasniqi i ka
3 kërkuar ndjesë publike popullit të Kosovës për veprimet e
4 Milaim Zekës?

5 PË. Une nuk di çfarë veprimesh Milaim Zeka ka bo. Ai ka
6 bisedu, paska bisedu me ta, këta e dinë vetë. Le të sqarohen.
7 Hiq, largoni Milaim Zekën, të nderuar Gjykatë, hiqna atë
8 emën. Vërtetoni qëto çka po ju them këtu me njerëz e me mu. A
9 ka diçka të dyshimtë mo pas kësaj? Është për dritë të diellit,
10 dihet emri edhe mbiemri i lëshimit të Komunikatës 59.

11 PY. Përpara pushimit dua të shohim edhe një dokument.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] DHT04410 deri në DHT04412.

13 PY. Është një artikull gazete, pra është diçka publike.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër.

15 PY. Titulli është që Krasniqi thotë që i vjen keq që e ka
16 lejuar Milaimin të konkurrojë në listën e partisë së tij.

17 Është një postim në Facebook dhe aty jepet gjithë artikulli i
18 gazetës:

19 "Gjithçka që doja ta thoja për luftën e kam thënë në
20 mijëra faqe. Kam thënë edhe -- kam dëshmuar edhe në rastin e
21 Limaj edhe Haradinaj, të gjithë e dinë mendimin tim.

22 "Unë nuk kam autorizuar asnjë person të flasë në emrin
23 tim për luftën apo për ngjarjet vetë. Nuk kam autorizuar
24 gazetarin -- as gazetarin Milaim Zeka."

25 A e keni lexuar këtë artikull në gazetë --

1 PË. Jo, jo, hiç, hiç.

2 PY. Një minutë -- që z. Krasniqi ka thënë që nuk e ka
3 autorizuar Milaim Zekën të përfaqësojë mendimet e tij lidhur
4 me atë që ka ndodhur në luftë?

5 PË. Këto janë punë të tyne, kën autorizojnë e ça flasin. Këto
6 s'janë punë të miat, as të Gjykatës hiç. Send mbi tokë këtë
7 lidhje s'kam. Pyetëm diçka ça kam lidhje unë. Mos më pyt për
8 sende që s'kanë kurrëfarë -- për mu s'kanë kuptim. Po flet
9 diçka abstrakte, diçka që unë s'merrna me ato hiç. Hiç s'janë
10 për mu ato.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
12 një pushim. Kemi gjysëm ore pushim, Dëshmitar. Do të kthehemi
13 në 11.30. Mos fol me asnjëri për dëshminë jashtë kësaj salle
14 gjyqi.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë ju ka
17 mbetur?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Rreth 30 minuta.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi pushim
20 deri në 11.30.

21 --- Pauza fillon në orën 11.01

22 --- Seanca rifillon në orën 11.30

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Numri MFI,
24 pra i provës materiale provizore P01752, është e përshtatshme,
25 dhe për këtë arsye neve mendojmë që autenticiteti dhe kriteri

1 që ka të bëjnë me *prima facie* janë të përmbushura. Edhe si
2 rrjedhojë, është një dokument që është me vlerë provuese dhe
3 është gjithashtu relevant.

4 Mund t'i hiqni numrin provizor të provës dhe mund të
5 caktoni numër të përhershëm prove.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
7 nderuar Gjykatës. Tani do të caktojme numrin P01752 dokumentit
8 përkatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të
10 vazhdojmë, atëherë.

11 Z. DIXSON: [Përkthim] Përderisa thamë që do ju japim një
12 përgjigje, duam të themi që nuk është se kemi asnjë
13 kundërshtim lidhur me materialet që u diskutuam sot herët në
14 mëngjes dhe që kanë të bëjnë me parashtrimin e Prokurorisë për
15 të cilët na pyetët sot në mëngjes. Faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, të gjitha ekipet
18 e Mbrojtjes kanë të njëjtin qëndrim, domethënë nuk kemi
19 kundërshtim lidhur me kërkesën e Prokurorisë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
22 këshillohen]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
24 uleni, se do kemi një vonesë të shkurtër.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
2 të vazhdojmë më tej me pyetjet e z. Misetic. Ju lutem,
3 dëgjojeni me vëmendje pyetjet.

4 Misetic, e keni ju fjalën.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Z. Geci, ne thamë më përpara që informacioni nga Milaim
7 Zeka që i ka dhënë këtë informacion Milaim Zeka, domethënë, z.
8 Gani Gecit, Gani Geci këtë informacion e ka marrë jo më vonë
9 sesa prilli i 2017. Domethënë, e kam fjalën këtu për
10 pretendimin që Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj
11 akuzojnë Hashim Thaçin për shkrimin e Komunikatës 59. Milaim
12 Zeka ia ka thënë vëllait tuaj këtë jo më vonë se sa prilli i
13 2017.

14 Pyetja që kam për ju është kjo, është e saktë, apo jo që
15 pavarësisht që çfarë ju ka thënë ju Milaim Zekaj, ju nuk keni
16 qenë i bindur që informacioni që ju ka dhënë ai ka qenë i
17 saktë. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Mu Milaim Zeka s'më ka thënë kurrëgjë kurrë. Vetëm atë,
19 vllaut, atë shkrim që kemi përdorur, atë shkrimin që kemi
20 përdor publik, është një shkrim që e kemi bo zyrtar, kurse me
21 Milaimin unë nuk kam kontakte. Nuk kam vazhdu me pas kontakte.

22 PY. Do ta shpreh ndryshe. Do ta perifrazoj atë çfarë thashë.
23 Të fillojmë nga fillimi dhe një herë. Me sa dini ju, ju thoni
24 që Gani Geci të ka thënë ty që atij i ka thënë Milaim Zekaj që
25 Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj e kanë akuzuar

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 62

1 Hashim Thaçin se ka shkruar Komunikatën 59. A është e saktë
2 kjo?

3 PË. Gani Geci është personazh që do të vje këtu, do t'i thotë
4 të tana ty. Juve, Gjykatës të nderuar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
6 përgjigjuni pyetjes. Në qoftë se nuk e dini, thoni nuk e di --

7 DËSHMITARI: Nuk e di.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] -- por duhet
9 që t'i përgjigjeni pyetjes.

10 DËSHMITARI: Për këtë -- për këtë pyetje mos më pyetni për
11 Milaim Zekën, nuk e di. Hiqeni q'tash prej menyje.

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, kam marrë diçka që ju e keni thënë, pra, është
14 në dëshminë që keni dhënë nën betim, është në dëshminë që i
15 keni dhënë Prokurorisë. E keni thënë këtë gjë që vëllai yt
16 Ganiu, të ka thënë ty që Milaim Zekaj i ka thënë atij që
17 Milaim Zekës i ka thënë Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe
18 Fatmir Limaj që Komunikatën 59 e ka shkruar Hashim Thaçi. Kjo
19 është dëshmia juaj, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Kjo, edhe një herë, thashë. Mos -- kjo temë është
21 përsërit shumë herë. Kjo është e vërtetë çka ka thanë Milaim
22 Zeka, këta personat janë këtu do të veten, a kanë thanë a
23 s'kanë thanë. Qetu i ki. Unë --

24 PY. Atëherë, edhe një herë. Po të pyes sepse unë e fillova
25 nga fillimi, po tregoj gjithë rrjedhën. Domethënë, vëllai yt,

1 Gani Geci, të ka thënë ty atë çfarë i ka thënë atij Milaim
2 Zekaj. E thamë që ndërkohë vëllait tuaj i është dhënë ky
3 informacion jo më vonë se sa prilli 2017.

4 Kështu që pyetja që kam për ty është kjo, a është e
5 vërtetë që as ti, as vëllai yt, Ganiu, nuk keni qenë
6 plotësisht të bindur që atë çfarë ju ka thënë Milaim Zeka ka
7 qenë e gjithë e vërteta? A është e vërtetë kjo, apo jo,
8 Dëshmitar?

9 PË. Kur të vjen Ganiu, pyetni për datë. Mos të bëj gabime se
10 jam i dobët në data. Pyetni Ganiun krejt jua spjegon edhe i
11 kjartësoni krejt. Kjo është e vërtetë çka është thanë, edhe
12 unë, e vërtetë, krejt çka kam thanë është e vërtetë.

13 PY. Në rregull.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoj që Sekretarja të nxjerrë
15 në ekran një postim në Facebook nga Gani Geci që lidhet me atë
16 se çfarë keni dhënë ju në dëshmi.

17 Pra, është dokumenti DHT04428 deri në DHT04428, në shqip
18 dhe në anglisht.

19 PY. Ky është postim nga llogaria në Facebook e vëllait tuaj,
20 e Gani Gecit. Data është 5 korrik 2018. E ka titullin
21 komunikatë për shtyp që bëhet në emër të familjes Geci nga
22 Gani Geci. A e lexon, a e shikon këtë, Dëshmitar? Po apo jo?

23 PË. Po, po e shikoj. Tu e këqyrë jam.

24 PY. Mund ta lexoni vetë. Dhe diku aty nga mesi thuhet që:

25 "Familja jonë ka vuajtur gjithë ato pasoja për 20 vjet

1 pasi kjo komunikatë nuk është shfuqizuar kurrë nga ky Shtab
2 përkundër pretendimeve. Nëse ish-anëtarët e Shtabit të
3 Përgjithshëm nuk kërkojnë falje publike dhe nuk e shfuqizojnë
4 këtë komunikatë, me ne do të ballafaqohen në Gjykatën Speciale
5 për të zbardhur të vërtetën se kush nga Shtabi i Përgjithshëm
6 mban përgjegjësi për këtë komunikatë. Prandaj, për herë të
7 fundit kërkojmë nga ish-anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm,
8 pikërisht nga presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri
9 Veseli, nënkryetari i kuvendit Xhavit Haliti, deputeti Rexhep
10 Selimi, ish-kryetari i kuvendit Jakup Krasniqi, Ramë Buja,
11 Fatmir Limajn, Adem Grabovci, Bislime Zyrapi dhe të gjithë të
12 tjerët që asokohe kanë qenë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm
13 të UÇK-së, që të na kërkojnë falje publike dhe ta shfuqizojnë
14 atë komunikatë.”

15 Në emër të familjes Geci, nënshkruhet nga Fadil --

16 PË. Po.

17 PY. -- është edhe emri juaj, Fadil Geci.

18 PË. Po.

19 PY. A e keni shkruar ju këtë, Dëshmitar?

20 PË. Po, është e vërtetë. Kjo është e vërtetë. Dhe kam kërku -

21 -

22 PY. Iu përgjigjët pyetjes. Nuk është e nevojshme të vazhdoni
23 më tej. Kjo është shkruar të paktën, të paktën, 15 muaj pasi
24 Milaim Zekaj ju ka thënë ju -- ose i ka thënë Ganiut, që Jakup
25 Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Fatmir Limaj kanë akuzuar Hashim

1 Thaçi që ka shkruar Komunikatën 59. Pavarësisht kësaj, ju
2 thoni që doni që anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të
3 zbulojnë të vërtetën lidhur me faktin se kush nga Shtabi i
4 Përgjithshëm mban përgjegjësi për këtë komunikatë.

5 Është e saktë, apo jo, Dëshmitar, që ju nuk ishit
6 plotësisht i bindur lidhur me atë se çfarë ju ka thënë Milaim
7 Zeka, që ajo që jua kishte thënë Milaim Zeka ishte e gjithë e
8 vërteta, kështu, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Unë jam kanë i bindun ditën e parë, por Shtabi u dasht me
10 bo publik, ata komplet me kërku falje. Unë Fadil Geci, ditën e
11 parë që kam shku në shtëpi e kam dit që komunikatën e ka --
12 unë, Hashim Thaçi e ka shkru. Këtu, deri sot, këtu, e kem
13 shkru këtë, e kam nënshkru këtë, e kam kërku komplet Shtabit.
14 Se ata kanë qenë komplet. Por mu më ka interesu cili individ.
15 Dhe individi që tani po e di unë, nuk jam kanë i interesu me
16 ardh këtu hiç nëse këta kishin kërku falje. Pra kam kërku
17 atëherë, deri sot e dimë kush e ka shkru Komunikatën 59, çdo
18 Gjykatë që do të bahet, do të jem aty pas asaj. Edhe sot jam
19 këtu për Komunikatën 59, për pasojat që i ka shkaktu familjes
20 time. Për damet që i ka shkaktu Drenicës, edhe shqiptarisë në
21 përgjithësi. Me atë komunikatë tregohet që jo veç ajo, por
22 edhe të gjitha komunikatat e tjera janë nga një person
23 dashakeq, që i ka ba dam shqiptarisë dhe i ka ba dam gjithë
24 Kosovës.

25 PY. Pavarësisht kësaj, edhe një herë, ajo çfarë po ju them

1 unë është që Ganiut, vëllait tuaj i ka thënë Milaim Zekaj që
2 pretendohet që atë informacion që ia ka dhënë vëllait tuaj,
3 është informacion të cilin ai e ka marrë nga persona të tjerë,
4 domethënë, nga Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj.
5 Dhe pavarësisht kësaj, ti shkruan këtë që sapo lexuam. Ti nuk
6 the që e ka shkruar komunikatën Hashim Thaçi, por thua që
7 dëshiron që ata që kanë qenë përgjegjës të mund të shfaqen.
8 PË. Në interes -- në interes të përgjithshëm ka qenë me dal
9 unik këta. Është kanë një variant me dal bashkë tanë me kërku
10 falje. Është mendu në atë drejtim, e din Hashim Thaçi ça ka
11 thanë. Por s'ka mujt se e kanë dit ata që ky e ka shkruar edhe
12 s'ka mujt me i ba bashkë të tanë. Por është dasht vet me kërku
13 falje, se i ka ardh fundi. Nuk ka mujt me ikë ma andej. Edhe
14 ma nuk ka mujt me ik për të. I ka ardh fundi, me i thanë të
15 vërtetën edhe ai vetë, u dasht vetë me thanë, "unë e kam
16 shkru, kërkoj falje, oj Drenicë e shqiptari". E ia kishim falë
17 që aty. Jo me thanë "s'e kam shkru". E ka shkru vetë me dorë
18 të vet.

19 Kjo është e randë për familjen [E padëgjueshme]. Kjo
20 është kanë randë për neve. Dy meshkujt ma të mirë janë vra për
21 atë komunikatë. Dy vëllazër janë plagu. Edhe krejt kreu i
22 krejt Kosovës është kanë i akuzum. Me komunikata të tilla.
23 Edhe shumica janë vra. Kjo është e vërteta.

24 PY. Do kalojmë edhe te kjo për një çast.

25 PË. Katër -- gjashtë shokë të mij i kam të vramë unë, në

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pytje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 67

1 Drenicë, nuk më pyet hiç --

2 PY. Ndaloni ju lutem, mjaft.

3 PË. -- asnjë s'më pyet. Po pyetëm t'i tregoj. Gjashtë shokë i
4 kam të vramë unë, njerëz, bashkëpunëtorët ma të ngushtë të
5 mijtë. Vetëm se kanë qenë në LDK, për me i pengu.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, ju lutem.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj që ky
9 postim në Facebook të pranohet në prova gjyqësore.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
11 DHT04428 deri në DHT04428, në shqip dhe në anglisht, pranohen
12 si provë.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
14 numrin e provës 1D00199. Klasifikohet si publik.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

16 PY. Dëshmitar, në postimin në Facebook ju keni kërkuar falje
17 publike, dhe më pas z. Thaçi ka, i ka kërkuar falje Gani Gecit
18 lidhur me komunikatën e UÇK-së. A është e saktë kjo?

19 PË. Po.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani të
21 paraqesë në ekran dokumentin 044 -- 04397 deri në DHT04398, në
22 shqip dhe në anglisht.

23 PY. Ky është një njoftim për shtyp, është një artikull që ka
24 të bëjë me faljen që kërkon Hashim Thaçi. Dhe këtu thuhet që:

25 "Komunikata 59 është abuzive, nuk i takon UÇK-së dhe

1 është publikuar nga persona keqdashës pa leje të UÇK-së. Si
2 rezultat, janë dëmtuar Gani Geci dhe anëtarë të tjerë të
3 familjes së tij dhe kërkoj -- dhe më vjen keq për atë çfarë ka
4 vuajtur familja Geci."

5 Me aq sa ju kujtohet juve, a është kjo falja që ka
6 kërkuar Hashim Thaçi për Gani Gecin?

7 PË. A e lexove mirë edhe tej, që kam kërku prej Shtabit. E ky
8 përfaqësuesi i Shtabit që po thotë, veç ky i Shtabit, veç ky.
9 Thotë që "kërkoj falje." E të tjerë brenda Shtabit thojnë, ky
10 e ka shkru vetë. Qysh e gjun gurin e mshef dorën kur e ka
11 shkru vetë, edhe kërkoj falje? Çfarë kuptimi ka kjo? Vetë e ka
12 shkru, vetë kërkon falje. Vetë të mbyt, vetë të ban hero. Kjo
13 ka ndodh te na, plot kem raste.

14 PY. Do ta marrim hap pas hapi. Megjithatë, pavarësisht kësaj,
15 këtij arsyetimi që ju jepni, asaj çfarë aludoni apo çfarë
16 nxjerrni si rezultat i asaj çfarë ka ndodhur, a ju kujtohet që
17 z. Thaçi të ketë bërë një falje të tillë publike në shkurt të
18 2019?

19 PË. Kjo është -- këqyre ku po shkrun këtu. Kujtohet edhe
20 atëherë edhe unë e kam thanë, mirë që ka bo, mirë që ka bo, ka
21 kërku falje. Në emër të shtabit ka thanë "unë jam -- po e
22 kërkoj", jo Shtabi. Shtabi ka thanë, edhe njerëzit rreth
23 shtabit që kanë qenë kanë thanë atë komunikatë, veç për qatë
24 komunikatë nuk është dasht me fol Hashim Thaçi. Pse
25 komunikatën e ka shkru vetë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 69

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. Kryegjykatës, kërkoj që të pranohet si provë ky
3 dokument.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi
5 kundërshtime?

6 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
8 DHT04397 deri në DHT04398, në shqip dhe në anglisht, pranohen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
10 provës 1D00200. Prova do të klasifikohet si publike.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Dëshmitar, do bëj një përmbledhje dhe pastaj do ju pyes
13 në qoftë se pajtoheni me përmbledhjen. Ta lëmë mënjane për
14 momentin Komunikatën 59, se e di që akoma nuk është e qartë
15 çështja e autorësisë së komunikatës.

16 z. Thaçi është dikush që nuk ka pasur mosmarrëveshje me
17 familjen Geci para ose pas luftës. Është një person të cilin
18 ju e keni përdorur si ndërmjetësues për mosmarrëveshjen që
19 kishte -- që kishit me Azem Sylën, që ju ka thënë ju në 2013,
20 në 2014, se kush besonte ai që e ka shkruar Komunikatën 59 që
21 ju ka bërë një falje publike me kërkesën tuaj sa i takon
22 Komunikatës 59 dhe ju vazhdoni që të besoni që ata të cilët ju
23 besoni ju ka dhënë informacion ndryshe, duke përfshirë këtu
24 Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, Fatmir Limaj, persona me të
25 cilët i keni pasur konflikte në kohë, pra të shtrira në kohë,

1 dhe që befas ju thoni, filloni që flasin fjalë pozitive ndaj
2 jush dhe vëllait tuaj, dhe pavarësisht të gjitha këtyre
3 zhvillimeve ju vazhdoni të mendoni negativisht për z. Thaçi
4 dhe vazhdoni të mos i besoni z. Thaçi. A është e një përshkrim
5 i saktë i situatës ky, Dëshmitar?

6 PË. Nuk kam pas konflikte unë, vetëm këto bindjet. Dhe LPK-ja
7 këta komplet bashkë kanë mendu me na eliminu neve, unë e kam
8 mendu që Shtabi i Përgjithshëm e ka shkru. Shtabi, komplet,
9 janë tubu edhe kanë shkru. Por është vërtetu, është vërtetu që
10 emri i personit që e ka pyet në telefon Rexhep Selimin, e ka
11 pyet në telefon i ka thanë "mos e shkruj që atë se s'e ka,
12 thuj është me Ibrahim Rugovën, thuj është me qeveri, thuj
13 është me FARK, thuj është me shtet të Kosovës, por mos thuj i
14 ka pri ofensivës serbe". Dhe ka thanë "Kam me jua ul, kam me i
15 shfaros atë familje".

16 PY. Ndaloni këtu. Ndaloni këtu, ndaloni, Dëshmitar --

17 PË. E ka pas -- [Folës që flasin njëkohësisht].

18 PY. -- t'ju pyes lidhur me këtë që sapo thatë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari nuk
20 mund të ndalohet mbasi bëhet një pyetje prej 13 rreshtash.
21 Duhet të lihet që të flasë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
23 akoma po marrim përkthimin nga përkthyesit, nuk -- të
24 përmbledhet përkthimi një herë dhe pastaj të kuptojmë se për
25 çfarë po flitet.

1 Ju lutem, përsëriteni edhe një herë përkthimin. Do u
2 lutesha përkthyesve që ta përsërisin dhe një herë përkthimin.

3 A mund ta thuash dhe një herë, e përsërit dot pjesën e
4 fundit të deklaratës që sapo thatë, çfarë thatë para pak
5 minutash?

6 DËSHMITARI: Unë thashë që Hashim Thaçi, Shtabi, Shtabi
7 unë kam mendu komplet dalin e kërkojnë falje. Unë e kam pas
8 mendimin tim për kënd. Por si ekip komplet dalin e kërkojnë
9 falje.

10 Ky është dalë individ, që vetë e ka shkru, vetë kërkon
11 falje. Vetë të mbyt, vetë të ban hero. Kjo është e vërteta.
12 Kemi raste këtu plot. Pyetmëni, pyet mu, unë ju tregoj. Pse
13 s'po më pyetni?

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, ti the në përgjigje në faqen 60, rreshti 23,
16 thatë që:

17 "Dihet që emri i personit që e ka pyetur Rexhep Selimin
18 në telefon edhe i ka thënë që 'mos e shkruaj këtë gjë, mos
19 shkruaj diçka që nuk është e vërtetë'."

20 Për cilën bisedë telefoni, për cilën, për çfarë thirrje
21 telefonike e keni ju këtu, mund të na e sqaroni pak?

22 PË. E ka -- bisedë telefonike që e ka sqaru kur e kanë shkru
23 se këta kanë qenë bashkë, në një vend ka qenë. Edhe Rexhep
24 Selimi edhe Hashim Thaçi. Por Rexhep Selimi s'e ka pranuar atë,
25 ky e ka pranuar edhe ka thanë, "Po du me i shfaros këtë

1 familje".

2 PY. Nga e di ti këtë gjë?

3 PË. Po, na --

4 PY. Ndalo këtu. Sepse duhet që të flasim me radhë për
5 përkthyesit. Nga e dini ju që ka ndodhur kjo bisedë telefonike
6 ndërmjet Hashim Thaçi dhe Rexhep Selimit? Nga e dini këtë gjë?

7 PË. Nëpër opinion deklarata e Rexhepit, deklaratë nëpër
8 opinion, televizion, deklarata e tijna drejtpërdrejt,
9 deklarata e shokëve të tjerë që s'i përmend në Shtab, Bardhyl
10 Mahmutit, edhe ai ka dhanë një deklaratë, se vetë s'më pyet
11 për të hiç. Edhe të tjerët, edhe Ramë Buja, edhe të tjerët.

12 PY. Ndjesë.

13 PË. Pyetni pak ma thellë.

14 PY. Ky informacion jepet në intervistën e ZPS-së, pra z.
15 Selimi ia ka dhënë këtë informacion ZPS-së në intervistën e
16 vet. Prokuroria, a ta ka dhënë deklaratën e Rexhep Selimit për
17 ta lexuar ty, Dëshmitar?

18 PË. Na dje të gjitha i pamë dje, dje bashkë me ty. Të gjitha
19 qetu i pamë çka ka thanë. Rexhep Selimi ka thanë, "Veç për atë
20 komunikatë nuk ban me fol se komunikatën e ka shkru dhe e ka
21 lëshu me dorën e vet Hashim Thaçi". "Më ka thirr mu në
22 telefon, unë i ka thanë 'mos, ai ka thanë 'due me i shfaros
23 atë familje'." Unë --

24 PY. Dëshmitar --

25 PË. -- nuk ish kanë fati, jam gjallë. Këtu jam.

1 PY. Në rregull.

2 PË. Mirë, ma mirë që jam, a po pajton?

3 PY. Më dëgjo çfarë po të pyes, Dëshmitar. A të ka dhënë
4 mundësinë ZPS-ja që të lexoni intervistën që Rexhep Selimi i
5 ka dhënë ZPS-së, gjatë seancës përgatitore, ke pas mundësi që
6 ta lexosh intervistën e Rexhep Selimit, Dëshmitar?

7 PË. Po, e kam pa një pjesë, po. E kam pa një pjesë. E kem
8 dëgju në aktakuzë --

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po flisni mbi
10 njëri-tjetrin, po flisni në të njëjtën kohë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. A të ka dhënë mundësinë ZPS-ja që të lexoni deklaratën e
13 Hashim Thaçit lidhur me Komunikatën 59, kush e ka shkruar këtë
14 komunikatë?

15 PË. Epma mundësinë, që tash po kam qejf me e pa [E
16 pakuptueshme]. Këtu jemi.

17 PY. Nuk po të pyes për këtë, Dëshmitar. Megjithatë, nga
18 përgjigja e kuptoj që juve nuk ju është dhënë deklarata e
19 Hashim Thaçit nga ZPS-ja në mënyrë që të lexoni versionin e
20 Hashim Thaçit sa i takon Komunikatës 59, kështu?

21 PË. Jo, jo. S'e kam pa.

22 PY. Në rregull. Faleminderit. Kalojmë tek tema tjetër. Vëllai
23 juaj e ka qëlluar me armë Abedin Rexhën, Sandokanin, kështu?

24 PË. Edhe një herë. Unë dje ju thashë. Është një temë që nuk
25 vlen, nuk ia vlen me u merr me mu këtu kur e ka mbyll mjekësia

1 ligjore. Nuk ia vlen me bisedu unë për një temë -- unë...

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar. Ju
3 lutem, përgjigjuni pyetjes. Nuk të takon ty të thuash që nuk
4 duhet të diskutohet kjo temë. Pyetjet i bëjnë palët. Detyra
5 jote është që t'i përgjigjesh pyetjeve. Në qoftë se ka
6 kundërshtim, Prokurori do marrë fjalën dhe do e thotë që
7 kundërshton. Tani për momentin dua që t'i përgjigjeni pyetjes.

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Pyetja është kjo. Vëllai juaj e ka qëlluar me armë Abedin
10 Rexhën, Sandokanin, apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Vëllai im nuk e ka qëlluar, por ai ka vdekë. Është e
12 vërtetë nga mjekësia ligjore, dhe ajo është zyrtare tash. Në
13 duart e juaja është. Përtej ekspertave nuk jemi ku shkojmë.

14 PY. Do shkojmë dhe te kjo pikë. Megjithatë do ta shpreh
15 ndryshe pyetjen. Vëllai juaj ka qëlluar në drejtim të Abedin
16 Rexhës, Sandokanit, dhe pasi është qëlluar, pak kohë mbasi
17 është qëlluar, Sandokani ka vdekur. A është e saktë kjo?

18 PË. Jo.

19 PY. Atëherë, të lexojmë atë çfarë ka thënë vëllai juaj.

20 Atëherë, të lexojmë çfarë ka thënë vëllai --

21 PË. Edhe një herë --

22 PY. -- Ti the "jo", e dhe përgjigjen tënde --

23 PË. -- u kry, po.

24 PY. -- kështu që të lexojmë çfarë ka thënë vëllai.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares

1 të paraqesë në ekran dokumentin DHT0444 deri në DHT004444.
2 Ndërkohë që në versionin në shqip dokumenti ka numrin e
3 identifikimit SITF00263239-00263325, në faqen SITF00263306.
4 Versioni në shqip është nga lista e dokumenteve të ZPS-së.
5 PY. Është një deklaratë e dhënë nga vëllai juaj. Të vazhdojmë
6 më poshtë, të kalojmë pak më poshtë në faqe, në një paragraf
7 më poshtë. Aty ku fillon që "Ata filluan të shtijnë
8 menjëherë":

9 "Ata filluan që të gjuanin me armë menjëherë. Shokët
10 thanë, 'Na vranë!' dhe ata vazhduan që të largoheshin. Unë e
11 kisha automatikun në prehër, e mora, u ula më poshtë dhe
12 shkova në drejtim të derës. E mora automatikun dhe qëllova në
13 drejtimin e tyre. Më pas dola dhe gjuajta duke shkuar në
14 drejtim të shtëpisë.

15 "Të shtënat u dëgjuan në shumë drejtime. Kam pasur gjak
16 në fytyrë nga spirat e xhamave. I kam larë sytë dhe jam kthyer
17 për të parë çka është bërë. Te kerri e kam taku Skënderin, e
18 kam pyetur se kush është vranë, dhe a janë vranë ata që kanë
19 qenë me mua. Ai m'u përgjigj se është vranë Abedini. Skënderit
20 i kam thënë që duhej që të tregonte realitetin. Vlen të
21 theksohet se diku 5-6 metra më andej, në anën e djathtë, ka
22 qenë një traktor me disa fëmijë e gra. Ata e dinë rastin shumë
23 mirë. Kur jam kthyer te kerri BMW, kerri im nuk ka qenë aty, e
24 kishin marrë disa djem dhe e kishin larguar dikund.

25 "Kjo është deklaratë që e ka dhënë Gani Geci."

1 Këtë ka thënë vëllai jua në deklaratën e vet. Që ka
2 shtënë me armë dhe Abedin Rexha, Sandokani, pak çaste mbas
3 kësaj ka vdekur. A është e saktë kjo?
4 PË. Do të sqaroj. Kjo është publike, shumë herë e kam thanë.
5 Ne kemi mendu ashtu të tanë. Kemi mendu që o vra prej dorës
6 tonë, Ganiut. Por është vërtetu, është hap procedurë, është
7 vërtetue nga mjekësia ligjore [E pakuptueshme] që personi që
8 është vdek, nuk është vdek prej pushke. Dhe në të drejtën e
9 përgjithshme reagimi i parë i njeriut është syni, prej reagon
10 pastaj dora. Ganiu ka vepru në vetëmbrojtje dhe ka gju me
11 armë, se ai është kanë në pritë. Por nuk është vërtetu që ai
12 plumb, e ka marrë një plumb dhe është vra në mënyrë zyrtare
13 mjekësia ligjore. Kjo është e vërteta. Të gjitha këto të
14 tjerat janë --
15 PY. Do të vijmë dhe aty. Do të vijmë ke mjekësia ligjore. Por
16 ti e konfirmon se ky është versioni që ka dhënë vëllai për atë
17 që ndodhi pak përpara se të vdiste Abedin Rexha, Sandokani,
18 kështu?
19 PË. Versioni im është ky. Unë jam jurist. Jashtë procedurës
20 gjyqësore asgjë s'pranoj, këto thashetheme. Kjo është e
21 vërteta që mjekësia ligjore e ka mbyll këtë temë, që kjo është
22 e vërteta. Për këto të tjerat, pyetna kur të vijë ai çka e ka
23 thonë, ai të thotë vetë.
24 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar. Z. Kryetar, ky është
25 marrë nga libri i Gani Gecit, prandaj e paraqesim si provë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 77

1 materiale.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
3 kundërshtime?

4 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT044 deri
6 në DHT044 [Sipas përkthimit] në anglisht dhe në shqip,
7 pranohet.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për të sqaruar që faqja
9 shqiptare [Sipas përkthimit] është marrë nga një dokument më i
10 madh dhe është SITF00263306. Do t'i jepet numri si provë
11 materiale 1D00201. Klasifikimi është publik. Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

13 Z. MISETIC: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, ti a ishe në veturë kur vëllai qëllloi me armë?
15 PË. Jo.

16 PY. Dua të të tregoj një deklaratë që e ka dhënë gruaja e
17 Abedin Rexhës, Sandokanit, gjatë hetimeve.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Është dokumenti me numër
19 SPOE00006816 deri në 00006855, në faqen SPOE0006820 [Sipas
20 përkthimit]. I njëjti numër është edhe në shqip. Ju kërkoj
21 ndjesë, i njëjti dokument, por numri i faqes në shqip është
22 SPOE0006826 [Sipas përkthimit].

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund ta përsërisni
24 numrin ERN? Nuk e gjej dot.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] SPOE00006816 deri në SPOE00006855.

1 PY. Dëshmitar, po lexoj atë që ka thënë ajo.

2 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Ku e ka thënë? Dua ta
3 gjej në listën e dokumentave, apo në listën e provave
4 materiale.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që mund ta pyes për
6 dokumenta që nuk janë në listë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ta
8 pyesësh. Por identifikoj se kush është dëshmitari me emër.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Gruaja e Abedin Rexhës, Sandokan,
10 quhet Sanije Rexha. Ajo thotë në faqen -- mbase nuk është në
11 listën e dokumenteve -- ajo thotë në faqen SPOE0000620 [Sipas
12 përkthimit] atë që i kanë thënë dëshmitarët okularë asaj.

13 PY. Pyetjen e bën Prokurori i EULEX-it.

14 "Të kujtohet nëse dëshmitarët okularë të thanë emrat e
15 vrasësve të burrit?"

16 "Po. Gani Geci, dhe vëllai i tij Fadil dhe Avni Haxha."

17 Z. PACE: [Nuk ka përkthim]

18 DËSHMITARI: Të lutem, [E padëgjueshme]. Ju lutem,
19 përkthimi nuk po më --

20 Z. PACE: [Përkthim] Ç'kuptim ka -- Prokurori, më fal --
21 që të lexojmë dokumente që nuk janë në listën e dokumentave.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka një arsye
23 që nuk është në listën e dokumenteve?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e di që nuk është. Ne po e
25 kërkojmë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta gjejmë që
2 ta bëjmë punën siç duhet.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, është një lapsus
4 nga ana jonë që nuk është.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkon që të
6 shtohet? Keni ndonjë kundërshtim që ta shtojmë këtë dokument?

7 Z. PACE: [Përkthim] Po. Ne nuk mund të bëjmë një pyetje
8 kur nuk e keni parë më parë dokumentin. Më duhet kohë që të
9 familjarizohem me të.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni
11 pyetjen, pastaj mund ta trajtoni më vonë çështjen.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Është një dokument i SPO-së, ZPS-
13 së në fakt.

14 Z. PACE: [Përkthim] Po ka mijëra dokumente të ZPS-së.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe Mbrojtja po ashtu, por kjo
16 nuk e ka penguar më parë ZPS-në që ta shtojë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju jap leje
18 ta bëni pyetjen, vazhdoni.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, është e saktë që keni qenë i pranishëm?

21 PË. Jo, jo. Jo, jo.

22 PY. Di nëse Avni Haxha ka qenë i pranishëm?

23 PË. Avni Haxha ka qenë i pranishëm, jo Fadil Geci, hiç.

24 PY. Ka qenë ndonjë nga vëllezërit e tjerë i pranishëm?

25 PË. Hiç. Vetëm Ganiu, hiç, asnjë vllazën tjetër s'ka qenë.

1 PY. Mirë. Në faqen tjetër ajo thotë, faqen që ka numrin
2 SPOE000621 [Sipas përkthimit], mbasi u vra burri, trupi iu
3 soll në shtëpi për ta varrosur. Dhe pyetja i bëhet nga
4 Prokuroria.

5 "E patë trupin e burrit?"

6 "Po, pa tesha."

7 "Pyetje: Të kujtohen ku ishte plagosur?"

8 "Një në kyçin e djathtë, një tjetër në anë, në shpatullën
9 e majtë."

10 A e dini që dëshmitarë të tillë siç është gruaja e tij
11 kanë pohuar që ka pasur plagë të shkaktuara nga armë kur ia
12 kanë sjellë trupin në familje?

13 PË. Unë vetëm një e di, që ajo ka bo deklarata shumë. Njënën
14 prej deklarata që mbaj mend mirë për opinion është kur ka
15 thanë se "mjekësia ligjore e ka vërtetue që burri im nuk është
16 vra prej plumbit, dhe nuk kam dasht me i marrë eshtrat". Se
17 këta njerëz si na, na ka akuzu që na kemi lidhje me Amerikën,
18 me juve, çfarë të thojmë na bahet.

19 Edhe mirë që ka thanë q'ashtu, edhe nuk është mirë me na
20 ngut qashtu të tanëve. Unë kurrfarë lidhje s'di kush janë kanë
21 ata mjekët ligjorë, por ata kanë kry punën e vet edhe
22 deklarata të tilla për mu nuk i marrim.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim se çfarë ka thënë
24 Prokurori i EULEX-it. Çfarë tregon mjekësia ligjore. Është
25 prova SITF00367274 deri në 0367292 në faqen 17.

1 PY. Do të tregoj dy dokumente, se do të përdor raportin, që e
2 përmend gjithmonë, raportin e autopsisë.

3 Këtu Prokurori, që flet me Sanije Rexhën, thotë...

4 PË. Ju lutem, a ka mundësi shqip të shoh?

5 PY. Nuk e kemi në shqip, është një raport i EULEX-it, po ta
6 lexoj.

7 Prokurori i thotë asaj:

8 "Dua të them gjithashtu, zonjë, se për fat të keq raporti
9 i autopsisë nuk e thotë dot me saktësi se cili ishte kanali i
10 plagës, sepse mund të vlerësohet vetëm duke parë indet e buta.
11 Ne tani kemi vetëm kocka. Kështu që situata kur plumbi hyri në
12 kraharor dhe doli në shpatull del nga përshkrimi yt. Po ta
13 kishim trupin e tij të freskët apo një fotografi të trupit të
14 tij, kur qe akoma i freskët, apo mbas disa vitesh, do ta
15 kishim përcaktuar me siguri. Prandaj duam të bëjmë analizën e
16 ADN-së që të vërtetojmë që janë 100 për qind eshtrat e
17 burrit."

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe pastaj është konkluzioni i
19 ADN-së. Dokumenti me numër 063150 [Sipas përkthimit]. Të
20 kalojmë tek faqja SITF00367147.

21 PY. Dhe është dosja e Prokurorisë pak më tutje.

22 Pika e fundit thotë:

23 "Raporti i autopsisë i kryer në 2014 erdhi në përfundimin
24 se shkak i vdekjes nuk mund të provohet".

25 E shikon këtë?

1 PË. Nuk e kuptoj unë gjuhën, ju po thoni që ashtu, unë këtu
2 shqip s'po e shoh. Por përafërsisht ka thanë edhe ajo vetë,
3 unë e kam dëgju atë vetë ça ka thanë, unë po flas ça kam dëgju
4 vetë, ça ka thanë, grunë e Abedin Rexhës. Ajo është kushërinë
5 e jona, e Llaushe, e një babe të mirë, e një familje të mirë.
6 Por e kanë përdor për nevojat të vetë, sa herë është kanë të
7 gjithë na kanë, kjo vra, kjo vra, kjo vra. Të gjithë e kanë
8 përdor qatë. Ky grupi, se ju ka vy për nevoja të veta. Edhe ju
9 qe ashtu po e përdorni tash, qe s'di sa herë, unë po them nuk
10 di.

11 Mjekësia ligjore ka konstatu, ata e vërtetojnë. Unë mbas
12 ekspertave nuk kam fjalë. Mbas ekspertizës mjekoligjore fjalët
13 më ndalen mu. E ty si ekspert, ndoshta jo.

14 PY. Mirë. Edhe një gjë. Kam dokumenta për këtë, por ju e
15 konfirmuat që mbrojtja e vëllait që e tha publikisht është që
16 po të akuzohej për vrasjen e Abedin Rexhës, do të thoshte --
17 mbrojtja e tij do të ishte që e bëri për vetëmbrojtje, kështu?

18 PË. Ai deklaroi për vetëmbrojtje, por edhe një herë. Reagimi
19 i parë te njëri është syni, qe këto qerpikët. Si të bën [E
20 pakuptueshme] qerpiku? Kur të sulmon dikush mbas qerpiku po
21 ika dora, për me mbrojt kryt. Kudo që të sulmohet e drejta
22 elementare themelore e njeriut është me mbrojt veten. E lejume
23 gjithkund në botë. Edhe kur ka sulmu ai, paska thanë ai, e
24 thotë prapë. Ai është mbrojt, por nuk është vërtetu që është
25 vra prej plumbi.

1 A duhet diçka ma e kjartë si drita e diellit se kjo? Ka
2 gjujt, ka thanë 'kam gjujt, jam mbrojt'. 'Jam ra në pritë',
3 por nuk e kish pas vdekjen prej plumbit tem. E kish pas
4 vdekjen prej exhelit [fonetikisht] që i ka ardh dekiku me
5 vdek. Qe kjo është e vërteta që unë e di, ça po them, ma shumë
6 s'muj ta them unë. Se s'muj të dal jashtë asaj kornize
7 mjekoligjore. Nuk guxoj me dalë.

8 Por çuditena me ty që merresh me një punë që e kanë kry
9 mjekët. Nuk di, a je mjek ti?

10 PY. E vlerësoj që habitesh.

11 PË. U habita kah pak.

12 PY. Po ta them kështu. Është e vërtetë, apo jo, se kushdo që
13 e ka shkruajtur Komunikatën 59, e bëri këtë sepse vëllai yt
14 qëllloi ndaj një komandanti të UÇK-së?

15 PË. [E pakuptueshme] po bojka me çu komunikata se edhe me
16 kanë e vërtetë ajo, komunikatën pse me e -- edhe e vërtetë me
17 qenë. Qysh bohet komunikata, është [E pakuptueshme] s'ka mujt
18 me thanë.

19 Çuditena me ty me pyetjen që po ban.

20 PY. Të lutem, mos iu përgjigj pyetjes sime me një pyetje
21 tjetër. Është e saktë që me sa kupton ti kushdo që e ka
22 shkruar këtë komunikatë, e ka bërë për faktin që vëllai yt ka
23 qëlluar një komandant të UÇK-së?

24 PË. Ata e dinë, pyeti, që ku janë këtu. Pse e ke shkru,
25 thuaji, ai të kallzon.

1 PY. Unë po të pyes si e kupton ti.

2 PË. Na jemi këtu të gjithë --

3 PY. Ti e kupton shumë mirë se kushdo që e ka shkruajtur këtë
4 Komunikatën 59 e ka bërë për faktin se vëllai yt ka qëlluar
5 një komandant të UÇK-së me armë?

6 PË. Nuk e besoj që është ajo. Unë e besoj për me më hjek prej
7 skenës politike, mbasi kanë hjek familjen Jashari. Se ky grup
8 i don veç të vdeknit. Nuk e do të gjallë, është Rifati, është
9 legjendë, nuk e do kurrkush. Këta hiç, as te shtëpia s'i
10 shkojnë. Por mbasi u vdek Ademi, [E pakuptueshme] s'po më
11 flet. A në realitet kur janë vdek, janë gëzu. Këto nuk e
12 besojnë, por popullata do ta dijnë. Kur ju vdek familja
13 Jashari, që disa, jo të tanë, kërkoj falje, disa këtu e dinë
14 për cilët po them "jo", janë gëzu se u vdek se na ka mbet ne
15 më u vetë. Edhe familja Geci ishte pengesë, ishim ne, isha
16 unë, edhe fati, edhe neve na piketun. Por po të mos ish, të
17 ish familje tjetër sikur na, ça ish ba me ta? Mos të kishim
18 kapital njerëzor, moral, me histori, ça ish ba me ta mbas
19 kësaj komunikate? Ça ish ba? Ishin likvidu të tanë. Kjo është
20 fati.

21 PY. Po ju them këtë. Ti e kupton se kushdo që e shkroi
22 Komunikatën 59 nuk e bëri sepse vëllai ishte në LDK, apo ishte
23 kundërshtar. E bënë sepse ishte, ata e menduan se ishte një
24 tradhti e hapur të qëllonte me armë ndaj një komandanti të UÇK-
25 së.

1 PË. Jo, jo. Këta e kanë bo me na likvidu prej skene. Se jemi
2 kanë ana e kundërt që kemi mbrojt shtetin e Kosovës,
3 kushtetutën e Kaçanikut, institucionet e Republikës së
4 Kosovës. Në krye me Presidentin Ibrahim Rugova. Për qatë edhe
5 Ibrahim Rugova e kanë qujt tradhtar, edhe neve na kanë qujt
6 tradhtarë. Edhe po ju tregoj, unë s'jam kanë fort ngushtë me
7 më qujt këta tradhtar hiç, unë kam mendu të boj nder. Unë, por
8 vëllai nuk ka pranue, mirë ka bo që s'ka pranu. Edhe është
9 ardh deri këtu me ju vërtetu këtu para jush cili është
10 tradhtari.

11 Se gjatë historisë i kena mësu, komunistat tradhtarin ta
12 bajshin hero, e heroin tradhtar. Edhe kësaj radhe këta kanë
13 mendue qashtu, por nuk iu ka dal qashtu.

14 PY. Kam edhe një çështje për ta diskutuar, Dëshmitar. Ja ta
15 gjej atë pjesën nga deklarata që i ke dhënë ZPS-së.

16 Ti i ke thënë ZPS-së --

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe kjo gjendet në materialin me
18 numër P1740.2, faqja 13, rreshtat 18 deri 22 në anglisht.

19 Faqja 16, rreshti 22 deri në faqen 17, rreshti 5 në shqip.

20 PY. Ti ke thënë që vëllai yt, Gani Geci, ishte personi më i
21 pastër dhe shpirti më i pastër, kështu?

22 PË. Po, po. Është e vërtetë ajo krejt. E dinë edhe këta këtu
23 mirë që është shpirt i pastër. Edhe mbarë shqiptaria e din që
24 është shpirt -- i pastër.

25 PY. E para që dua të them është, është një shpirt i pastër

1 edhe pse është shpallur fajtor për vrasje, kështu?

2 PË. Edhe një herë, e drejta nuk bohet, elementare është
3 mbrojtja e vetes. Janë kanë të sulmum, prej të tana anëve janë
4 kanë të sulmum. Fati ka desht, ai është gjallë. Veç fati. Se
5 ai është kanë i vram. Ai është i plagum, edhe veç fati është
6 gjallë, [E pakuptueshme] rastësisht. E tani s'kish pas ça me
7 fol ma. Por është gjallë dhe flet vetë. E tregon vetë. Edhe
8 tregon kush janë këta ose ai edhe kush është Gania edhe kush
9 ata që kanë dasht me vra Ganinë. Edhe unë jam këtu për q'ata.
10 PY. Po të tregoj tani një video dhe do të shpjegoj se çfarë
11 po ndodh, je dhe ti aty.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Është numri DHT04401, deri në
13 DHT04401. Fillon në minutën 3 dhe përfundon në minutën e 4.
14 Mund ta luani në shqip.

15 [Luhet video-incizimi]

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndalojeni.

17 PY. Personi që rri aty në këmbë me xhaketën e gjelbër është
18 vëllai jot, kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe personi që është i ulur me një xhaketë si të bardhë,
21 është Ganiu?

22 PË. Po. Vëllau është truproja e presidentit Rugova.

23 PY. Ja, prit një minutë ta dëgjojmë videon.

24 [Luhet video-incizimi]

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

1 PY. A mund të -- është një takim i partisë LDK, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Na thuaj se përse vëllai jot, vëllezërit u bënë të
4 dhunshëm në një takim të LDK-së, duke e përfshirë edhe Gani
5 Gecin që ti the se është një shpirt i pastër?

6 PË. Shumë i pastër -- edhe këtu ka lujt shpirtin ma të pastër
7 që janë mbrenda të tanëve q'aty. Këtu është kanë publike. Ka
8 reagu paq, pastër, me rujt diçka, "mos shkatërroni gjithçka",
9 ju ka thanë. E njerëzit që kanë dasht me shkatërru mbrenda
10 dihet tash. Ai person që, unë jam kanë aty mbrenda, që ka
11 shkatërru LDK-në në këtë formë është Fatmir Sejdiu. Që do të
12 merr përgjegjësinë historike, se ka pas marrëveshje me këta
13 për me ardh vetë me u bo kryetar dhe vetë me i marrë përsipër
14 të gjitha. Dhe ka shkatërru LDK-në. Ai e ka shkatërru LDK-në,
15 në marrëveshje me Hashim Thaçin. Dhe i kanë bo bizneset çka me
16 bo, ku me shku. Zyrtare, publike, është qe kjo e vërteta.

17 Edhe lutja e Ganiut, lutja jonë, "mosni, mos boni
18 kështu", publik për me, "mosni, mos e ndani përgjysmë LDK-në".
19 "Mosni, mos e boni këtë". Se është në dam të popullit të
20 përgjithshëm. Edhe u pa që është kanë dam. U pa që është kanë
21 dam. Për ata nuk më pyet, por po them është kanë dam shumë me
22 ardh aty.

23 Si President ka bo gabime, ka shkel kushtetutën, dhe
24 gjykata jonë -- ju jeni gjykata jonë, por gjykata atje duhet
25 me marrë masa për shkelje të kushtetutës. Ka bo negociata me e

1 nda Kosovën. E falënderoj, Ramush Haradinaj është i vetmi
2 person që e ka shpëtu pa nda Kosovën. Këta të tjerët kanë pas
3 marrëveshje. Gjetën mendje me Vuçiqin me nda Kosovën.

4 Ai person është ky. Kemi argumente edhe gjykata jonë do
5 të merret me këtë punë. Prandaj personi, personi kryesor
6 mbrenda LDK-së është Fatmir Sejdiu me Sabri Hamitin. Fatmir
7 Sejdiu dhe Sabri Hamiti në marrëveshje këta kanë përça, kanë
8 nda LDK-në në dy copësh për me ia arrit qëllimin me ardhë me
9 punët e veta.

10 PY. Kush ishte personi që e filloi këtë punë, që e qëllloi i
11 pari personin tjetër me karrige?

12 PË. Personi i cili i shkatërroi krejt, i largoi gjysmën e
13 delegatëve. E nuk u mor me ta hiç, ishte Fatmir Sejdiu. Edhe
14 ata gjysma e delegatëve prej Amerike, e prej Evrope,
15 kërkujshin mos me e shkatërrue, ndaluni njiherë, pusho.

16 PY. Dëshmitar, dakord. Po të tregoj dhe një dokument tjetër
17 dhe do të mbaroj.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] DHT04431 deri në DHT04435-ET. I
19 njëjti numër është dhe për shqip.

20 PY. Është nga 2003, është një raport që tregon se si e ke
21 rrahur vetë fizikisht Gani Kocin në parlament, në Kosovë. Të
22 mbahet mend?

23 PË. Po, mirë. Shumë mirë mbaj mend.

24 PY. Ishte hera e parë që dikush në parlamentin e Kosovës
25 përfshihet në një zënkë fizike, dhe ky ke qenë ti që je rrahur

1 me Sabri --

2 PË. Unë. Jam shty, se s'jam rrah, jam shty pak.

3 PY. -- Gani Kocin.

4 PË. Kjo e vërteta. Unë jam shty me Gani Kocin, dhe i kam
5 thanë, se më ka thanë, "kena me ju vra të tanëve".

6 PY. Raporti, sipas raportit, tregohet që ti e ke rrahur
7 fizikisht, e ke qëlluar.

8 PË. Ai ka fillu --

9 PY. Është bërë me gjak. [Folës që flasin njëkohësisht]...

10 PË. -- jam shty. Bon vaki edhe ia kam hi ma shumë. Unë nuk
11 kam kajtë, ai ka kajtë. Unë s'kam kajtë. Kjo është ajo.

12 PY. Në rregull.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Kaq kisha unë, z. Kryetar, për
14 pyetje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon.

16 Z. DIXSON: [Përkthim] Faleminderit, nuk kemi pyetje për
17 këtë dëshmitar.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Mbasi u konsultova
20 me klientin, edhe ne nuk kemi pyetje për këtë dëshmitar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Më jepni, më lejoni
23 një minutë.

24 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

25 Z. ELLIS: [Përkthim]

1 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

2 PË. Mirëdita.

3 PY. Unë jam Aidan Ellis, dhe përfaqësoj z. Jakup Krasniqi.

4 PË. Po.

5 PY. Do të përpiqem të mos e zgjas shumë, por ka disa tema që
6 dua t'i shtjellojmë bashkë. Do të filloj me LDK-në në vitet
7 1990. Besoj që këtyre pyetjeve mund t'u japësh përgjigje me
8 "po" apo "jo".

9 Është e saktë që ka pasur një degë të LDK-së në çdo
10 komunë të Kosovës, kështu?

11 PË. Po.

12 PY. Në komunën e Skenderaj, kryetari i degës ka qenë Idriz
13 Reksi [Sipas përkthimit], kështu?

14 PË. Idriz Rreci, po. Një burrë shumë i mirë.

15 PY. Dje keni folur për sa i takon këshillit të emergjencave,
16 në Skenderaj. Por përveç këtij këshilli, ka pasur dhe këshilla
17 të tjerë që kanë bërë punë shumë të rëndësishme, si për
18 shembull këshilli për arsimin, këshilli financiar, e kështu, a
19 është i saktë ky informacion, Dëshmitar?

20 PË. Po, e vërtetë është.

21 PY. Drejtuesit e këtyre këshillave në secilën prej komunave
22 kanë punuar bashkërisht ose në bashkëpunim të ngushtë me
23 drejtuesin e degës, apo jo, ose me kryetarin e degës, a është
24 e saktë kjo?

25 PË. Po, është shumë e saktë.

1 PY. A e kam kuptuar drejt që të paktën në fillim të 1998
2 secili prej degëve, ose secila prej komunave, ka pasur dy
3 përfaqësues që i çonte çdo të premtë në Prishtinë në mënyrë të
4 tillë që të takoheshin në nivel të LDK-së së përgjithshme në
5 Prishtinë, në godinën e Shoqatës së Shkrimtarëve. A është
6 kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Si kryetar i Skenderajt, Idriz Reksi [Sipas përkthimit]
9 ka marrë pjesë në takime të tilla, apo jo?

10 PË. Po, shumë herë edhe unë edhe ai.

11 PY. Në shumë raste nga komuna e Gllobovcit [fonetikiisht],
12 takimet në emër të komunës së Gllobovcit [Sipas përkthimit]
13 kanë marrë pjesë Mehdi Bardhi, Jakup Krasniqi. A është
14 informacion i saktë ky, Dëshmitar?

15 PË. Po, e vërtetë. Unë i kam çu shumë herë. Me kerr temin jam
16 shku bashkë, me i ul shpenzimet.

17 PY. Përqendrohuni tek z. Krasniqi për momentin. Është e
18 vërtetë, apo jo, Dëshmitar, që ai është zgjedhur si deputet i
19 parlamentit në vitin 1992. A e keni këtë informacion, a e dini
20 këtë gjë ju dëshmitar?

21 PË. Unë e di për komunën e Skenderajt mirë, se është komuna e
22 jem, por edhe për komuna të tjera sigurisht që ashtu është
23 kanë, tash [E pakuptueshme].

24 PY. Besoj që e kuptova atë çfarë thatë. Sepse sigurisht që ju
25 keni informacion për komunën e Skenderajt, LDK-në në komunën e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fadil Geci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z.Ellis

Faqe 92

- 1 Skenderajt. Ndërkohë që z. Krasniqi ka qenë i komunës së
2 Gllogocit, që është një komunë tjetër, kështu, Dëshmitar?
3 PË. Ka qenë një i komunës -- Drenasit, po. Komunë e Drenicës,
4 por komunë tjetër, komunë më vete.
5 PY. Në rregull. Për të qenë plotësisht të saktë, ju përmendët
6 fjalën "Drenas". Ndërkohë që unë përmenda komunën e
7 "Gllogocit", por ne po flasim për të njëjtën komunë, apo jo,
8 Dëshmitar?
9 PË. Po, po. E njëjta komunë është.
10 PY. Deri në 1998, Jakup Krasniqi u bë kryetar i degës së LDK-
11 së në Gllogoc, në Drenas, dhe ka fituar zgjedhjet aty së
12 bashku, domethënë ka qenë konkurrent së bashku Mehdi Bardhi
13 dhe ai dhe ai ka fituar për, zgjedhjet për të qenë kryetari i
14 degës së LDK-së, kështu?
15 PË. Edhe një herë pyetjen ma ngadalë, ju lutem?
16 PY. Po, patjetër. Unë po ju them këtë, që në 1998, Jakup
17 Krasniqi ka qenë kryetari i degës së LDK-së në Gllogoc dhe
18 fitoi kundër Mehdi Bardhit i cili po ashtu konkurroi për këtë
19 pozicion, për këtë post. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
20 PË. Po, veç duhet ta spjegoj pak, nëse më lejon Gjyqtari.
21 PY. Nuk më nevojitet sqarimi i mëtejshëm lidhur me këtë pikë.
22 Të falënderoj, gjithsesi. Megjithatë, ajo çfarë është e saktë
23 është që në këtë kohë z. Krasniqi ka qenë me LDK-në në
24 Gllogoc, në Drenas, dhe jo Prishtinë. Nuk ka qenë i stacionuar
25 ose nuk e ka pas qendrën në Prishtinë, por në Gllogoc. Kështu

1 ka qenë, Dëshmitar?

2 PË. Prej ditës së parë, një gabim historik që kam bo për
3 Drenicën, unë e pranoj. Unë e pranoj gabim historik, a ma fal
4 Drenica, të më falin, e kam ba. Jakup Krasniqin e kam kuptu,
5 është kuptu, është kanë ndikimi jem. Pa vota, pa vota është
6 kuptu në Drenas, edhe Gani Kocaj në Skenderaj. Edhe nuk kanë
7 qenë kurrë veprimtarë të LDK-së, veç të LPK-së. Të gjithë kanë
8 kërku me ia marrë kokën pa anëtarë, veç me e nxanë kokën. Kjo
9 është e vërteta. Dhe janë shty për LDK, është e vërtetë ça the
10 ti, janë shty për LDK edhe u bo kuvendi i jashtëzakonshëm dhe
11 ia ka marrë prapë Mehdi Bardhi. Si ia ka marrë Mehdi Bardhi,
12 ku u bo zëdhënës i UÇK-së, edhe dul aty me grusht që -- unë e
13 kam bukur jaran, e respektoj, veç me grusht ti të dalësh [E
14 pakuptueshme].

15 PY. Dëshmitar, të njëjtin problem në fakt e kishit dhe me
16 avokatin që ju bëri pyetje më përpara. Unë po ju bëj pyetje që
17 kërkojnë një përgjigje me po ose jo, ndërkohë që ju vazhdoni
18 të jepni një përgjigje shumë të gjatë që nuk ka lidhje me
19 pyetjen --

20 PË. Shumë konkrete. Shumë, domethënë se për me i kuptu të
21 tanë, edhe ti me i kuptu.

22 PY. Unë po ju bëj pyetje konkrete, unë po ju pyes si më
23 poshtë: Z. Krasniqi nuk ka qenë, nuk ka qëndruar në Prishtinë
24 në atë kohë, apo jo? Kaq e thjeshtë është pyetja. Po apo jo.

25 PË. Jo, në Prishtinë për çdo ditë ka ndejt në Prishtinë. Edhe

1 neve na thojke Zoti ju ndihmoftë për luftë, ka bo mirë, se
2 është kanë i interesum. Por për çdo ditë prej atje që i
3 mbajshin atje në qendër, për çdo ditë gati konferenca. Na
4 thirrke në telefon, thojke, "Zoti ju ndihmoftë, Zoti ju
5 ndihmoftë". Edhe ishte mirë ajo, na ka ndihmu Zoti, thashë
6 edhe dje.

7 PY. Në rregull. Le ta trajtojmë pak këtë gjë. Sepse kjo nuk
8 është e saktë, Dëshmitar. Kur ti thua që Jakup Krasniqi i ka
9 kalu gjithë ditët e veta në Prishtinë. Kur e ka bërë Jakup
10 Krasniqi këtë gjë?

11 PË. Prej marsit, prej sulmit të Jasharëve edhe deri në këtë
12 kohë që u bo zëdhënës, ka luftu, është kanë aktiv në
13 Prishtinë, në Drenas, me delegatë, lëvizje andej-këndeje, na
14 ishim në luftë, këta bojshin luftë për me marrë LDK-në. Na
15 ishim në luftë në Llaushë, këta, ky, Mehdi Bardhi bajshin me
16 marrë LDK-në, me ia marrë, me marrë LDK-në, kreun e LDK-së pa
17 anëtarë. Se s'ka qenë hiç anëtar i LDK-së, gjithë fallc është
18 kanë.

19 Le ta pranon si burrë se q'ashtu është kanë vallahi, nuk
20 them kurrgjë të pavërtetë. Ma mirë është e vërteta, edhe na
21 ndihmon të tanë, e kam respektue shumë, kam bo shumë për të, e
22 din edhe ky, edhe Gani Koca, për këta dy njerëz ma së shumti
23 kam bo për ta unë. Edhe ma së keqti ma kanë kthi. Edhe
24 Drenicës edhe ne.

25 PY. Atëherë, ta shtjellojmë pak këtë që sapo thatë. Së pari,

1 ti the që "ai nuk ka qenë fare anëtar". Sigurisht, që Jakup
2 Krasniqi në atë kohë ka qenë anëtar i LDK-së, apo jo,
3 dëshmitar?

4 PË. Ka qenë anëtar fallc. Që s'ka pas -- LDK-ja ka qenë
5 populli, komplet, ky ka qenë me marrë kalanë nga mbrenda.
6 Është kanë një farë grupi që kanë dashtë nga mbrenda me ia
7 marrë kalanë, me ia marrë kokën, tani me thanë "na jemi", dhe
8 kjo është vërtetu në kuvendin e fundit që Presidenti Rugova
9 jua ka ba jashtë, të tanëve. Edhe u pastru prej kësaj
10 kategorie. Kjo është e vërteta për opinion, e din krejt
11 Kosova, e din Shqiptaria, e dimë na. Kuvendin e fundit ju ka
12 thanë, ju ka dhanë vijë, ju ka ra vijë krejtëve.

13 PY. Do jua bëj dhe një herë pyetjen, Dëshmitar. Ju lutem,
14 përqendrohuni tek pyetja që po ju bëj.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
16 lejoni përkthyesin që të përfundojë me përkthimin pastaj
17 vazhdoni.

18 Z. ELLIS: [Përkthim]

19 PY. Do t'ju kërkoj dhe një herë që të përqendrohuni tek
20 pyetja që po ju bëj, dhe t'i jepni përgjigje pyetjes që po ju
21 bëj unë pa dhënë fjalime.

22 Ti the gjithashtu që:

23 "Ai po konkurronte kundër Mehdi Bardhit për t'u bërë
24 drejtues i LDK-së pa pasur mbështetës dhe pa pasur anëtarë. E
25 vërteta është që z. Krasniqi e fitoi votimin dhe u bë në fakt

1 kryetar i degës së LDK-së në atë komunë, po apo jo, dëshmitar?

2 PË. Po nuk ish kanë i rregullt, diçka fallco u bo aty, e di

3 Jakupi vetë. Jua kanë kontestu ato edhe e kanë kthy kuvendin

4 kryesia qendrore. Dhe është leju kuvendi i jashtëzakonshëm se

5 ka pas parregullsi aty, edhe është, ka fitu Mehdi Bardhi. Por

6 i ka kushtue, goxha stupc ka hëngër për atë punë. Për atë

7 punë. Në stupc e kanë rrehë. Jaranat e Jakupit.

8 PY. Edhe një herë. Nuk po i përgjigjeni pyetjes që po ju bëj

9 unë, Dëshmitar --

10 PË. Po të përgjigjena origjinalin që të dimë të tanë çfarë

11 është. [Folës që flasin njëkohësisht]

12 PY. -- por realiteti është që Jakup Krasniqi -- megjithatë,

13 rezultati përfundimtar është që autoritetet kanë konfirmuar, e

14 kam fjalën që autoritetet e LDK-së kanë konfirmuar Jakup

15 Krasniqin si kryetarin e degës së LDK-së në Drenas, në komunën

16 e Gllogocit, a është kështu, Dëshmitar?

17 PË. Jo. Jo.

18 PY. Në rregull. Këtë mendon ti. Gjithsesi mund të vazhdojmë

19 më tej. [Folës që flasin njëkohësisht]...

20 PË. Jo. Jo [E pakuptueshme] por u kontestu prej kryesisë

21 qendrore. Dhe është aprovu, është mbajt kuvendi i

22 jashtëzakonshëm se ka pas parregullsi. Jakupi i din këto vetë.

23 Të dytën herë kur është mbajt, e ka marrë Mehdija. Nji djalë

24 shumë i mirë, nji burrë shumë i fortë i Drenicës, që e ka pas

25 hak, e ka çdo hap që e ka qit, edhe gjithmonë është kanë afër

1 me i ndihmu Jakupit. E Jakupi nuk e ka traditë, veç ia ka kthy
2 me të keq vallahi.

3 PY. Dëshmitar, do ju lexoj diçka. Do t'ju lexoj atë çfarë i
4 keni thënë ZPS-së. Nuk kisha në plan në fakt që ta lexoja,
5 megjithatë do t'ju lexoj atë çfarë i keni thënë Prokurorisë në
6 shtator të 2018.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Për ata që na ndjekin, pjesa është
8 marrë nga deklarata juaj në faqen 3, Pjesa 4, 054034.

9 PY. Këto janë fjalët tuaja:

10 "Nuk e di në qoftë se ka qenë fundi i 1997 apo fillimi i
11 1998, por ka qenë periudha kur është organizuar kongresi dhe
12 Jakup Krasniqi u zgjodh si kryetar. Ai e fitoi këtë pozicion
13 kundër Mehdi Bardhit. Mehdi Bardhi e kontestoi këtë zgjedhje
14 si të parregullt dhe kërkoi një asamble të jashtëzakonshme. U
15 bë votimi dhe përsëri Jakup Krasniqi u zgjodh kryetar."

16 Këtë keni thënë në 2018 në deklaratën që i keni dhënë
17 Prokurorisë, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Është marrë, është murr, se këtu në përkthim po merret
19 gabim por kjo "kontestuse", është kur ka parregullsi. Kryesia
20 qendrore vendos a ka parregullsi, a s'ka parregullsi. Aty kanë
21 vendos me e mbajt një kuvend të jashtëzakonshëm dhe me siguri
22 ka pas parregullsi se ato s'janë punë të mijat me u përgjegj
23 unë, por ato kryesia, punët e kryesisë qendrore janë. Por ka
24 pas parregullsi dhe është mbajt një kuvend i dytë. Ato e din
25 ma mirë Jakup Krasniqi edhe ai e shpjegon ma mirë, edhe Mehdi

1 Bardhi, edhe pse është i lodht tash, s'mund me folë, në
2 gjendje të keqe, por këta të dy, edhe e din Drenasi, jo unë.
3 S'janë punë të mijat shumë ato.

4 PY. Më thonë që në faqen 81 ka një rresht që mungon në
5 përkthim. Rreshti 12. A ke thënë që:

6 "Ai është shok i mirë me mua, por ai nuk duhej që të
7 përdorte grushtin."

8 E ke thënë, apo jo, domethënë thuajse tre faqe përpara, e
9 ke thënë apo jo, Dëshmitar? [Folës që flasin njëkohësisht]...
10 PË. Po, edhe sot -- po edhe sot kam respekt për atë burrë.
11 Shumë kam respekt, unë e kam dasht Jakupin. Po ka pas bindje
12 tjetër. Dhe me grusht ka përshëndet, qite këtu, qysh do
13 thojshë, [E pakuptueshme] në Rusi. E ka pas mendimin,
14 ideologji e ka, ideologji. Edhe nuk muj me ia hjek. Iu ka,
15 qashtu iu ka shpëla trutë. Qashtu qysh është, është i mirë.
16 Qysh është, apet e du.

17 PY. Gjatë kësaj periudhe që ka qenë nga fillimi i 1998, ju
18 keni qenë pjesë të komunave të ndryshme. Ti dhe Jakup Krasniqi
19 nuk është se ke punuar, nuk keni punuar drejtpërsëdrejti me
20 njëri-tjetrin, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Jo, por kam qenë të lidh për të gjitha proceset, dhe
22 atëherë kur ishim ngushtë me Serbi u lidhshim fort. Jam kanë
23 bashkë [E pakuptueshme].

24 PY. Po ashtu, i keni thënë në intervistën që i keni thënë
25 Prokurorisë në vitin 2018, që personalisht ju nuk e keni

1 biseduar me Jakup Krasniqin se pse është larguar ai nga LDK-
2 ja.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Për procesverbal këtë e keni thënë
4 në rreshtin 10, Pjesa 4, faqja 4.

5 PY. Është e vërtetë kjo, Dëshmitar, që nuk keni biseduar
6 asnjëherë me Jakup Krasniqin lidhur me arsyet se pse është
7 larguar nga LDK-ja?

8 PË. Jo, nuk kam bisedu se mu s'kam mujt me fol hiç. Unë tani
9 jam kanë kundërshtari më i keq i tijna. Ai -- Jakup, qysh
10 ashtu, por mu më ke njoft mirë, më ke dit kush jam, me shkru
11 me e fol ashtu. Më vjen shumë keq që e ke dit për mue edhe për
12 që flet ti ashtu, po bindja politike janë, jo ashtu me shku në
13 atë shkallë. Kriminel e kriminel, e me shkru histori e rrenë.
14 Keq ka bo, historian është.

15 Por unë besoj që e din dhe vetë që nuk është kanë ashtu.
16 Edhe sido që të jetë, qysh do të jetë, Jakupin kam respekt.
17 Idhnohet kaiher, e di që e ka sheqerin, e ka sëmundjen aty kah
18 pak, edhe unë e kuptoj që njëni kur është pa qejf mund të
19 shkruj në efekt edhe të dallosh. Unë kam respekt për të. Për
20 vëllazërit Geci nuk ka shkru drejt. Ka shkru gabim. Është mirë
21 me dalë para juve edhe me thanë --

22 PY. Dëshmitar, përsëri po jepni shumë më tepër informacion që
23 ju kërkova. Nuk ka lidhje me pyetjen kjo që po thoni.

24 Mendoj që në përgjigje ju u pajtuat me mua që nuk keni
25 biseduar me Jakup Krasniqin për arsye se është larguar nga

1 LDK-ja. Është e vërtetë kjo apo jo, po apo jo, Dëshmitar?

2 [Folës që flasin njëkohësisht]...

3 PË. O s'ka bisedu -- o s'ka bisedu me mu ma hiç, u bo i madh
4 edhe mu, Fadilin, duhet hiç s'u merr më. Le për mirë që s'u
5 merr, por për të keq kah pak u merr. Që po më duket krejt pa
6 vend.

7 PY. Arsyeja që nuk keni biseduar me të, është që ju nuk keni
8 një marrëdhënie personale me të në mënyrë të tillë që të mund
9 të diskutonit çështje të tilla, a është e drejtë kjo të
10 thuhet?

11 PË. Ai s'ka pas ma marrëdhënie me mu. Ai nuk ka pas më
12 marrëdhënie me mu as kurrë më nuk ka fol me mu, as kam fol me
13 të. Shumë keq. Çka i vyjsa unë më Jakup Krasniqi? Ai u bo i
14 madh, unë kurrgjë. Kush jam unë?

15 PY. Përpara një jave i thatë Prokurorisë se Jakup Krasniqi
16 gjithmonë ka qenë person i LPK-së. Unë po ju them
17 drejtpërsëdrejti, Dëshmitar, Jakup Krasniqi nuk ka qenë
18 asnjëherë anëtar i LPK-së, apo jo?

19 PË. Jakup Krasniqi ka qenë i OMLK-së, organizatës marksiste-
20 leniniste, edhe në atë drejtim ka luftue si luan. Bravo i
21 kjoftë, drejtimin e ka, me ia hjek s'mujm. Por kjo është e
22 vërteta, që një organizatë marksiste-leniniste që e ka qujt
23 Amerikën armik, është e dëmshme për shqiptari. Edhe ka hjek,
24 edhe në burg, edhe me i bo dam vetes, me na bo dam.

25 E na e kemi respektu shumë, i kemi respektu këta të

1 burgosur, këta djem. Unë posaçërisht shumë, gjithçka kam dhanë
2 për ta. Dhe momentin kur i kam pa që ka diçka krejt në
3 drejtim, përnjëmend është kanë në atë drejtim, jam nda prej
4 tyne.

5 PY. Jakup Krasniqi nuk ka qenë anëtar i LPK-së, apo jo,
6 Dëshmitar?

7 PË. Ka qenë anëtar, një herë OMLK-së, organizatë marksiste-
8 leniniste, tani u shndërru në LPK. Këta janë një drejtim. Tani
9 u shndërru, hala njerëz si të majtë, prej të majtëve, kur i
10 kanë bo do pasuni janë bo të djathtë me e ru atë pasuni, edhe
11 ndërrime mos vet hiç. Ia kanë -- këto janë të vërteta.

12 PY. Dëshmitar, sot jeni këtu nën betim që të thoni të
13 vërtetën. Unë po jua them troç, Jakup Krasniqi nuk ka qenë
14 anëtar i LPK-së. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

15 PË. Po si, unë po të them ty -- ku po e din ti, po si po thu
16 ti, unë po them diçka tjetër. Ka qenë organizatë marksiste-
17 leniniste. E konvertume në LPK, e prej LPK-ve këta janë LBD,
18 është kanë një farë -- prej LBD-ve në PPT, po s'di ç'a u kanë
19 ajo PTP, e prej asaj tjetrës është ardh në këtë tjetrën, edhe
20 prej asaj del q'etu të majtë. Organizatë e majtë, me grusht,
21 me përshëndet me grusht, që është kanë e dëmshme.

22 Dhe kjo është organizatë e majtë komuniste. Jakupi biles
23 qysh s'e ka bo hesap që është Amerika këtu. Se sikur t'ish
24 kanë Rusia krejt na kishin pushkatu. As dhe një s'ishim gjallë
25 sot. Por shqyr, nuk e kanë ditë -- me metoda komuniste u

1 vepru. Me metoda Marksiste-Leniniste, me t'i vra shokët, mu
2 kanë vra katër, gjashtë shokë të Drenicës m'u kanë vra mu. Nuk
3 më lanë me fol hiç. Njerëz ma të mirë të mundshëm u kanë vra
4 këta -- Haki Imeri u vra, Xhaferr Bajrami u vra, u kërcënu
5 Bahtir Kastrati, një burrë shumë i fortë i asaj ane. Ismet
6 Rrahmani është vra.

7 PY. Dëshmitar, prapë do ju ndaloj sepse po largoheni shumë
8 nga pyetja që ju bëra. Unë e kuptoj që ju nuk doni t'i
9 përgjigjeni kësaj pyetjeje. Kështu që do vazhdojmë me një
10 pyetje tjetër.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares të
12 paraqesë në ekran dokumentin DJK01051, në shqip dhe në
13 anglisht. Dokumenti mban të njëjtin numër në të dy versionet.
14 PY. Nga fillimi i faqes së parë, Dëshmitar, mund të shikoni
15 që ky është një artikull që ka titullin "Takimi i parë i UÇK-
16 së me diplomatët amerikanë". Artikulli mban datën e 6
17 dhjetorit 2023. Është një intervistë ekskluzive me Bardhyl
18 Mahmutin.

19 Ju Bardhyl Mahmutin e keni përmendur në seancën
20 përgatitore edhe ju keni thënë që e dini që ai ka qenë anëtar
21 i LPK-së në Zvicër. Kjo është e saktë, apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Unë e di që ka qenë. Ai mund të deklarohe vetë.

23 PY. Korrigjoj transkriptin, në rreshtin përkatës që është
24 rreshti 14, thashë "anëtari i LDK-së", por ndërkohë nuk e
25 kisha fjalën për anëtar i LDK-së, ka qenë anëtar i LPK-së,

1 Bardhyl Mahmuti, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Kjo është e vërtetë. Unë, çka di unë. Pra unë muj edhe me
3 gabu aty, LPK, LDK, këta një kanë qenë o burrë, zotëri Avokat.
4 Këta kanë qenë të njëjtën organizatë, të majtë. Që kanë mendue
5 metoda komuniste me ardh në pushtet. Me i marrë, kjo kështu ka
6 qenë. Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni. Llum
7 proletar. Zibidi, faqezi, delenxhi, çohuni në këmbë, kapni
8 stupcat, mbytni shtëpijat e mira, mbytni pasuni, merrni dhe
9 ato, ça ka të gjallë, edhe kryhet puna. Bahet shteti komunist.
10 Këto, kjo është e vërtetë. Por nuk iu ka shku ashtu. Shyqyr që
11 s'u shku. Edhe shumë kam pas pasoja në atë drejtim.

12 PY. Atëherë, do shikojmë pak faqen e dytë të artikullit që
13 keni përpara. Paragrafi i katërt, paragrafi i katërt dhe i
14 pestë. Këtu është shumë e qartë, apo jo, që Bardhyl Mahmuti,
15 që vetë ka qenë anëtar i LPK-së, e bën të qartë që Jakup
16 Krasniqi nuk ka qenë asnjëherë anëtar i LPK-së.

17 Bardhyl Mahmuti e ka ditur kush ka qenë anëtar i LPK-së e
18 kush nuk ka qenë apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Këto janë punë të tyne. OMLK, organizatë marksiste-
20 leniniste, është i dënum Jakup Krasniqi. Është e kjo? A
21 i bjen ça po të thom unë? OMLK, organizata marksiste-
22 leniniste.

23 PY. Ti e di me siguri që nga viti 1992 deri në 1998, Jakup
24 Krasniqi ka punuar me LDK-në në komunën e vet, në Glllogoc, apo
25 jo? Jo me LPK-në.

1 PË. Tjetër organizim. LDK-ja është kanë krejt budall, 99 për
2 qind janë kanë një një vend. Aty këta kanë punue, edhe ky, si
3 një djalë i mirë, e kemi respektu shumë, e kemi avit, e kemi
4 kuptu pa vota, që kam ndikim shumë unë te Mehdia që e ka
5 kuptu. Se s'ka dashtu me e kuptu. Dhe mbrenda ka veprue deri
6 në momentin kur i ka ardh momenti me i marr kokën, pa anëtar.
7 LPK-ja s'ka pas anëtarë në Kosovë. Asnji anëtar, të gjithë
8 kanë qenë LDK. Kanë qenë 100, janë nda në vota, Rexhep Qosja u
9 dal në vota, ka marrë 1000 vota. S'ka pas anëtarë LPK-ja, e
10 majta në Kosovë, në Drenicë s'ka pas anëtarë, as dhe një.

11 PY. Do t'ju lexoj gjithashtu edhe pjesën e pyetjeve-
12 përgjigjeve në fund të kësaj faqeje. Pyetja që i bëhet Bardhyl
13 Mahmutit në këtë intervistë është kjo:

14 "Në çfarë kuptimi emërimi i Jakup Krasniqit për zëdhënës
15 të UÇK-së ishte argument i fuqishëm në duart tuaja?"

16 Përgjigja që jep Bardhyl Mahmuti është:

17 "Për arsye se ishte një dëshmi që nuk mund të kontestohet
18 se vullneti i LPK-së ishte bashkimi i të gjithë shqiptarëve
19 për çlirimin e vendit pa marrë parasysh dallimet klasore,
20 ideologjike, partiake, religjioze ose krahinore."

21 Kjo ka qenë arsyeja apo jo? Që të kishe dikënd si Jakup
22 Krasniqi nga LDK-ja në UÇK-s ishte diçka që i vyente UÇK-së?
23 Kjo është arsyeja se pse është emëruar ai, apo jo, Dëshmitar?
24 [Folës që flasin njëkohësisht]

25 PË. Jo, jo. Hiç s'e ka thanë -- hiç ai s'e ka thanë të

1 vërtetën këtu. I ka bishtru të vërtetës. Se LDK-në Bardhyl
2 Mahmuti e ka sulmu me krejt fuqi. Sa për LDK kurrë Jakup
3 Krasniqi s'ish bë zëdhënës. Kurrë. U bë zëdhënës përfaqësues i
4 organizatës marksiste-leniniste edhe dashamir i madh tash po
5 del i LPK-së. Ato janë, një vend janë kanë, dy organizata, një
6 vend. Të njëjtën ideologji e kanë pas, të njëjtën.

7 Veç nuk u dasht Jakupi kundër vëllazërve Geci. Pse bre
8 Jakup kështu me u ba? Pse kundër vëllazërve Geci që të kanë
9 nderu shumë e të kanë respektu shumë? E kanë bo për ty shumë?
10 Pse me shkru aty çka s'është histori me e shkruet? Ti e din që
11 ato tubime i ka organizu LDK-ja edhe UÇK-ja ka majt me dalë
12 veç në Llaushë, aty ku e kanë organizu vëllazërit Geci, me
13 krejt Llaushën edhe prej Prekazin. Jo në Qirez e Likoshan. Ke
14 bo gabim, Jakup.

15 PY. Dëshmitar, Trupi Gjykues është i interesuar për dëshminë
16 tuaj bazuar në faktet, jo në deklaratat politike, në fjalimet
17 politike. [Folës që flasin njëkohësisht]...

18 PË. Këto që po i them 200 për qind me jetë betohena që janë
19 fakte. Betohena me jetë që çka po them është fakt.

20 PY. Nuk të bëra këtë pyetje, Dëshmitar. Në fakt pyetja ime
21 është kjo: A po na thoni që Bardhyl Mahmuti është një person
22 tjetër që ju po na thoni këto dy ditët që keni qenë në
23 Gjykatë, që edhe ky ka gënjyer, këtë po thoni?

24 PË. Nuk e ka thënë këtë. LDK-në e ka sulmu ai me krejt fuqinë
25 Bardhyl Mahmuti, kundërshtari i LDK-së më të madhe nuk,

1 komplet ekipi, edhe ai person gjithë. Kurrgjë këta s'kanë pas
2 me LDK hiç. LDK-ja është kanë pengesë për ta, për me marrë
3 frymë. Edhe kanë dasht me likvidu të gjitha pengesat që i kanë
4 pas. Në Drenicë 4 bashkësi lokale ma të mëdhajat, Xhaferr
5 Bajrami u vra, drejtori i shkollës, kryetari i nëndegës. Haki
6 Imeri, u kanë sa u kanë Haki Imeri atje, dy fakultete, s'ka
7 pas tjetër parti atje. Bahtir Kastrati u kërcënu me jetë,
8 Ismet Rrahmani, themeluesi i akademisë të parë ushtarake në
9 Aqarevë. Është vra. Janë kërcënu njerëz të tjerë për me shujt
10 LDK-në për me ec tjetër organizim. Me luftën për pushtet e
11 kanë bo, kanë gabu na kanë bo dëm Kosovës. Ma mirë është kanë
12 me i bo me i njoft institucionet, me e njoft shtetin, me luftu
13 për shtet të Kosovës -- [Folës që flasin njëkohësisht].
14 PY. Dëshmitar. Do t'ju ndaloj përsëri. Edhe një herë, unë po
15 them që juve po e përdorni këtë Gjykatë për të bërë deklarata
16 politike.

17 Do kaloj tek një tjetër person përpara se të shkojmë për
18 pushimin e drekës. Më herët gjatë dëshmisë tuaj keni folur për
19 Ramë Bujën. Është e drejtë të thuhet apo jo, Dëshmitar, që
20 Ramë Buja ka qenë pjesë e kryesisë së LDK-së, është e drejtë
21 kjo, është e vërtetë kjo?

22 PË. Po të gjithë këta të burgosun që janë ardhë në 1990 që
23 janë lëshu prej burgu, i keni dasht shumë. I kemi nderu shumë.
24 I kemi respektu shumë. Gjithçka kam bo unë për ta, edhe
25 populli i Kosovës. Dhe i kemi pranë në gjirin tonë. [Folës që

1 flasin njëkohësisht]...

2 PY. Dëshmitar. Do ju ndërpres dhe një herë këtu. Është një
3 pyetje që kërkon përgjigje me "po" apo "jo". Ramë Buja ka qenë
4 anëtar i kryesisë së LDK-së, po apo jo?

5 PË. Po, ka qenë. Edhe kryetar i degës së Lipjanit.

6 PY. Në rregull.

7 PË. Por ka qenë marksist-leninist --

8 PY. Faleminderit.

9 PË. -- ka qenë Marksist-Leninist i përbetum. Nji djalë i
10 mirë, i mençum, tana të mirat. Marksist-leninist ka qenë. Edhe
11 është q'ashtu hala. Shumë e respektoj, edhe më don, edhe e du,
12 por qashtu.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Shoh kohën, ndoshta do ishte mirë që
14 të kalojmë te pushimi i drekës tani përpara se sa të dëgjojnë
15 ndonjë akuzë tjetër për ndonjë person tjetër.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
17 pushimin e drekës tani, Dëshmitar. Kemi pushim për një orë e
18 gjysmë. Do kthehem përsëri në orën 14.30. Ju lutem mos flisni
19 me askënd lidhur me dëshminë tuaj, me askënd tuaj përveç -- me
20 askënd tjetër që nuk është i pranishëm në sallën e gjyqit.

21 DËSHMITARI: Faleminderit.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të kërkoj në
24 qoftë se ka ndonjë përditësim sa i takon kohës për të ditur në
25 qoftë se duhet ta mbajmë dëshmitarin tjetër këtu apo jo.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, dhe
2 sa kohë ju duhet?

3 Thjesht për ta ditur.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Po merr më shumë kohë se sa kisha
5 planifikuar unë të paktën deri tani. Megjithatë nuk do më
6 duhet më shumë se sa një orë. Do mundohem që të përfundoj më
7 përpara se sa një orë, por besoj që kaq do më duhet pak a
8 shumë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa do
10 bëjmë pushimin e drekës tani dhe të paktën z. Ellis do të ketë
11 30 minuta deri në 45 minuta, mbase ju do keni pyetje të tjera
12 plotësuese. Gjykatësit do keni pyetje po ashtu. Besoj që mund
13 ta lironi dëshmitarin që po pret. Nuk do kemi dëshmitar tjetër
14 për sot. Mendoj që do të fillojmë nesër paradite herët me të.

15 Do bëjmë pushimin e drekës deri në 14.30 tani.

16 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

17 --- Seanca fillon në orën 14.31

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
19 ju jeni ngritur në këmbë.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po. Kam një çështje administrative
21 nëse më lejoni ta ngre shkurtimisht.

22 Sot ZPS-ja paraqiti numrat e provave 2667, që është në
23 fakt një mocion i paraqitur prej tyre që është një
24 korrespondencë dhe kërkojmë një shtesë kohe për t'u përgjigjur
25 që do të ishte 15 nëntori dhe Prokuroria nuk e kundërshton.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me

2 mirëkuptimin e palëve, sigurisht që do ta miratoj.

3 Pra, shtyhet deri në 15 nëntor në fund të ditës së punës.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

6 z. Geci, z. Ellis ka edhe disa pyetje të tjera. Dëgjojini me

7 vëmendje.

8 Vazhdoni.

9 Z. ELLIS: [Përkthim]

10 PY. Përpara pushimit të drekës po flisnim për Ramë Bujën. Sot

11 në mëngjes në faqen 9 të transkriptit thatë se Ramë Buja të

12 tha që:

13 "Kam pasur pasoja për shkak se kam folur në emrin tuaj.

14 Madje tha që dhe 'Më qëlluan me plumb sepse ju kam mbrojtur'."

15 A ju kujtohet që e thatë këtë sot në mëngjes?

16 PË. Po

17 PY. Në deklaratën përgatitore, paragrafi 2, rreshti 18 thatë

18 që Ramë Buja ju tregoi një shenjë që i kishte ngelur në

19 fytyrë, kështu është?

20 PË. Po, është e vërtetë. Edhe në gisht e ka pas.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem paraqisni në ekran

22 materialin SITF00009397. Uluni pak më poshtë në faqe.

23 PY. Po ta shikoni është nga dëshmia e Shukri Bujës në 26

24 shtator 2011 në një çështje të quajtur Arben Krasniqi dhe të

25 tjerë. Besoj ju e dini që Shukri Buja është vëllai i Ramë

1 Bujës, apo jo?

2 PË. Veç e di që është vëllai, lidhje s'kam me të. Me Ramë po
3 gjithë. Me Shukrinë kurrë.

4 PY. Unë ju pyeta vetëm që të më thoshit nëse është vëllai,
5 kaq.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë tani në njëjtën dokument,
7 në anglisht është faqja 9401 në shqip 9402. Ju lutem uleni pak
8 faqen në anglisht.

9 PY. Këtu flet për një periudhë në fund të marsit apo fillim
10 të prillit 1999. Dhe e pyesin:

11 "Ishte plagë serioze ajo që kishte vëllai?"

12 Shukri Buja thotë:

13 "Po. Ai ishte i plagosur këtu.

14 "(Dhe me gisht tregon qafën, poshtë mjekrës).

15 "Nuk e di nëse ishte në anën e djathtë apo të majtë."

16 Pyetja:

17 "Si e keni ditur se që ai ishte i plagosur?"

18 Përgjigja:

19 "Ne ishin së bashku kur ndodhi kjo. Ne ishim duke i
20 vizituar pozitat tona së bashku me Fatmir Limajn. Ishin dhe ca
21 ushtarë të cilët i kishin zënë pozicionet e veta. Ndodhi një e
22 shtënë dhe Rama u plagos. Ne e tërhoqëm shumë shpejt dhe ishim
23 të detyruar ta mbartim deri në spital. Unë dhe ushtarë të
24 tjerë e mbartëm atë deri në makinë dhe e dërguam deri në
25 spital."

1 Pyetja:

2 "A është plagosur dhe dikush tjetër gjatë të shtënave?"

3 Përgjigja është:

4 "Unë kam pësuar ca të mavijosura në këmbë. Nuk kisha
5 plagë. Mendoj se isha i goditur nga fragmentet e municionit
6 apo të plumbit."

7 Pra, është shumë e qartë Shukri Buja thotë që shenja që
8 kishte në faqe erdhi nga të shtënat që ndodhën në pranverën e
9 1999, kështu?

10 PË. Ishalla a q'ashtu. Ai mu mi ka thënë geto. Unë ma qejf
11 kam me kanë q'ashtu qysh po thu ti se ajo që më ka thënë mu. A
12 mu m'i ka thënë. Ai a gjallë. Vetë mu mi ka thënë në zyrë.
13 Ishalla qashtu. Ishalla del q'ashtu. Se qejf kam kun diçka e
14 keqe mes veti mos me pas. Ai e ka thënë vetë. Ai të del dhe të
15 deklarohet a më ka thënë a s'më ka thënë.

16 PY. Në qoftë se lëndimi ka ndodhur në mars apo prill të 1999
17 gjatë atij incidentit me të shtëna, nuk ka të bëjë fare me
18 Komunikatën 59, apo jo?

19 PË. Hiç nuk jam hi në atë punë unë. Hiç në atë punë nuk më ka
20 interesu ma ndejna hiç. Këto m'i ka thënë vetë ai më ka ngrit
21 për dore më ka thënë. Nuk më ka thënë veç për komunikatë po
22 kam fol keq që din ai për neve çdo herë kur janë kanë. Paska
23 fol keq edhe Jakup Krasniqi në libër që s'kisha besu kurrë që
24 flet keq. Po qe e pashë me sy që ka shkru ç'a s'a, që tash po
25 besoj.

1 PY. Në fakt, ti e pe librin e z. Krasniqi javën që shkoi kur
2 ta tregoi Prokuroria apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Që të jemi të qartë, data e Komunikatës 59 është tetor
5 1998, kështu?

6 PË. Po. Sigurisht, po.

7 PY. Tani do të kalojmë në një temë tjetër që është funerali
8 në Likoshan në 3 mars 1998, për të cilën Prokurori të bëri
9 disa pyetje dhe i je referuar disa herë.

10 Është e saktë që sulmet serbe në Likoshan dhe Qirez në
11 fshatrat e tyre në 28 shkurt 1998 vranë 24 civilë shqiptarë,
12 kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe pastaj u organizua një procesion mortor nga dega e
15 LDK-së në Gllogoc dhe Skënderaj se viktimat ishin nga të dy
16 komunat. Kështu ka qenë?

17 PË. Po, është e vërtetë ajo.

18 PY. Faleminderit.

19 PË. Tjetër organizim s'ka pas atëherë veç ne. Dhe këto i ka
20 dit Jakupi mirë.

21 PY. Jakupi u morë me organizimin e këtij funerali sepse ishte
22 kryetari i degës të Drenasit të Gllogocit në atë kohë, apo jo?

23 PË. Mehdi Bardhi ka qenë. Ala nuk kanë qenë ato. Mehdi Bardhi
24 ka qenë.

25 PY. Ti na the se Luljeta Pulaj mbajti një fjalim aty ku

1 kritikoi Ibrahim Rugovën. Të kujtohet që e the këtë?

2 PË. Shumë më kujtohet, edhe krejt popullit të Kosovës i
3 kujtohet. Shumë ka qenë e vërtetë ajo. Për fushatë ka mendu që
4 po fiton, po ajo ka hup për gjithmonë. Kurrë më në sipërfaqe
5 s'ka dalë. Veç e aty e ka thy këmbën e vet, nuk a e mirë. E ka
6 pas besim populli në të. Qaty më kurrë deri sot kurrë më pa
7 s'e kam. Edhe qaty i ka tregu që Drenica nuk është kundër
8 Ibrahim Rugovës.

9 PY. Ti vëllezërit e tu ishit ata që u ngritën, reaguat kundër
10 fjalimit të saj atë ditë, kështu?

11 PË. O ka reague komplet masa. U kanë një diçka e tmerrshme.
12 Reagimi ka qenë i tmerrshëm.

13 PY. Po ti ishe një ndër ata që reaguat, po apo jo?

14 PË. Po reagimi ka qenë i 200,000 vetëve. Reagim ka qenë i
15 tmerrshëm, i 200,000 vetëve u kanë një reagim. Po edhe unë ka
16 reague. Edhe vëllezërit kanë reague. Edhe tanë kanë reague.
17 Ata që kanë pas mend pak me reagu. Kurse ata që janë habit
18 mbas ideologjie, po thojnë që mirë e ka pas. Mbas pushtetit,
19 lakmia e pushtetit po t'i qërrojke sytë.

20 PY. Dhe në emër të komunitetit organizator si kryetar i degës
21 së Gllogocit, Jakup Krasniqi u orvat ta qetësonte situatën,
22 apo jo?

23 PË. Qetësimin e situatë e kanë përdorë krejt popullata.
24 Prindët e të vdekurve, Sheremet Sejdiu e të gjithë të tjerët
25 kanë reagu dhe kanë hjek pej bine. Ja kanë ndalë fjalën.

1 Reagim të ashpër ka bërë Mehdi Bardhi. Reagim të ashpër ka bërë
2 Halil Geci dhe krejt vëllazërit edhe krejt ai rreth aty që u
3 kanë.

4 PY. Ti e di kush është Jakup Kastrati, apo jo?

5 PË. Po qysh s'e di. Një burrë prej Malisheve, një burrë i
6 mirë shumë.

7 PY. Dhe ai ishte nga LDK-ja e Malishevës?

8 PË. Nga Malisheva, ishte kryetar i LDK-së. I arrestum dhe i
9 mbajtun një muaj në burg në burg pa asnjë arsye, veç pse ishte
10 i LDK-së, me gjithë Cen Deskun. Dy burra ma të mirë të atij
11 regjionit. Faleminderit që po mi qet se po i harroj. Ti po mi
12 qet ndërmend.

13 PY. Pyetja që po të bëj është pak e ndryshme dhe përqendrohu
14 tek pyetja që po të bëj. Jakup Kastrati ka dhënë një deklaratë
15 rishtazi për këto ngjarje, ku thotë se Jakup Krasniqi vetë u
16 tërhoq dhe tha "Unë jam kryetar i LDK-së. Unë jam pjesë e LDK-
17 së. Ajo që ajo tha ishte gabim". Këtë ka thënë Jakup Krasniqi
18 në rastin e Likoshanit, apo jo?

19 PË. Është mundshme dhe ka thënë atë. Nuk kam thënë. Paska
20 thënë ai. Nëse ka thënë ashtu ai ka thënë. Q'ashtu ka mendu
21 q'ashtu ka thënë. Po Jakup Kastrati është një burrë i mirë,
22 një veprimtar i mirë që ka vuajt një muaj ditë burgjeve edhe i
23 kanë shku te shtëpi më s'ka ba zë, i ka ndalë fjalët. Ku i ka
24 shku te shtëpia Hashim Thaçi i ka ndalë fjalët.

25 PY. Nuk po të pyesja për këtë. Po kalojmë me një temë tjetër

1 në lidhje me Likovcin. Në deklaratën përgatitore, deklarata 2,
2 paragrafi 25 the se gjatë luftës nuk ke dashur kurrë të shkoje
3 në Likoc dhe nuk e ke pasur asnjëherë qendrën në Likoc. Kështu
4 ka qenë?

5 PË. Kështu ka qenë. Qendra në Likoc ka qenë e LPK-së, UÇK-së
6 e quajton e uzurpume UÇK. E LPK-së. Unë e kam pas drejtim
7 tjetër. Drejtimi jem ju kam spjegue.

8 PY. Në rregull. Në qoftë se më duhen shpjegime të tjera do të
9 pyes. Po për momentin po ju pyes qartë këtë, pra, ti nuk ke
10 shku vetë personalisht dhe nuk e di vetë personalisht nëse ka
11 qenë aty Jakup Krasniqi apo ç'ndodhte aty në atë vend, kështu?

12 PË. Jo, jo, hiç unë. Hiç unë. Në atë drejtim s'kam lidhje në
13 Likoc hiç. Unë s'kam lidhje me Likovc hiç.

14 PY. Faleminderit. Tani kalojmë në një temë tjetër që është
15 përshëndetja. Ti i the Prokurorit në intervistën e 2018 dhe
16 është Pjesa 3, faqja 4, se:

17 "... Jakup Krasniqi përshëndeste me grusht si në Rusi.
18 Ishte në televizor. Me siguri që e di."

19 Pyetja që kam për ty është: Nuk i ke dhënë Prokurorisë
20 ndonjë hollësi për këtë program televiziv, datën kur është
21 transmetuar, në çfarë programi. Nuk ia ke dhënë këto të dhëna?

22 PË. Unë besoj që Prokuroria tëna i ka edhe Gjykata edhe krejt
23 Kosova e din se përshëndetjet me grusht kanë qenë të kësaj
24 organizate. Dhe janë dalë zyrtarisht, në momentin që u dalë
25 publik Jakup Krasniqi u dalë me grusht.

Dëshmitari: Fadil Geci (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 116

1 PY. Po.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani të shohim pak materialin 078323
3 deri në 07850 në faqen 78418.

4 Ndërsa presim të dali dokumenti, harrova që të paraqisja
5 një material për ta pranuar që është DJK01051 deri në
6 DJK01055, po e paraqes tani.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
8 kundërshtim?

9 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk ka.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra,
11 dokumenti DJK01051 pranohet.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë.
14 T'i japim një numër përpara sesa të vazhdojmë.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është, sa për sqarim,
16 është një artikull i tërë që ka dy faqe?

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Po.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë është dokumenti
19 DJK05050 do të pranohet si dokument me numrin 4D00088. Është
20 dokument publik. Faleminderit.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë poshtë tek faqja që ka
22 dalë në ekran tani.

23 PY. Dëshmitar, të kujtohet kjo faqja si faqja e parë e librit
24 që ka shkruajtur vëllai ju, Gani Geci?

25 PË. Po, po.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në faqen

2 074383. Edhe besoj që në shqip është e njëjta 078382.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Sa për ta sqaruar,
4 anglishtja dhe shqipja janë në të njëjtin dokument?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, besoj. Faleminderit.

6 PY. Paragrafi që po shohim është ai që ka të bëjë me Shaban
7 Shalën. Është në mes të faqes në anglisht nga libri i vëllait
8 tënd:

9 "Pastaj doli në diskutim përshëndetja me grusht. Shaban
10 Shala u paraqitë në televizorin shqiptar të përgatitur nga
11 Nuhi Bytyqi duke përshëndetur me grusht dhe gjatë të cilës
12 Jakup Krasniqi mbajti fjalim në një ceremoni mortore."

13 Në librin e tij është e qartë se vëllai, Gani Geci, po
14 përshkruan Shaban Shalën që ka dalë në një program të
15 televizorit shqiptar dhe që përshëndet me grusht. Kështu thotë
16 ai në librin e tij?

17 PË. Mirë. Këta që kanë shkru libra duhet me ju dalë ça kanë
18 thënë edhe vëllau jem edhe tanë këta tjerë. Do t'ju qëndrojnë
19 mbrapa atyre ça kanë thënë. Unë, tash ka dalë një libër që
20 është shkru për mu, unë qëndroj pas asaj komplet. Ça kam thënë
21 asnjë fjalë s'ia hjeku. Kurse këta që kanë shkru edhe Jakupi
22 edhe tjerë që janë lëvdu ka pak, do të mbahen, do të
23 qëndrojnë, s'a punë e jemja. Unë e di që Jakup Krasniqi ka
24 përshëndet me grusht. Edhe u dashtë me dalë nëpër Drenicë me
25 ju thënë hiqni grushtin se është i dëmshëm. Edhe pyetshin

1 ndërkombëtarët që vijshin aty. Edhe nuk janë marksist unë u
2 dashtë me thënë, se është një masë e vogël. Edhe nuk jem
3 fundamentalist. Se propaganda armike e qitke veç një rast të
4 mbulum e thojke shiqoni kujt po i ndihmon Evropa, shtetet
5 demokratik, një vendi fundamentalist që nuk ishte ashtu. Ishte
6 veç një person. Por qatë u marrke shembull ose tjerët me
7 grusht.

8 Jam dal vetë nëpër të gjitha pikat edhe ku kam nejt edhe
9 është mirë ose këta vetë janë bind, disa shokë e njerëz dhe
10 kanë hjek ato shenja. Dhe është mirë që u hjek. Dhe duhet me
11 pranë të gjithë që a mirë që u hjek. Nuk a diçka që s'u kanë,
12 që s'e di kërrkush që Jakup Krasniqi ka përshëndet me grusht.
13 Edhe jo veç Jakup Krasniqi edhe Shaban Shala që unë s'e kam
14 pa. Edhe të tjerë edhe Shaban Shala ka qenë qashtu.

15 PY. Dëshmitar, mbajte një fjalim të gjatë. Por ta themi
16 shkurt, është që në libër, ai përmend, vëllai përmend Shaban
17 Shalën dhe jo Jakup Krasniqin që përshëndet me grusht?

18 PË. Po vëllau e ka pa Shaban Shalën. Unë e kam pa Jakup
19 Krasniqin. Është kur u dalë në skenë UÇK-ja që u dal ma së
20 pari kështu, gati tu edhe me grusht, ky u kanë aty. Dhe kjo
21 është e vërtetë. Po s'duhet mo të vërtetat me i hup, po thua j
22 po s'u ka e mirë. Po dhe ju si Mbrojtës nuk po na bëni mirë as
23 këtyne as neve, po na bëni dëm.

24 PY. Kështu thua ti, por s'na ke dhënë asnjë hollësi të vetme
25 ku e ke parë, kur e ke parë. S'i ke dhënë asnjë detaj

1 Prokurorisë?

2 PË. A don me ti dhënë që tash.

3 PY. Po them që s'i ke dhënë këto detaje Prokurorisë --

4 PË. Po, po ti dhën që tash. Paskam harru. Paskam harru me ti
5 dhënë.

6 PY. -- që i ke dhënë Prokurorisë në 2018.

7 PË. Po ti dhënë që tash. A bën? Para Gjykatës. Një tash po i
8 dhënë.

9 PY. Ne e kemi parë të gjithë paraqitjen e parë --

10 PË. E tani pse po --

11 PËRKTHYESJA: Prisni pak, ju lutem, sa të mbaroj që
12 pastaj...

13 Z. ELLIS: [Përkthim]

14 PY. Pra, e keni parë që ai rrinte pas një tavoline në atë
15 paraqitje.

16 PË. Nuk më përktheu këtu?

17 PY. Keni parë Shaban Shalën duke përshëndetur dhe jo personin
18 tjetër.

19 PË. A tash ti dhe atje po më drejtohesh mua? Kën kam pa unë
20 po më kallëzon? Ai ka pa Shaban Shalën. Unë kam pa Jakup
21 Krasniqin. Shumë interesant a kjo punë.

22 PY. Do të vazhdojmë tani me një temë tjetër dhe do shikojmë
23 një tjetër dokument, Dëshmitar.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti
25 DJK01042 në versionet në shqip dhe në anglisht. Ju kërkoj

1 ndjesë nuk ka përkthim në shqip të këtij dokumenti. Dhe një
2 herë për procesverbal dokumenti që kërkoj që të shfaqet në
3 ekran është DJK01042.

4 PY. Do lexoj pjesët përkatëse për ju, Dëshmitar. Dokumenti
5 mban datën 27 nëntor 2009. Është dokument ose artikull i
6 *Balkan Insight*. Paragrafi që do ju lexoj është paragrafi 2:

7 "Zëvendësi i partisë opozitare LDD-ja, Gani Geci tha që
8 urdhrat për të vrarë Agim Veliun janë dhënë nga Lidhja
9 Demokratike e Kosovës dhe për Adem Salihaj nga Lidhja
10 Demokratike e Dardanisë.

11 "Duke ju drejtuar parlamentit ai thotë: 'Unë kam provë
12 për këtë. I nderuar kryetar i parlamentit, ju nuk jeni,
13 megjithatë në qeveri ne kemi burra, kemi persona të cilët kanë
14 urdhëruar vrasjen e deputetëve, të kolegëve tanë', thotë
15 Geci."

16 Pastaj vazhdohet më tej -- megjithatë do e ndërpres këtu
17 për momentin, Dëshmitar.

18 A keni informacion lidhur me këtë incident që është
19 raportuar në 2009 ku Gani Geci e ka ngritur këtë çështje në
20 parlamentin e Kosovës, a dini gjë lidhur me këtë, Dëshmitar?

21 PË. Po. Krejt e keni *out* jeni. Krejt këto nuk janë deklaratat
22 që duhet me u merr me to. S'është e vërtetë hiç që tash po të
23 them ç'ka po thu s'është e vërtetë. Se kurrë s'ka thënë që pej
24 Lidhjes Demokratike ka dhënë urdhër dikush. As nuk është e
25 vërtetë që ka dhënë. E ki gabim, ngatërru. Krejt e ke

1 ngatërru. I ke bënë lëmsh.

2 Hiç s'është e vërtetë, Gjykatës, hiç. Krejt është out
3 kjo. As po i kuptoj çka po thotë krejt i ka bënë guzhullic, s'ka
4 kurrfarë kuptimi.

5 PY. Mbase ka problem përkthimi. Megjithatë do të mundohem
6 t'jua sqaroj, Dëshmitar. Në këtë artikull thuhet që Gani Geci
7 ka ngritur akuza në parlament që është menduar që të vriten dy
8 persona, domethënë, është bërë tentativë për vrasjen e dy
9 personave Adem Salihu dhe Agim Veliu. A ju kujtohet ky rast,
10 Dëshmitar?

11 PË. Kjo krejt tjetër çka po thu tash, krejt tjetër çka tha
12 pare.

13 PY. Jo, më përpara po ju lexoj artikullin. Në qoftë se ka
14 ndonjë problem me përkthimin na e thuaj, ju kërkohet falje për
15 këtë.

16 PË. Ajo çka --

17 PY. Por, por ajo çfarë po ju pyes tani është: A ju kujtohet
18 që ka ndodhur ky rast në 2009, Dëshmitar?

19 PË. E nderuara Gjykatë, Gjyqtarë, Kryetar i gjyqit, ajo çka
20 tha me këto çka po thotë është krejt sa nata me ditë. Është e
21 vërtetë që Agim Veliu një personalitet është plagu prej dikuj
22 edhe Adem Salihu u tentu me u vra prej njerëzve. Po jo veç
23 ata, po janë edhe disa tjerë ren që janë tentu të gjithë ata
24 që kanë qenë pengesë e proceseve aty janë mundu me i
25 shkatërru. Ato dy figura kanë qenë figura që kanë pas ndikim

1 dhe është mendu me ju frigu edhe s'kanë mujt me i frigu, kanë
2 tentu me i hjek krejt.

3 Kjo e ka ngritë Ganinë, po e ngriti unë që tash si vëlla,
4 unë po i ngre që ti faleminderit që po pyet e po bën mirë që
5 po më pyet se unë po harroj, po m'i qetë ndërmend. Ndera t'u
6 rrit.

7 PY. Pyetja ime ishte kjo: Gani Geci a e ka ngritur këtë
8 shqetësim në parlament në vitin 2009?

9 PË. Gani --

10 PY. Dhe mendoj që përgjigja që dhatë Dëshmitar ishte po, a
11 është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Gani Gaçi ku u shku e ka ngrit problemin e vrasjeve të
13 njerëzve të mëdhenj pas luftës në Kosovës, njerëzve me vlera,
14 njerëzve që kanë pas ndikim, njerëzve që u kanë e pamundur me
15 mendu shqiptari me mend e shqiptarit që duhet me u vra.

16 PY. Në artikull vazhdohet më tej dhe thuhet:

17 "Kryetari i parlamentit, Jakup Krasniqi, mori kërkesën
18 duke pretenduar që prova e pretenduar duhet dërguar në polici.
19 'Provat duhet që të çohen në zyrën e Prokurorisë, parlamenti
20 nuk është gjykatë', thotë Krasniqi."

21 Është e vërtetë, apo jo, që këto prova që të ekzistonin
22 duhet që të dërgoheshin në polici? Është e saktë kjo,
23 Dëshmitar, po apo jo?

24 PË. Po, shumë e vërtetë e shumë mirë paska thënë Jakup
25 Krasniqi. Bravo i koftë. Q'ashtu duhet me i çu. Edhe çdo herë

1 Gani Geci ça ka pas, ç'i kë ka gjykata është çdo herë. Në
2 gjykatë, në polici gjithçka e ka çu ku duhet atje. Dhe ai do
3 të vjen këtu e do të bisedoni dhe me të. Edhe paska bë mirë
4 shumë Jakupi që i ka thënë se është i mençëm, i din qysh
5 duhet. Tëna i ka dit që duhet në polici dhe në gjykatë me i
6 çu.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shohim dokumentin SITF00398158
8 deri në 398180. Ky është një tjetër dokument ku versioni në
9 shqip dhe në anglisht janë pjesë e të njëjtit dokument.
10 Atëherë referencat për faqet përkatëse në shqip dhe në
11 anglisht janë 398176 dhe 398179.

12 PY. Kjo është deklarata e një dëshmitari që është marrë nga
13 një person që quhet Ajriz Zeqiraj. Diku nga mes i kësaj faqe,
14 në versionin në anglisht nga mes i faqes thuhet si më poshtë:

15 "Adem Salihu më tha që do më jepte 15.000 euro më shumë,
16 domethënë, 45,000 euro në qoftë se unë do bëja deklaratë me
17 shkrim dhe nënshkrimin tim dhe ta bëja me incizim të CD-së
18 duke folur unë në atë CD. Unë e pyeta se çfarë duhej të thoja
19 unë. Dhe unë i thashë atij që çfarë duhej të thoja, ndërkohë
20 që ai m'u drejtua që ti ke me dhënë deklaratë lidhur me se
21 gjoja unë kam dashur që ta mbys atë, Adem Salihun sepse më ka
22 paguar dikush për vrasjen e tij."

23 A e ke dëgjuar diçka të tillë që njerëzit kanë ofruar
24 ryshfet për dëshmi të rreme lidhur me krimet kundër anëtarëve
25 të LDK-së? Domethënë, ju lutem na thoni me po apo jo, a keni

1 dëgjuar pretendime të tilla për sa i takon dëshmive të rreme
2 kundrejt ryshfeteve?

3 PË. Kurrë s'kam dëgjuar. Dhe sa i përket Adem Salihut që tash
4 betohna që është rrenë e montume. Adem Salihu një personalitet
5 shumë i fortë. Edhe kjo montim për me hjek orientimin më thotë
6 që ka dhe këso. Gjithçka ka mujt me bë. Adem Salihi është një
7 djalë i fortë, i pathyeshëm dhe kurrë nuk ka bë kështu, as nuk
8 bën. Unë që tash qetu para juve betohna që a q'ajo unë e marr
9 përsipër e marr përgjegjësinë. Rrenë është, e montume a. Nuk
10 jam noj farë personi që muj me marr, po vetë e di karakterin e
11 tij. Adem Salihi është personalitet i fortë që nuk kanë mujt
12 me i tejkalu këta, po u dashtë me i kërcënu në tëna format ose
13 me i vra krejt. I pathyeshëm ka qenë edhe ka mbet qashtu.
14 Prandaj është person që vetëm kanë bë shantazhe, kanë bë
15 rrena, kanë bë montime, nuk ju ka tut kërrkush gjithçka janë
16 mundu me bë me të. Keq është. Keq keni bë. Qeto janë ma të
17 këqija ndër shqiptarë. Ma të këqijat janë. Ai që ka mendu
18 ashtu ai ideatori i kësajna ka bë keq. E tash po dal unë po
19 mendoj që ideatorët tëna janë qeto pështjellimet që po i
20 bëjnë. Për qatë jam këtuna.

21 PY. Do të vazhdojmë me dy temat e fundit për të cilat do t'ju
22 bëj pyetje, Dëshmitar.

23 PË. Urdhnoni.

24 PY. Janë pyetje të cilat kanë të bëjnë me tema që i kemi
25 diskutuar sot. Së pari, tema që do t'ju bëj disa pyetje ka të

1 bëjë me Milaim Zekën dhe e dyta ka të bëjë me postimin në
2 *Facebook* e z. Krasniqi.

3 Sa i takon Milaim Zekës e keni thënë disa herë, z.
4 Misetic, që Gani Geci të ka thënë ty që Milaim Zeka i ka thënë
5 atij që Jakup Krasniqi kishte thënë që Hashim Thaçi ka shkruar
6 Komunikatën 59. Këtë e keni konfirmuar dhe më përpara. Këtë
7 gjë ua ka thënë ai, kështu ka shkruar rrjedha e tregimit,
8 Dëshmitar?

9 PË. Shiqoni, vetë ai deklarimi publik i Jakup Krasniqi është
10 për me u përshëndet se i ka qit senet në vend. Ka kallëzue
11 drejt. Jakup Krasniqi edhe në televizion edhe në *Facebook* ka
12 kallëzu drejt. Q'aty burrnia më e madhe e tina është që ka
13 kallëzu drejt se janë [E pakuptueshme] nuk mund të bëhen aso
14 padrejtësi. Edhe ka kallëzu një të vërtetë. Këto tjerat s'di
15 çka po më vyjnë mu, çka janë në interes tonë.

16 PY. Sepse ti vetë nuk e di në qoftë se Milaim Zeka ka thënë
17 të vërtetën apo jo?

18 PË. Po dhe Milaimi ka fol me tanë këta, me tanë këta ka
19 biseduar. A ka fol të vërtetën? Këta e dinë vetë. Milaimi nuk
20 ka lënë pa pështjellë me tanë ka bisedu, tanë kanë fol, tanë i
21 kanë tregu diçka. Edhe ka tregu Milaimi diçka. Këtu janë këta.
22 Këtu janë kësajde janë. Ça janë qetu me Milaimin kanë fol.
23 Tanë kanë bisedu me Milaimin. I ka pështjellë gjithçka. Është
24 pështjelloci më i madh aty është Milaimi.

25 PY. Dëshmitar, ju lutem ndaloni aty. Sepse këtu po spekulon,

1 se ti vetë personalisht nuk ke qenë i pranishëm kur Milaim
2 Zeka ka fol me ndonjërin prej tyre, në qoftë se vërtetë ka
3 folur, apo jo?

4 PË. Po qe ku janë, pyeti. Unë nuk spekuloj kurrë. Kurrë nuk
5 spekuloj. Milaimi ka thënë ka deklaruar në tëna mediat ju kam
6 thënë këtij, e këtij, e këtij në tëna mediat e kam pa Milaimin
7 vetë. Ku për Komunikatën 59 duhet me dalë me i kërku falje
8 vëllezërve Geci se keni shkruar komunikatë të rrejshme. Ai ka
9 thanë. Ai u përzi vetë pa i thënë kërrkush. Dhe ato që i ka
10 thënë Milaimi vëllaut, kur të vjen Gani Geci e ndëgjoni me zë,
11 jo unë. Mos më shtini në ato çka unë me Milaimin, mos më
12 shtini. Hiç s'e kam jaran me u merr me të. Hiç, hiç. Se edhe
13 ai s'ka qejf me fol me mu. Shumë më interesit. Hiç s'duhet me
14 fol as unë me të as ai me mu hiç. Kurrfarë kontaktesh s'kemi.
15 S'du me u merr me atë person unë.

16 PY. Milaim Zeka nuk do me fol me ty, nuk do me pas kontakt me
17 ty?

18 PË. Unë s'du. Unë s'du me pas kontakt hiç. Hiç, hiç.

19 PY. Ju nuk doni që të keni fare kontakt me të, kështu?

20 PË. Hiç, hiç. Hiç. As kurrë s'kam dashtë me pas kontakt me
21 të. Kurrë. Dhe a e dini pse?

22 PY. Po pse? Pse nuk keni dash kurrë me pas kontakt me të?

23 PË. Se Milaimi është 100 mijë nadjë t'i pështjellë e t'i
24 pështjellë e t'i pështjellë e t'i pështjellë e unë s'du, s'muj
25 ashtu, s'muj me kanë. Po ato duhet me i ndëgju në televizor

1 ose me i incizu e me jua qit përpara ça ka thënë.

2 Milaimi ka fol me tanë këta ku janë ku jarani, ku një
3 parti, ku me ata, ku me këta, u kanë në luftë. Ka fol u shku
4 si gazetar, i ka marrë në pyetje, i ka marrë në intervju. Tëna
5 të zezat e të mirat e krejt Milaimi i me ta i ka bë.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
7 në ekran tani dokumentin DJK01061. Ky është versioni në shqip,
8 ndërkohë që versioni në anglisht ka të njëjtin numër por
9 përfundon me ET në fund.
10 PY. Është një artikull i vitit 2020 që ka të bëjë me Milaim
11 Zekën.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Që në qoftë se do të vazhdojmë në
13 fund të faqes.

14 PY. Thuhet që:

15 "Zeka vetë është paditur për shpifje në disa raste ..."

16 Domethënë, pyetja e parë është kjo: A kemi të bëjmë me të
17 njëjtin person, i njëjti Milaim Zeka është ky që shikoni në
18 ekran, Dëshmitar?

19 PË. Po, vetë Milaim Zeka është.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

21 PY. Këtu thuhet që:

22 "Paditje për shpifje ndaj Milaim Zekës janë bërë
23 vazhdimisht dhe vazhdojnë të bëhen dhe gjithmonë për shpifjet
24 që ai bën ndaj personave të caktuar ..."

25 Nuk do të vazhdoj me leximin por në fakt këtë na keni

1 thënë dhe juve që Milaim Zeka është person i intrigave, a
2 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Milaim Zeka është personi që ka nejt me ta dhe ju ka
4 thënë 100 herë në televizion "Kërkoni falje, kërkoni falje,
5 kërkoni krejt shtabi falje". Publik është çka ka thënë Milaim
6 Zeka. Le ti ato intrigat e çka kanë bë ndërmjet vedi, se s'di
7 unë çka ka bë ndërmjet vedi. Milaim Zeka unë nuk kam qejf me
8 pas punë me të hiç. As me i thënë si je, as me më thënë si je.
9 Hiç. Kurrë. Edhe njerëz si Milaimi, ai mund të jetë i mirë, po
10 hiç unë njeri që të shoh që është pështjellaq s'du me pas punë
11 me të. Po kësaj radhe këtu kur ka thënë e ka pas mirë. Se këtu
12 janë këta vetë që kanë fol me të, që këtu janë. Nuk do të
13 thotë që nganjëherë s'e ka pas mirë Milaimi.

14 Se dhe Milaimi u ka i maltratum pi këtyne tani. Janë
15 guzhmid këta ndër vedi.

16 PY. Ju e dini çfarë reputacioni ka Milaimi dhe keni thënë që
17 nuk doni fare të keni kontakt me të.

18 PË. Mor hiç.

19 PY. Dhe unë po të them që ti nuk e di në qoftë se Milaim Zeka
20 ka thënë të vërtetën kur ka folur me vëllain tuaj?

21 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë, të nderuar Gjykatës.
22 Është pyetje që është bërë disa herë dhe që ka marrë përgjigje
23 deri tani.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Kërkoj që artikulli të pranohet si

1 provë. Numri i artikullit është DJK0161 deri në DJK0163.

2 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë sa i takon relevancës.
3 Nuk është e qartë se çfarë lidhjeje dhe çfarë relevance ka ky
4 dokument lidhur me dëshminë që po jep dëshmitari.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Milaim Zeka nuk është thirrur si
6 dëshmitar nga Prokuroria, por dëshmitarit i janë bërë pyetje
7 që kanë të bëjnë me z. Krasniqi.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë pak
9 relevancë ka. Do ta pranojmë, megjithatë do t'i japim peshën
10 që meriton.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti DJK01061 deri
12 në DJK01063, përkthimi në shqip dhe në anglisht, do të marrë
13 numrin e provës 4D00089. Klasifikimi është publik.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. ELLIS: [Përkthim]
16 PY. Do të kaloj tek tema e fundit tani që ka të bëjë me
17 përgjigjen e botimit në *Facebook*, të postimit në *Facebook* të
18 z. Krasniqi.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja dhe një herë Sekretares
20 të paraqesë në ekran dokumentin me numër DJK00104.

21 PY. Sot paradite keni folur me z. Misetić lidhur me z. Thaçi
22 që kërkon ndjesë lidhur me Komunikatën 59. Dua t'ju tregoj një
23 pjesë të një transkripti që ka thënë z. Thaçi. Z. Thaçi i
24 bëhet pyetje lidhur me Komunikatën 59. Pyetja që i bëhet atij
25 është si më poshtë:

1 "Çfarë mund të na thoni diçka më tepër lidhur me

2 Komunikatën 59?"

3 Dhe diku nga mesi i paragrafit, ai thotë:

4 "Mua nuk më kujtohen të gjitha komunikatat që janë bërë

5 nga zëdhënësi ose nga persona të tjerë, megjithatë në

6 përgjigje të pyetjes tuaj ka pasur individë keqbërës që kanë

7 abuzuar me emrin e UÇK-së apo me emrin e individëve të caktuar

8 brenda UÇK-së."

9 A ju kujtohet ta keni parë këtë në deklaratën që ka dhënë
10 në atë kohë z. Thaçi?

11 PË. Jo, nuk e kam pa unë hiç. Për herë po e ni. Po e ka sqaru
12 Jakup Krasniqi këtu, mirë e ka sqaru.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Le të kalojmë tani në dokumentin
14 06131, në versionin në shqip dhe në anglisht.

15 Z. PACE: [Përkthim] Ndoshta do ishte mirë që të sqarohet,
16 domethënë, t'i sqarohet dëshmitarit se kush thotë çfarë sepse
17 duket sikur lidhja nuk është e qartë duket sikur dëshmitari
18 mendon që këto janë fjalët e z. Krasniqi.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Pjesa që sapo lexova është teksti i
20 asaj çfarë ka thënë z. Thaçi në një intervistë që gjendet në
21 YouTube. Nuk e di e keni kuptuar kështu apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Jo, s'e kuptova ashtu. YouTube. Që tash po e spjegu.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull. Atëherë të kalojmë në
24 dokumentin 061381.

25 Faleminderit për sqarimin.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal ky
2 dokument është pranuar dhe ka marrë numrin e provës P01751.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

4 PY. Përpara një jave Prokurori ju tregoi këtë postimin e
5 këtij teksti në adresën e *FaceBook* të z. Krasniqi. A ju
6 kujtohet ta keni parë këtë --

7 PË. Po.

8 PY. -- ta keni parë dhe përpara një jave dhe gjatë këtyre dy
9 ditëve, Dëshmitar?

10 Në paragrafin e dytë thuhet:

11 "Përderisa ai përmendi zëvendësin e UÇK-së në intervistën
12 e tij, e shoh të domosdoshme të deklarohej publikisht."

13 Pra, kjo është një përgjigje nga z. Krasniqi ndaj asaj
14 pjesës që ju lexova pak më herët ku z. Thaçi përmend edhe
15 zëdhënësin, a është e saktë kjo?

16 PË. E saktë është që këto e kam pa prej Prokurorit. Edhe
17 krejt çka thotë këtu mjafton. Kurrëgjë tjetër nuk po më thonë as
18 për Jakup.

19 PY. Mendoj që z. Pace jua lexoi të gjithë postimin për
20 procesverbal. Megjithatë këtu thuhet, apo jo, se:

21 "... asnjë komunikatë nuk përbën lista emrash me Ibrahim
22 Rugovën dhe veprimtarëve të tjerë politik shqiptarë nuk është
23 lëshuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së sepse do
24 të kishim reaguar që në atë kohë, pasi lufta jonë kishte për
25 adresë vetëm pushtuesit."

1 Domethënë, këtu mohohet që komunikata të tilla janë
2 lëshuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm. Kjo është ajo
3 çfarë thuhet tek kjo pjesa, apo jo, Dëshmitar?
4 PË. Po këta u bënë më Ibrahim Rugovë se ai vetë që tash. Që
5 tash u bënë me kështu me këqyrë krejt me Ibrahim Rugovës janë
6 kanë, po jo atëherë. Këto fjalë i ka thënë, i ka sqaru disa më
7 poshtë. Merri edhe ato të tjerat se është në interes me i pa
8 tëna. Edhe Kryetari i gjyqit me i vlerësu krejt. I ka thënë që
9 ka komunikata s'janë shkru prej *Bahnhof* hiç. E din Hashim
10 Thaçi që komunikatat nuk janë shkru pej atije po veç në
11 Prishtinë janë shkru. Edhe atë e ka thënë Jakupi. Edhe ka bë
12 mirë që e ka thënë. Edhe e din kush e ka marrë, kush u kanë
13 përgjegjësi. Këta e dinë ma mirë dhe do ta thojnë ashtu të
14 vërtetën është ma mirë.

15 Një pjesë shumë mirë të vërtetës e ka thënë Jakup
16 Krasniqi, është për me u përshëndet.

17 PY. Ai vazhdon më tej dhe thotë që:

18 “- Hashim Thaçi e di fare mirë se asnjë komunikatë edhe
19 unë edhe komandantë të tjerë të Zonës Operative të Drenicës e
20 kemi kundërshtuar Komunikatën 59 sepse është mbështetur në
21 gjëra të pavërteta dhe denigruese.”

22 Dhe po ashtu që:

23 “- Ka shprehur kundërshtimin e vet në rast se e njëjta
24 gjë do kishte ndodhur kundër cilëndo familje shqiptare.”

25 Besoj që kjo ju tregua ndërmjet fakteve të tjera dje edhe

1 sot. Kjo është e saktë, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Të lumtë. Të lumtë, Jakup Krasniqi. E ke thënë një të
3 vërtetë që ja vlen. Në radhën e krejt atyre tjerave, kjo është
4 një diçka që është e vërtetë, jo që është personale, po është
5 e vërtetë. Prandaj të vërtetat të gjithë i dun. Dhe je ka një
6 burrë që veç të vërteta unë e kam dit që thu, kaherë e ke laku
7 punën.

8 PY. Nuk ka asgjë në këtë postim në *FaceBook* që tregon
9 konkretisht se kush e ka shkruar Komunikatën 59, apo jo,
10 Dëshmitar?

11 PË. Ka thënë që komunikatën -- i kam thënë se e gjun gurin e
12 mshef dorën, nuk a mirë. Tanë kanë thënë të shtabit, dikush e
13 gjun gurin e mshef dorën. Po erdh një vakt që e gjetën atë që
14 gjun gurin e mshef dorën. E gjetën vetë këta.

15 PY. T'i lëmë mënjanë proverbat, fjalët e urta, e thënë me
16 fjalë të tjera, kjo është një lloj kërkimi faljeje për të
17 thënë që kush ishte përgjegjës. A është kështu, Dëshmitar?

18 PË. Qysh edhe një herë të lutem? Edhe një herë?

19 PY. Atëherë kjo shprehja që ju thatë që të hedhësh gurin dhe
20 të fshehësh dorën, do të thotë që në qoftë se do të kërkosh
21 falje duhet që të tregosh se kush është përgjegjës, kush e ka
22 bërë X gjë, apo jo?

23 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë se nuk është e qartë se
24 çfarë po i kërkon dëshmitarit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i

Dëshmitari: Fadil Geci (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 134

1 përgjigjet dëshmitari në qoftë se e di.

2 DËSHMITARI: E gjuan gurin e mshef dorën kanë thënë këta
3 vetë. Ai person që e gjun grurin e mshef dorën nuk a mirë.
4 Edhe këta e dinë. Ka pas që i kanë thënë drejtpërdrejt që ai
5 që e ka gju gurin e ka mshef dorën. I ka kallëzu që "Ti e
6 gjuve gurin ti. Mos e mshef dorën". Dhe i ka thënë që "Mu më
7 ke thënë. Mu më ke thënë qështu". Pse s'i tha ky "Ti mu më ke
8 thënë e ke bë ti qështu, po qysh u kanë realitet. Ti mu, ti mu
9 më ke thënë qështu". A e kjartë?

10 Z. ELLIS: [Përkthim]

11 PY. Unë po ju them këtë që ju keni dëgjuar z. Misetic që ka
12 diskutuar për mosmarrëveshjet politike lidhur më z. Krasniqi
13 dhe z. Thaçi. Në qoftë se z. Krasniqi do ketë dashur që të
14 thotë që z. Thaçi ka shkruar Komunikatën 59 do e ketë thënë
15 këtë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo jo?

16 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Dëshmitari nuk e di se
17 çfarë ka pasur në mendje Jakup Krasniqi.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull.

20 PY. Në këtë postim në *FaceBook* nuk thuhet shprehimisht se
21 kush e ka shkruar Komunikatën 59, apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Këtu thuhet diçka tjetër që Komunikata 59 është rrenë
23 fare edhe nuk qëndrojmë ne mbas saj hiç. Çka u shkruie prej
24 shtabit u shkru brenda që Hashimi thotë u shkru jashtë dhe kjo
25 e ka demontu. Nuk u shkru në *Bahnhof*. Se disa komunikata që i

1 kanë shkru, kanë kërku falje për disa, por u dash 20 vjet me
2 kërku falje.

3 U dashtë dhe një herë me u kërku falje më thej "E kena
4 shkru një komunikatë gabim kërkojmë falje". A u ka e rand kjo
5 Gjykatë? U kry puna, u merrke fund. Jo me vra njerëzit dhe me
6 pas pasoja, tani po kërkojmë falje. Pse s'kanë kërku falje
7 menjëherë pas komunikatës? Po mbas 20 vjet po thotë "E kena
8 shkru një komunikatë, kërkojmë falje". Puna më e lehtë u kanë
9 me thënë kërkojmë falje mbas tri dite "Gabim na ka dalë një
10 punë dhe ajo nuk është e vërtetë. Kërkojmë falje. Edhe ecëm".

11 Ka për disa komunikata që kanë kërku falje për Shqipëria
12 që e dinë këta. E pse për këto jo? Që u kanë e mshtjellun me
13 benzinë për tëna të këqijat. Qëtu u kanë edhe mbas kësaj kemi
14 pas pasoja dhe na po si familje, po dhe krejt Drenica e
15 Kosova.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
17 një pushim, në qoftë se mbaroni, në rregull. Në qoftë se jo,
18 mos u ndjeni nën presion se do të vijmë prapë.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Do të mbaroj, kam dhe një pyetje.
20 PY. Po them që kjo komunikatë nuk e përcakton se kush e
21 shkroi Komunikatën 59 dhe thotë që z. Krasniqi do ta kishte
22 shprehur kundërshtimin e tij në qoftë se ishin bërë, kishte
23 akuza të tilla kundër ndonjë familje shqiptare.

24 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Sepse pjesa e parë e
25 pyetjes mori përgjigje, kurse e dyta del nga e para.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet
2 kundërshtimi.

3 Mund t'i përgjigjeni. E doni t'jua përsërisim pyetjen?

4 DËSHMITARI: Po, po.

5 Z. ELLIS: [Përkthim]

6 PY. Po e lexoj nga transkripti:

7 "Po t'i lëmë mënjanë fjalimet politike, unë po them që
8 postimi në *FaceBook* nuk e përcakton kush e shkroi Komunikatën
9 59 dhe thotë që në qoftë se do të ishin bërë akuza të tilla
10 ndaj çdo familjeje shqiptare, z. Krasniqi do ta kishte
11 shprehur kundërshtimin e tij. Këtë thotë, apo jo?"

12 PË. Edhe një herë, Jakup Krasniqi i qetë në vend disa këtu
13 për komunikatë. Nuk ka shkru në *Bahnhof*, nuk janë shkru prej
14 Zvicre. Tëna komunikatat janë shkru pej Kosove edhe e ka
15 kundërshtu Komunikatën 59 publikisht para tyre. Ato tjerat
16 flasin vetë.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Kaq kisha. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 z. Ellis.

20 Do të bëjmë një pushim prej dhjetë minutash. Do të
21 ktheheni përsëri në sallë e gjyqit në 3.40.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 3.43. Deri
24 atëherë do të bëjmë pushim.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 15.32

1 --- Seanca rifillon në orën 15.43

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

3 Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje

6 plotësuese, z. Pace.

7 Z. PACE: [Përkthim] Jo, faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
9 Gjykatësit kanë disa pyetje tani për ju. Kështu që ju lutem
10 dëgjojini me vëmendje. Do vazhdojmë me Gjykatësin Barthe që
11 është në të majtën time në të djathtën tuaj.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shumë faleminderit,
13 Gjykatësi Smith.

14 Pyetje nga Trupi Gjykues:

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Geci.

16 PË. Mirëdita.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Geci, Trupi Gjykues ka
18 ndjekur dëshminë tuaj gjatë këtyre ditëve të fundit me shumë
19 interes. Sikurse e përmendi edhe Kryegjykatësi, ne kemi disa
20 pyetje të tjera për ju që ne besojmë që janë të nevojshme për
21 ta kuptuar më mirë dëshminë tuaj.

22 Pyetjet e mia nuk kanë të bëjnë vetëm lidhur me atë se
23 çfarë na keni thënë sot dhe dje gjatë dëshmisë në sallë, pra,
24 në përgjigje të pyetjeve të bëra nga Prokuroria dhe palët e
25 tjera në këtë sallë gjyqi por edhe lidhur me atë se çfarë i

1 keni thënë Prokurorit gjatë seancës përgatitore përpara një
2 jave dhe ajo çfarë pasqyrohet në Shënimin Përgatitor 1 dhe 2.
3 E kuptoni këtë, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] I lutem Sekretares që të
6 shfaq në ekran për të mirën e palëve Deklaratën 1 Përgatitore
7 që ka numrin P01741 dhe aty të shikojmë paragrafin 7 të këtij
8 shënimi a deklaratë. Të shohim faqen 3. Faleminderit.

9 Z. Geci, sipas këtij paragrafi apo në këtë paragraf
10 përmendet faqja 12, rreshti 16 i deklaratës që i ke dhënë
11 Prokurorisë në 2018, bëhet fjalë për një incident në Qirez.
12 Dhe këtu thuhet në shënime apo deklaratë -- nuk e kemi në
13 shqip këtë deklaratë, po dëgjoje me kujdes pyetjen dhe përpiqu
14 t'i përgjigjesh sa më shkurt dhe sa më saktë që të mundesh.

15 Sipas shënimit të Prokurorisë Mehdi Bardhi të tha se ai
16 dhe të tjerë ishin keqtrajtuar nga një grup njerëzish,
17 kryesisht Hashim Thaçi dhe këtu thuhet se pjesë e grupit në
18 Qirez përfshinte edhe Sami Zeqirajn, anëtar i parlamentit dhe
19 se një anëtar parlamenti dhe se gratë ishin lënë mënjanë dhe
20 nuk ishin keqtrajtuar.

21 Ju kujtohet që e keni thënë këtë gjatë?

22 PË. Po, shumë mirë më kujtohet. Po, shumë mirë më kujtohet.

23 Edhe nuk ka e gjinisë mashkullore po Sami është i gjinisë
24 femënore, femër është.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mjafton, kaq. Faleminderit

1 shumë për sqarimin, por është i mjaftueshëm për të sqaruar
2 pyetjen.

3 Pyetja tjetër që kam për ju, z. Geci - dhe prapë dua një
4 përgjigje sa më të saktë nëse është e mundur - kur ta ka thënë
5 z. Bardhi këtë? Kur e keni zhvilluar këtë bisedë me z. Bardhi
6 lidhur me incidentin në Qirez? Çfarë viti apo në çfarë muaji?
7 PË. Me z. Bardhi kem qenë bashkëpunëtorë shumë të mirë dhe
8 raporte shumë të mira dhe kam bisedu tek mbas lufte për këtë
9 rast. Ai me gojë vetë ma ka thënë mbas lufte. Por edhe ka
10 shkruajt një libër, z. Bardhi. S'di e keni ju në dorë atë
11 libër.

12 Edhe më ka thënë se Hashim Thaçi i ka shku brenda pa e
13 dit hiç i ka hi brenda si kryetar i shtetit. E din --

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Geci. Dhe
15 sa për vitin, ju thatë mbas lufte. A mund të jeni më i saktë
16 në çfarë viti ta ka thënë z. Bardhi këtë?

17 PË. Unë me Bardhin mbas lufte kam kontakti gjithë, po me data
18 jam i dobët. Muj me gabu. Kështu gjithë kam kontakti. E kam
19 edhe sot, është smut, po kam vlerësim shumë të madh për të.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo bisedë është zhvilluar
21 menjëherë mbas lufte apo më vonë?

22 PË. Menjëherë pas lufte.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ku, në ç'vend është
24 zhvilluar kjo bisedë?

25 PË. Me Mehdinë jam taku edhe në Prishtinë se ka vazhdu me

1 punu në parti, po edhe në shtëpi të tij edhe në shtëpi teme.

2 Edhe gjithkund jam taku me Mehdinë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Të lutem

4 mundohu të jesh sa më i saktë. Çfarë bëri konkretisht z. Thaçi

5 sipas asaj që tha z. Bardhi?

6 PË. Personazhi kryesor ka qenë në Qirez Hashim Thaçi. Çfarë i

7 bëri ai e ka dhe në libër që janë -- mu më tha që jam

8 maltratum. Bile dove ju ka qitë birra e pula q'atë ka bë mirë

9 q'atyne që ju ka qit birra e pula.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush ju ka qitë pula dhe

11 birrë të tjerëve, kush?

12 PË. E kam ndëgjue këtu një veprimtar që ka thënë edhe birra

13 edhe pula na kanë qitë, mirë me u bë ajo farë pune, mu bë

14 nderim i madh. Gjergj Dedaj e ka thënë po më duket. Ai e din.

15 Ma mirë e din ai.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ta lëmë mënjanë këtë, çfarë

17 ju tha z. Bardhi menjëherë pas lufte në Prishtinë, sikur

18 thatë, lidhur me atë që bëri z. Thaçi? Z. Thaçi i ka

19 keqtrajtuar personalisht me duart e veta njerëzit aty në

20 Qirez?

21 PË. Personalisht. Personalisht, jo në Qirez, po ku i kanë çu

22 atje, diku ku i kanë çue në Baicë a ku i kanë çu, se në Qirez

23 vetëm i kanë ndalu. Kurse unë -- në Baicë i kanë çu dhe atje i

24 kanë pas maltratime. Po për në Qirez kur u takun ma së mirti

25 është personazhi që ka qenë vetë aty, ajo ka qenë një deputete

1 dhe që e përmende Sanije Aliu - Sanije, jo nuk është Aliu,
2 Zeqiraj. Dhe nëse dojnë me e thënë të vërtetën le të thojnë.

3 Unë nuk jam kanë aty, po kështu ka thënë që emni, jo, po
4 personi që ka qenë ka qenë vetë Hashim Thaçi. Veç nuk ka thënë
5 që më ka qitë pulë, nuk ka thënë Mehdi ashtu.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk jam i interesuar shumë
7 për pulat. Dua të dëgjoj nga ju atë që të tha z. Bardhi lidhur
8 me përfshirjen e z. Thaçi. Ai tha që ishte i pranishëm. Bëri
9 gjë tjetër z. Thaçi përveçse që ishte nga ato që të ka thënë
10 z. Bardhi?

11 PË. Maltratimet, krejt maltratimet e mëdhaja i kena pas prej
12 z. Thaçit. Kështu më ka thënë Mehdi Bardhi mu. A ka shtu a
13 s'ka shtu, a u ka qashtu, ai e din vetë se unë s'jam kanë. Mu
14 m'i ka thënë qështu.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja tjetër
16 është: Kush tjetër ishte në grupin e njerëzve që pretendohet
17 se kanë keqtrajtuar z. Bardhi dhe të tjerët? Përmende një grup
18 njerëzish. Sipas këtij shënimit përgatitor kush tjetër ishte
19 në atë grup?

20 PË. Aty ishte edhe Sabit Geci. Po kryesori që e ka marrë
21 përgjegjësinë me i pyet, me i ngjoft, me i dit ka qenë Hashim
22 Thaçi. Edhe Gani Koci ka qenë që i ka njoft mirë ata persona.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të tha që tjetër z. Bardhi
24 lidhur me atë që bëri Sabit Geci gjatë këtij incidenti në
25 Qirez?

1 PË. Tha që na Sabit Geci ka qenë prezent kur na ka shty në
2 kerre. Ka qenë Gani Koca që i ka njoft ata. Bile unë e di që
3 aty që mendojke dhe Mehdi Bardhi që Gjergj Dedaj u maltratu në
4 emën të një Rexhep Gjergjit. Rexhep Gjergji ka qenë i LDK-së,
5 po Gjergj, emnin Gjergj edhe u përzi dhe qaty u kanë puna që i
6 ka qitë pula.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund ta përsërisësh emrin
8 e personit të dytë që sapo e përmende?

9 PË. Personi i LDK-së, një personalitet shumë i fortë, shumë
10 bashkëpunëtor me presidentit Rugova, i emërum me gojë të
11 presidentit si ministër i punëve të brendshme Rexhep Gjergji.
12 E u përzi me Gjergj Dedaj. Edhe vonë e kanë marrë vesh që
13 është Gjergj Dedaj. Kështu më ka thënë Mehdi Bardhi.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Të tha gjë
15 tjetër z. Bardhi lidhur me kërcënime që ka bërë Sabit Geci?

16 PË. Jo. Nuk e ka marrë për gojë Sabitin, veç si individ
17 thjesht. S'u merr me të. Kryesori ka qenë ky person dhe Gani
18 Koci që i ka njoft të gjithë kush është e ka a, se ka punu
19 deri ditën e mbrëmë me ta. Se është e mundshme që Hashim Thaçi
20 s'i ka njoft tanë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, z. Bardhi nuk përmendi
22 ndonjë kërcënim apo ndonjë sjellje kërcënuese nga z. Sabit
23 Geci, këtë po thoni?

24 PË. Mua nuk m'i ka thënë. Ai i ka thënë. Ka shkru libër. Mua
25 nuk m'i ka thënë. Ndoshta s'ka dashtë me m'i thënë, po s'mi ka

1 thënë. Nuk di.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Geci. Të
3 kalojmë te një pyetje tjetër ose pyetjet e tjera që kanë të
4 bëjnë me paragrafin 9.

5 Në paragrafin 9 të Shënimit Përgatitor 1 përmenden faqe
6 19, rreshtat 10 dhe 11 të deklaratës së vitit 2018 që ke dhënë
7 dhe thuhet që gjatë seancës përgatitore i ke thënë Prokurorisë
8 se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte qenë një organ i LPK-
9 së.

10 Ia ke thënë këtë Prokurorisë?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A mund të na
13 shpjegosh shkurtimisht pse thua kështu, pse mendon që Shtabi i
14 Përgjithshëm ka qenë një organ i LPK-së?

15 PË. Sepse të gjithë këta njerëz kanë qenë në LPK ose OMLK.
16 Dhe deri kanë ardhë këta ka qenë prefekt pa asnjë përçarje në
17 mes të shqiptarëve. Deri mbas marsit, fundit të marsit 1998.
18 Komplet shqiptarët ishin unik në luftë me Serbinë.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A mund të na
20 thuash se kush nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ishte anëtar
21 apo i lidhur, sipas mendimit tënd, me LPK-në?

22 PË. Me LPK-në --

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Prisni sa të mbaroj. Nuk dua
24 të dëgjoj shpjegimin dua të dëgjoj emra. Mund të përgjigjeni.

25 PË. Me LPK-në ishte i lidhun Hashim Thaçi, Rexhep Selimi me

1 LPK-në. Jakup Krasniqi me LPK-në. Edhe të tjerët kush janë ato
2 të gjithë kanë qenë personazhe të LPK-së. Edhe nuk ka gjë të
3 keqe që kanë qenë të LPK-së, po, është e vërtetë. Le të thonë
4 që s'u kanë qenë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Të kalojmë tek
6 tema tjetër dhe pyetjet e tjera të cilat lidhen me paragrafin
7 14 të Shënimit 1.

8 Pjesa për të cilën jam i interesuar është në faqen 5 të
9 Shënimit Përgatitor, fjalia e dytë e parafundit.

10 Z. Geci, sipas këtij paragrafi, i ke thënë Prokurorisë
11 gjatë seancës përgatitore se dhe po citoj nga shënimi këtu:

12 "Vetëm udhëheqësit e UÇK-së ishin me LPK-në, ata që ishin
13 nën ta kishin mbështetur LDK."

14 Dua të di këtë që the tani. Disa herë kemi dëgjuar se
15 rreth 90 për qind të popullsisë shqiptare të Kosovës ka
16 mbështetur LDK-në dhe presidentin Rugova para lufte, është e
17 saktë kjo?

18 PË. E saktë 100 për qind. E saktë.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse dikush kishte dëshirë
20 t'i bashkëngjitej UÇK-së që kishte qenë mbështetës i LDK-së a
21 do të kishte probleme për një person të tillë? Nuk e kam
22 fjalën për njerëz që kishin një pozitë zyrtare, funksion
23 zyrtar në LDK. E kam fjalën për mbështetës të zakonshëm të
24 LDK-së.

25 PË. Q'ata që janë duk publikisht të zellshëm për LDK e kanë

1 pas të vështirë. Kurse disa tjerë që popullata ka qenë e
2 madhe, në heshtje kanë ec dhe janë pranë edhe kanë punu.
3 Gjendja ishte e jashtëzakonshme.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] I dole përpara asaj që do të
5 pyesja tani dhe pyetja do të kishte qenë çfarë do t'i ndodhte
6 dikujt po të kishte qenë në një pozitë apo funksion zyrtar në
7 LDK dhe që ishte hapur kundër UÇK-së. Një person i tillë do të
8 kishte pasoja nga UÇK-ja, nëse po, çfarë pasojash mund të
9 ishin ato, nëse e di?

10 PË. Njerëzit që të kanë qenë të pathyeshëm kanë pas pengesa
11 edhe janë -- kanë bërë tentim vrasjeje, do janë vra, do janë
12 dorëzuar s'kanë bërë zë. Interesi jonë ishte me ruajt unitetin, me
13 ruajt vëllavrasjet edhe me ec përpara. Këto ishin këshillat e
14 presidentit Rugova se kjo i shkon përshtati Serbisë dhe ashtu
15 kemi vepruar.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këta njerëz kishte gjasa që
17 dhe të ndaloheshin nga UÇK-ja, nga aq sa di ti?

18 PË. Disa janë ndaluar si në Malishevë, ata janë ndaluar. Sejdi
19 Koca u ndaluar në Drenicë. Haki Imeri u vra krejt. Xhaferr
20 Behrani u vra krejt. Përkrahës që kanë qenë këta persona
21 s'ka pas tjetër parti aty. Edhe shumë tjerë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja tjetër
23 që kam ka të bëjë me paragrafin 20 të Shënimit Përgatitor 1 në
24 faqen 6 të shënimit. Këtu regjistrohet se i keni thënë
25 Prokurorisë gjatë përgatitjes se e keni ditur që z. Thaçi ishte

1 përfaqësuesi politik i UÇK-së në 1998, 1999 dhe kjo ishte
2 arsyeja pse shkove në shtëpinë e Thaçit në dhjetor 1998 për të
3 kërkuar përgjigjen e tij lidhur me Komunikatën 59. Pyetja
4 është kjo: Nga e ke ditur ti që z. Thaçi ishte përfaqësuesi
5 politik i UÇK-së në 1998 dhe 1999?

6 PË. I bënë publike tani ato ata emna. Tani u bënë publik.
7 LPK-ja i bëni publik emnat që është. Dhe ishte e ditun për të
8 gjithë, jo për mu.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Të kalojmë tek
10 paragrafi 22 i Shënimit Përgatitor 1, në faqen 7.

11 Ky paragrafi këtu flet për atë që të ka thënë Tahir
12 Zemaj, siç pretendohet, lidhur me incidentin me Hashim Thaçin
13 dhe Rexhep Selimin pas lufte dhe thotë që askush s'kishte qenë
14 i pranishëm kur keni pas këtë diskutim me z. Zemaj dhe se z.
15 Zemaj të ka thënë që z. Thaçi ka thënë që "ata nuk e kanë
16 pranuar marrëveshjen midis Ramush Haradinajt dhe Zemajt".

17 Pyetja është: Të kujtohet që e ke diskutuar këtë me
18 Prokurorinë gjatë seancës përgatitore?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe a mund të na thoni se
21 kur me saktësi z. Zemaj ta ka thënë këtë? Thua pas lufte, po a
22 mund të jesh më i saktë? Mbase të na japësh muajin apo vitin
23 kur?

24 PË. Lutem disa herë unë jam taku me z. Zemaj. Ka qenë një
25 oficer i karrierës dhe kam pas një besim të madh në të. Se ju

1 ka dashtë Kosovës ma shumë se buka, me qenë një profesionalist
2 për me qenë në ato gjendje të jashtëzakonshme që e kishim.
3 Dhe kemi bisedue shumë sene kur ishim vetë dhe më ka thënë që
4 nëse nuk vijshin, se këta kanë ardhë mes marrëveshjes që kanë
5 bë. Kanë bë një marrëveshje që Tahir zemaj me kanë komandant
6 në Dukagjin, zëvendëskomandant me kanë Ramush Haradinaj. Dhe
7 gjithçka do të shkonte prefekt. Ka pranë edhe Ramush Haradinaj
8 dhe është në libër që ka pranë do nënshkrime.

9 Kurse shkumja e Hashim Thaçit dhe Rexhep Selimit bashkë
10 kanë qenë aty nuk është pranë ajo dhe pasojat dhe telashet i
11 ka pas të mëdhaja krejt ajo zonë, që nuk u kanë në interes
12 hiç. U kanë shumë e dëmshme për të gjithë neve edhe për të
13 gjithë Dukagjinin.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kjo na
15 ndihmon, por a mund të përpiqesh të jesh pak më i saktë lidhur
16 me kohën kur e ke pasur këtë bisedë me z. Zemaj apo më shumë
17 sesa, ishe më shumë sesa një bisedë kur ta tha?

18 PË. Shumë herë kam bisedu. Po në 2001 ka qenë edhe në
19 Skënderaj ka ardhë na ka vizitue. Edhe në Prishtinë, edhe në
20 Dukagjin jam takue dhe është hap biseda dhe u bisedu kjo temë.

21 Dhe është libër, që besoj që e keni libër, që ajo vlen më
22 shumë se këto fjalë që po i them unë, që është zyrtarisht e
23 shkrime. A këto m'i ka thënë mu.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me fjalë të tjera nuk kishte
25 shumë që kishte përfunduar lufta kur keni biseduar me z. Zemaj

1 --

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- kështu, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Se keni përmendur 2001, apo
6 jo?

7 Në rregull. Le të vazhdojmë me pyetjen tjetër ose grupin
8 tjetër të pyetjeve. Viojmë me paragrafin 24 të Shënimit
9 Përgatitor 1. Këtë temë e diskutuat me disa Ekiye të
10 Mbrojtjes, me Ekipin e Mbrojtjes së Thaçit dhe z. Krasniqi pak
11 më herët sot. Këtu përsëri thuhet që z. Milaim Zekaj ka thënë
12 që Fatmir Limaj, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, të gjithë i
13 kanë thënë atij, domethënë, z. Zekaj, se Komunikatën e ka
14 shkruar Hashim Thaçi dhe kur flitet për komunikatën këtu bëhet
15 fjalë për Komunikatën 59, nëse s'gabohem.

16 Po ashtu këtu thuhet që Gani Geci, që është vëllai juaj,
17 duhet të ketë regjistrimin e kësaj bisede.

18 Pyetja e parë që kam për juve, z. Geci është kjo: Në këtë
19 kontekst a mund të përpiqeni që të na thoni, të na tregoni se
20 kur jua ka thënë, ja ka dhënë këtë mesazh ose ke thënë këtë
21 gjë z. Zekaj vëllait tuaj, kur ka pasur bisedën z. Zekaj me
22 vëllain tuaj? Z. Misetic, Avokati i z. Thaçi ju sugjeroi - dhe
23 nuk jam i sigurtë në qoftë se e keni konfirmuar apo jo, në
24 qoftë se e keni konfirmuar na e thoni edhe njëherë, po nuk jam
25 i sigurtë në qoftë se keni thënë po apo jo - biseda midis z.

1 Zekaj dhe vëllait tuaj, Gani Gecit, nuk është zhvilluar jo më
2 vonë sesa më 17 prill, a është kështu, Dëshmitar?

3 PË. Gani Geci, vëllau im, kontakton me Milaim Zekën gjithherë
4 në kohna të ndryshme. Dhe ai mund t'jua thotë ma të vërtetë
5 kur të është këtu, unë mendoj kështu. Për me i ra trup shkurt.
6 Kontakton me të gjithherë. Unë kurrë, ai gjithherë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, apo thoni, Dëshmitar,
8 që nuk e dini konkretisht se kur ka ndodhur kjo bisedë?

9 PË. Jo, nuk e di.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që nuk e dini kur ka ndodhur
11 kjo bisedë, këtë po thoni, Dëshmitar?

12 PË. Kështu po them. Kontakton gjithherë. Nuk e di kur ka
13 ndodhë. Kontakton gjithherë. Kur ka ndodhë nuk e di.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk mund të thuash në qoftë
15 se ka qenë përpara apo pas prillit të 2017, apo jo, Dëshmitar?

16 PË. Unë muj gabo. Edhe para 2017 edhe pas 2017, Ganiu
17 kontakton me Milaimin.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Ka qenë bisedë
19 përmes telefonit apo bisedë e drejtpërdrejtë kjo që ka pasur
20 vëllai juaj me Milaim Zekën?

21 PË. Ata drejtpërdrejt --

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Apo ka qenë një apo më tepër
23 sesa një bisedë?

24 PË. Drejtpërdrejt takohen e flasim gjithqysh. Edhe në telefon
25 edhe kështu kontaktojnë çdo herë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ti vetë, personalisht, a ke
2 qenë i pranishëm kur z. Zekaj i ka thënë vëllait tënd atë
3 çfarë i kishte thënë atij z. Limaj, z. Rexhep Selimi dhe z.
4 Jakup Krasniqi sa i takon pretendimit që z. Thaçi kishte
5 shkruar komunikatën, Komunikatën 59?

6 PË. Unë kurrë. Unë kurrë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sipas asaj që të ka thënë
8 vëllai, z. Zekaj a e ka përmendur se kur dhe ku z. Limaj, z.
9 Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi i kanë thënë atij që
10 komunikatën e ka shkruar Hashim Thaçi?

11 PË. Nuk i mbaj mend datat. Jam i dobët në atë drejtim. Ganiu
12 është personazh që vjen e të gjitha ja u thotë juve
13 drejtpërdrejt ashtë ma origjinal.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Një ose dy pyetje
15 tjera lidhur me këtë. Nëse është e mundur të na e thoni, sipas
16 z. Zekaj bisedat që z. Zekaj thotë që ka pasur me z. Limaj, me
17 z. Krasniqi dhe me z. Selimi kur kanë ndodhur, kanë ndodhur
18 përpara luftës apo gjatë luftës? Pas luftës apo gjatë luftës?

19 PË. Zekaj ka kontakte çdo herë me këta ka pas kontakte, kurrë
20 s'janë ndalë. Edhe me vëllaun tim Ganiun ka pas kontakte. Edhe
21 unë që kaq di.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e fundit për këtë
23 temë. Sipas paragrafit 24 të Shënimit Përgatitor 1 i ke thënë
24 Prokurorit që vëllai juaj duhet të ketë incizimin e kësaj
25 bisede. Dhe për këtë arsye të pyeta në qoftë se ka pas një

1 bisedë me telefon apo jo, por na e sqarove këtë pikë.

2 Për çfarë lloj regjistrimi e keni pas fjalën këtu,

3 Dëshmitar?

4 PË. Milaimi ka pak i thotë do fjalë po vëllau don origjinal.

5 Edhe ka diçka që ju tregon kur të vjen krejt. Pyetne, unë

6 besoj që do t'ju tregon. Edhe këtë pyetje thuaj "ka thënë

7 vëllau yt trego çka ki, se ka thënë që din ti". Që kaq di.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do të përpiqem që ta kujtoj

9 dhe t'i them vëllait tuaj në qoftë se do flasim me vëllain

10 tuaj po nuk jam i sigurtë për momentin.

11 PË. Faleminderit. Respekte.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do të vazhdojmë me pyetjen e

13 radhës ose pyetjet e radhës që kanë të bëjnë me paragrafin 32

14 të Shënimit Përgatitor 1.

15 Në këtë paragraf flitet lidhur me atë çfarë keni mësuar

16 ju lidhur me çfarë i ka ndodhur z. Jakup Kastrati dhe Cen

17 Deskut gjatë luftës. Sipas këtij paragrafi, ju thoni ose me

18 fjalë të tjera i keni thënë Prokurorisë një javë më përpara

19 lidhur me këtë paragraf që keni folur me të dy këta persona,

20 domethënë, keni folur dhe me z. Kastrati dhe me z. Desku pas

21 luftës rreth vitit 2001 dhe se ata të kanë thënë ty që Hashim

22 Thaçi ka qenë personi kryesor pas asaj çfarë ju ka ndodhur

23 atyre.

24 Dhe se ju keni biseduar së pari me z. Kastrati ose me

25 fjalë të tjera, z. Kastrati ka qenë personi i parë që ka

1 përmendur përfshirjen e z. Thaçi dhe më pas z. Desku në një
2 rast tjetër ju ka thënë për përfshirjen e pretenduar të z.
3 Thaçi.

4 Pyetja që kam për ju është kjo: Çfarë ka bërë konkretisht
5 z. Thaçi sipas asaj që ju ka thënë z. Kastrati?

6 PË. Skena ka qenë publike, që janë arrestu dy personalite të
7 LDK-së, kryetari dhe një veprimtar i madh i LDK-së. Është
8 publikisht. Besoj që i keni ju shënimet. Dhe në atë kohë, ai
9 edhe me vështirësi e ka identifikuar se nuk ka qenë problem me i
10 dit kush janë, po ma vonë e ka kuptuar kush ka qenë. Nuk hite
11 shumë në detale po vetëm thojshë që ka qenë Hashim Thaçi. Tash
12 a ka qenë Hashim Thaçi mundet dhe ai këtu janë unë nuk di.
13 Vetëm mu më ka thënë qështu.

14 Edhe që i ka shku te shtëpi edhe kjo a e vërtetë që i ka
15 shku në shtëpi. E për ato tjerat s'di unë.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush i ka shku në shtëpi?

17 PË. Hashim Thaçi.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Hashim Thaçi i ka shkuar në
19 shtëpinë e z. Kastrati?

20 PË. Po. Ashtu ai ka thënë. Unë nuk di, veç ashtu ka thënë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju nuk dini më tepër rreth
22 kësaj vizite?

23 PË. Jo.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, nuk dini çfarë ka
25 ndodhur atje kush ka qenë, kur ka ndodhur, nuk dini asgjë?

1 PË. Jo. Nuk di ato. Nuk janë ajo u kanë publike që krejt bota
2 e ka pa ata njerëz që i kanë marrë i kanë mbajtur një muaj ditë.
3 Ka reagu zyra amerikane i ka nxjerrë. Për respekt njerëz të
4 zyrës amerikane. Ata janë ma të informum. Unë nuk kam lidhje
5 mandej me këtë punë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do e përsërisë dhe një herë
7 pyetjen e mëparshme se nuk është regjistruar për procesverbal.

8 Unë ju pyeta që ju nuk e dini ose a është e saktë që nuk
9 dini ju gjë lidhur me kohën kur z. Thaçi ka shkuar në shtëpinë
10 e z. Kastrati?

11 PË. E vërtetë është që nuk di gjë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Ju nuk dini
13 asgjë sa i takon qëllimit të vizitës, apo jo, Dëshmitar?

14 PË. Nuk di në atë drejtim. Ai e din.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë të ka thënë ty z.

16 Desku lidhur me përfshirjen e z. Thaçi ose përfshirjen e
17 pretenduar në rastin në fjalë me këta dy persona me z.

18 Kastrati dhe me z. Desku? Ju lutem jeni sa më i saktë të jetë
19 e mundur.

20 PË. Vetëm që ka qenë Hashim Thaçi. Ato tjera në detale nuk u
21 lëshu asnjëherë. E ka spjeguar në tv disa herë para gazetarëve.
22 Dhe qaq unë di, nuk di ma shumë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Kastrati dhe/ose z. Desku
24 a kanë përmendur se pse ata kanë menduar që z. Thaçi ka qenë,
25 sikurse e thoni juve, personi kryesor pas asaj çfarë ju kishte

1 ndodhur atyre?

2 PË. Mbas lufte e kanë njoft ata, se në atë kohë s'u njoftke
3 kush është.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk të kanë përmendur asgjë,
5 nuk të kanë përmendur faktet mbi të cilat ata i mbështesin
6 prezumimet ose supozimet e tyre që z. Thaçi ishte personi
7 kryesor?

8 PË. Jo, nuk jam hi më andej se s'u ka në interes temin
9 mandejna. Nuk di mandej.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa për informimin tuaj, z.
11 Geci dhe për palët, do të mundohem që pyetjet e mia t'i
12 përfundoj gjatë kësaj seance. Shpresoj që të mund të përfundoj
13 deri në orën 4.30. Mbase mund ta zgjasim dhe pak ndoshta 3, 4
14 minuta derisa të përfundojmë, megjithatë do të përpiqem që të
15 jem sa më i shkurtër dhe që të përfundojë deri në orën 4.30.

16 Sa i takon pyetjes time tjetër - znj. Sekretare nuk e dua
17 që ta paraqesë në ekran Shënimin Përgatitor numër 2 -- është
18 paragrafi 25 i Shënimit përgatitor 2 që u diskutua gjithashtu
19 edhe më herët me Mbrojtësin e z. Krasniqi, ju me Prokurorinë
20 keni folur lidhur me Likocin.

21 Dhe këtu thoni që keni dëgjuar gjatë luftës që Sylejman
22 Selimi, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, të gjithë e kanë
23 pasur qendrën në Likoc dhe se ju nuk donit të shkonit në Likoc
24 sepse ose me fjalë të tjera, ju keni qenë përkrahës i
25 perëndimit dhe personat që kanë qenë në Likoc kanë qenë

1 përkrahës së praktikave komuniste dhe kjo ishte e papranueshme
2 për ju sepse njerëzit në Likoc dëshironin të vrisnin ose të
3 likujdonin të gjithë ata që ishin kundër tyre.

4 Pyetja e parë është: A ju kujtohet ta keni diskutuar këtë
5 çështje me Prokurorinë përpara një jave dhe me Mbrojtjen e z.
6 Krasniqi sot?

7 PË. Po, kam bisedu. Dhe është e vërtetë që s'jam shku në
8 Likovc.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kush të ka
10 thënë ty që z. Sylejman Selimi, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup
11 Krasniqi, të gjithë e kanë pas qendrën ose kanë qenë të
12 stacionuar në Likoc gjatë luftës, kush ta ka dhënë këtë
13 informacion, dëshmitar?

14 PË. E ka dit edhe bashkësia ndërkombëtare që në Likoc qendër.
15 LPK-ja, kreu i UÇK-së i ashtuquajtur ka qenë në Likovc. Po nuk
16 kanë qenë veç këta që i përmendët. Se këta mund kenë -- aty ka
17 pas edhe djem të mirë, po ka pas edhe tjerë që janë, që kanë
18 qenë, qaty e kanë pas bazën.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush të ka thënë ty që
20 personat në Likoc kanë qenë mbështetës të praktikave
21 komuniste?

22 PË. LPK-ja ka qenë mbështetëse e orientimit komunist deri në
23 1995, gazetat, organi i gazetave që i kanë shkru me i këqyrë
24 ju e gjeni aty vetë se çfarë orientimi kanë pas. E kanë quaj
25 Amerikën imperialiste tëna gazetat dhe kanë mendu që e vetmja

1 rrugë për me e zgjidhë problemin është kjo rrugë. Dhe kjo
2 është e vërtetë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e fundit lidhur me
4 këtë temë është kjo: Nga ku e keni marrë informacionin që
5 njerëzit në Likoc dëshironin që të vrisnin ose të likujdonin
6 çdokënd që ishte kundër tyre, nga e keni marrë veshë këtë
7 informacion?

8 PË. LPK-ja ka qenë një organizatë, që ju kam spjegue, që ka
9 bë luftë për pushtet. Dhe luftën për pushtet pa i hjek
10 njerëzit që janë aty nuk mund të bëhen. Dhe kjo ka qenë ajo që
11 e kam thënë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, nuk është se të
13 ka thënë konkretisht një person që janë vrarë njerëz, janë
14 likuiduar njerëz në Likoc, kështu?

15 PË. Jo. Lufta për pushtet -- dy lufta lufta për pushtet dhe
16 lufta për shtet. Luftën për shtet e ka bë drejtimi i
17 presidentit Rugova, luftën për pushtet e kanë bë këta njerëz
18 që të thashë. Dhe kemi pas pasoja.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ti vetë nuk ke qenë
20 asnjëherë në Likoc siç ke thënë --

21 PË. Hiç, hiç s'kam qenë.

22 PY. -- në deklaratën tënde ose sikurse e ke thënë edhe në
23 seancën përgatitore, kështu?

24 PË. Hiç.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja tjetër

1 ka të bëjë me atë çfarë na ke thënë më herët sot lidhur me një
2 bisedë që ke pasur me Ramë Bujën lidhur me Komunikatën 59. A
3 të kujtohet që e ke diskutuar këtë temë pra, bisedën që ke
4 pasur me Ramë Bujën për Komunikatën 59, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal kjo mund të
7 gjendet në faqet 8 deri në 10 të transkriptit në kohë reale
8 dhe është një informacion të cilin e keni dhënë gjatë pyetjeve
9 të Prokurorit.

10 Në këtë kontekst, ti ke thënë që z. Buja të ka thënë ty
11 që ke folur me njerëz "të shtabit të LPK-së që quhet UÇK". Për
12 të qenë i qartë në këtë pikë e keni fjalën për Shtabin e
13 Përgjithshëm të UÇK-së, apo jo, Dëshmitar?

14 PË. Ramë Buja ka qenë, ka qenë një ndër anëtarët e Shtabit të
15 Përgjithshëm të UÇK-së -- të LPK-së. Dhe është vetë është një
16 marksist Ramë Buja. Vetë e ka orientimin e majtë. E kam njoft
17 mirë. Edhe mu më ka mbet hatri pse ai aty me kanë e me leju me
18 fol kundra neve kur na ka njoft mirë. Dhe ai është deklaruar ato
19 që i kam thënë, mos me zgjatë shumë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur keni thënë më herët sot
21 që "shtabi i LPK-së që quhet UÇK" dhe pastaj ju shtuat që nuk
22 kishte shtab tjetër, e keni pasur fjalën për Shtabin e
23 Përgjithshëm të UÇK-së, apo jo, Dëshmitar?

24 PË. Po. Shtabi i LPK-së edhe Ministria e Mbrojtjes e Ahmet
25 Krasniqit. Dy grupe, një për shtet, një për pushtet. Dy grupe,

1 dy organizime. Njëni organizim që ka pas popullatën e komplet
2 për shtet dhe u dashtë gjithçka me hesht me pshtu çka muj të
3 pshtoj, luftën, vëllavrasjet, ne me vete edhe vetëm luftë me
4 Serbi edhe luftën për pushte që nuk sheh kurrgjë vetëm
5 pushtetin, tmerrohet.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Geci, një sekondë. Ju
7 kërkoj ndjesë që ju ndërpres, po besoj që kjo është e qartë
8 për të gjitha palët dhe pjesëmarrësit.

9 Të kalojmë tek pyetja tjetër. Me kë ka folur z. Buja në
10 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së? Mbi bazën e asaj që të ka
11 thënë ty ai, a ka përmendur emra personash me të cilët ai ka
12 folur?

13 PË. Vetëm ai e din. Nuk m'i ka përmend emrat. Po "Kam fol",
14 tha, "dhe kam pas pasoja". Këtë fjalë ma ka thënë "Kam fol
15 edhe kam pas pasoja". Edhe "Ju kam thënë moni, se keq e keni"
16 edhe bile thotë "Mirë jua keni bë se ju kam thënë moni".
17 Kështu më tha. Ai është gjallë. A e thotë, a e përsërit tash.
18 Nuk e di. Mu më ka thënë. E kam përsërit edhe disa herë në
19 mjete të informimit. Nuk ka pas reagim edhe kjo është e
20 vërtetë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dy pyetjet e
22 fundit. E para, ka të bëjë me atë çfarë keni thënë në
23 përgjigje të pyetjes së Avokatit të z. Thaçi, sipas faqes 51
24 të transkriptit në kohë reale në kuadrin e ndjesës së
25 pretenduar të z. Thaçi për pasojat e Komunikatës 59 për

1 familjen tuaj, keni thënë që jeni në dijeni të shumë rasteve
2 kur personat që janë vrarë më pas janë shpallur heronj. Pa u
3 futur në hollësi, dua t'ju pyes për çfarë rastesh e keni
4 fjalën? A mund të na thoni të paktën emrat e dy personave që
5 keni parasysh kur keni thënë këtë gjë, pra, dy person të cilët
6 janë vrarë nga UÇK-ja dhe pastaj shpallur heronj?

7 PË. Unë po përmendi një. Ai rast është Haki Imeri. Rasti i
8 Haki Imerit. Është vra dhe u shpall hero. Tash kush a
9 tradhtar? A është tradhtar vrasësit a heroi?

10 Një kohë u quajt tradhtar, tani u bë hero. Ai ka qenë
11 vërtetë hero. Po pse me u quajt tradhtar dhe pse me u vra? Një
12 njeri me dy fakultete, një bashkëpunëtor i imi i ngushtë,
13 bashkëpunëtor, me fletë të LDK-së të kuvendit në xhep e ka
14 pas, kena pas me mbajt kuvendin, në xhep është vra. Vetëm pse
15 në atë pjesë atje kur u kanë ai s'ka pas tjetër që mund me pas
16 ndikim. Ka qenë personalitet me ndikim.

17 Është vra Xhaferr Behrami, drejtor i shkollës dhe kryetar
18 i atij rrethi që ka pas ndikim në atë vend.

19 Është vra Ismet Rrahmani, një njeri themeluesi i
20 akademisë ushtarake të UÇK-së. Po ka mbrojt shtetin e Kosovës,
21 e ka mbrojt institucionin. Njeriu më me vlera në krejt fshatin
22 Aqarevë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Geci, besoj që do kemi
24 mundësi t'i kthehemi kësaj teme prapë nesër. Megjithatë për
25 sot pyetja e fundit është kjo: Kemi folur shumë lidhur me

1 Komunikatën 59 dhe kush e ka shkruar atë. Ti ke thënë më herët
2 që jeni i bindur që autori i kësaj komunikate është Hashim
3 Thaçi.

4 Së pari, a është e saktë kjo?

5 PË. Saktë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thatë gjithashtu se z. Thaçi
7 ka qenë përfaqësuesi politik i UÇK-së në 1998 dhe 1999 me aq
8 sa keni dijeni ju, a është e vërtetë kjo?

9 PË. Saktë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo në fakt është pyetja e
11 fundit: A jeni në dijeni të një dokumenti zyrtar që është
12 nxjerrë dhe është publikuar në emrin e Shtabit të Përgjithshëm
13 të UÇK-së ku thuhej që Komunikata 59, në fakt, nuk është
14 lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm dhe se përmbajtja e kësaj
15 komunikate nuk ka qenë e saktë? A keni dëgjuar ndonjëherë për
16 një dokument të tillë?

17 PË. Jo. Unë i kam kërku, nëse më lejohet, me dal me më
18 informue ku ato 20 vjet -- lehtë u kanë menjëherë mbas lufte
19 veç me thënë s'është publike dhe u kryjke. Nuk kam dëgju.

20 Edhe pasojat kanë qenë, i nderuar Gjykatës, dy meshkujt
21 ma të mirë të Drenicës janë vra. Janë vra. I kanë la dy vajza
22 njënin. Njëni ka pas me u martu një javë edhe një javë ka pas
23 me u martu, ish truproja e presidentit. Dy vëllezërit e mi sot
24 janë të plagum, rëndë të plagum. Zoti i ka shpëtu. Pasoja
25 Komunikata 59. Kjo është e vërteta.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Geci. Kaq
2 kisha për sot. Faleminderit dhe një herë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Geci
4 përfundam me dëshminë tuaj sot. Nesër do vazhdojmë me
5 dëshminë tuaj dhe shpresojmë që të përfundojmë me seancën e
6 paradites.

7 Ju lutem mos flisni me askënd lidhur me dëshminë tuaj
8 jashtë sallës së gjyqit. Shpresojmë që të pushoni sonte dhe do
9 të takohemi përsëri nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

10 DËSHMITARI: Faleminderit.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
13 nuk ka ndonjë çështje tjetër për t'u ngritur? Do ta
14 përfundojmë këtu seancën.

15 Do fillojmë përsëri nesër në orën 9.00 paradite.

16 --- Seanca mbyllet në orën 16.36

17

18

19

20

21

22

23

24

25